

# MONITORIMI I AKSESIT NË DREJTËSI DHE PERFORMANCA GJYQËSORE PËR ZHVILLIMIN E NJË GJYKIMI TË DREJTË

## MANUAL TRAJNIMI PËR SHOQËRINË CIVILE

---

Aksesi në drejtësi dhe komunikimi  
me përdoruesit e gjykatës

### Manual 2

Tiranë, Shtator 2023

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian.



Funded by  
the European Union

Ky botim është përgatitur në kuadër të projektit “Gjyqësori në fokus” i zbatuar nga një konsorcium prej tre partnerësh: Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore (ISPL), Fondacioni Shoqëria e Hapur për Shqipërinë (OSFA) dhe Centre for Legal Empowerment (CLE), me mbështetjen e Bashkimit Evropian në kuadër të kornizës “Civil Society Facility and Media Programme 2021”.

Ky botim është bërë i mundur me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmbajtja e këtij dokumenti është përgjegjësi e vetme e Institutit për Studimet Publike & Ligjore dhe në asnjë rrethanë nuk mund të konsiderohet se pasqyron pozicionin e Bashkimit Evropian.

©Të gjitha të drejtat e botimit i takojnë Institutit për Studimet Publike & Ligjore (ISPL)

ISBN: 9789928361462

## SHKURTIME

<b>GjK</b>	Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë
<b>GjL</b>	Gjykata e Lartë
<b>GjEDNj</b>	Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>KEDNj</b>	Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut
<b>DNJF</b>	Drejtoria e Ndhmës Juridike Falas
<b>MD</b>	Ministria e Drejtësisë
<b>KL Gj</b>	Këshilli i Lartë Gjyqësor
<b>KLP</b>	Këshilli i Lartë i Prokurorisë
<b>ILD</b>	Inspektorati i Lartë i Drejtësisë
<b>ShM</b>	Shkolla e Magjistraturës
<b>DhKA</b>	Dhoma Kombëtare e Avokatisë
<b>K.Pr.C.</b>	Kodi i Procedurës Civile
<b>K.Pr.P.</b>	Kodi i Procedurës Penale
<b>OJF</b>	Organizata jofitimprurëse
<b>CEPEJ</b>	Council of Europe European Commission for the Efficiency of Justice
<b>UNROLI</b>	United Nations Rule of Law Indicators
<b>OECD</b>	Organisation for Economic Co-operation and Development
<b>WJP</b>	World Justice Project



## Pasqyra e lëndës

SHKURTIME .....	3
HYRJE .....	7
OBJEKTIVAT DHE REZULTATI QË SYNOHET TË ARRIHET .....	9
STRUKTURIMI DHE PËRMBAJTJA E MODULEVE .....	10
PLANI I TRAJNIMIT .....	12
MODULI I	
AKSESI NË CILËSINË E DHËNIES SË DREJTËSISË.....	13
1. Hyrje .....	13
2. Aksesit në cilësinë e dhënies së drejtësisë sipas këndvështrimit të akteve ndërkombëtare;.....	14
3. Aksesit në cilësinë e dhënies së drejtësisë sipas legjislacionit të brendshëm.....	16
MODULI II	
CILËSIA E SHËRBIMIT NË GJYKATË DHE KOMUNIKIMI ME PËRDORUESIT E GJYKATËS DHE PUBLIKUN .....	18
1. Hyrje.....	18
2. Komunikimi i gjykatave me publikun .....	19
3. Kufizimi i aksesit të publikut në të dhënat personale në vendimet gjyqësore.....	23
4. Monitorimi i përmbushjes së standardeve për cilësinë e shërbimit në gjykata dhe komunikimin e gjykatës me publikun .....	24
<i>Treguesit e realizimit</i> .....	25
<i>Metodat për zhvillimin e monitorimit</i> .....	27
MODULI III	
MONITORIMI I GJENDJES SË AKSESIT FIZIK NË GJYKATA .....	28
1. Hyrje.....	28
2. Standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me aksesin në gjykatë dhe transparencën e procesit gjyqësor .....	30
3. Aksesit në gjykatë i personave me aftësi të kufizuara .....	31
4. Zbatimi i procedurave elektronike në gjykimin e mosmarrëveshjeve.....	33
5. Efektiviteti i hartës gjyqësore në kuadër të aksesit të qytetarëve në proceset gjyqësore dhe shërbimet administrative.....	35
6. Monitorimi i respektimit të aksesit fizik në gjykata .....	37
<i>Treguesit e realizimit</i> .....	37
<i>Metodat për zhvillimin e monitorimit</i> .....	40

## MODULI IV

EFEKTIVITETI I SË DREJTËS SË ANKIMIT.....	41
1. Hyrje.....	41
2. E drejta e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore në çështjet civile.....	42
2.1 Ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë .....	42
2.2 Rekursi ndaj vendimeve të gjykatës së apelit.....	45
2.3 Kërkesa për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë.....	48
3. E drejta e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore në çështjet administrative.....	50
3.1 Ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë .....	50
3.2 Rekursi ndaj vendimit të gjykatës së apelit.....	52
4. E drejta e ankimit ndaj vendimit gjyqësor në çështjet penale .....	53
4.1 Ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë .....	54
4.2 Rekursi ndaj vendimit të gjykatës së apelit.....	55
4.3 Rishikimi i vendimeve të formës së prerë .....	58
5. Monitorimi i përmbushjes së standardeve për respektimin e së drejtës së ankimit.....	60
<i>Treguesit e realizimit .....</i>	<i>60</i>
<i>Metodat për zhvillimin e monitorimit.....</i>	<i>61</i>

## MODULI V

AKSESI NË DREJTËSI NËPËRMJET NDIHMËS JURIDIKE.....	62
1. Hyrje.....	62
2. Ndihma juridike për t'u njohur me legjislacionin dhe zgjidhur problemet ligjore .....	63
3. Ndihma juridike për të aksesuar gjykatën .....	66
4. Përjashtimi nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore.....	67
5. Efektiviteti i praktikave të punës së organeve përgjegjëse për funksionimin e skemës shtetërore të ndihmës juridike .....	68
6. Monitorimi i përmbushjes së standardeve për respektimin e së drejtës për të përfituar ndihmë juridike falas.....	71
<i>Treguesit e realizimit .....</i>	<i>72</i>
<i>Metodat për zhvillimin e monitorimit.....</i>	<i>77</i>

RASTE STUDIMORE .....	78
-----------------------	----

Kazus 1 .....	78
---------------	----

Kazus 2 .....	79
---------------	----

EKSTRAKTE.....	80
----------------	----

BIBLIOGRAFIA .....	86
--------------------	----

## HYRJE

Manuali i Trajnimit mbi “Monitorimin e aksesit në drejtësi dhe performanca gjyqësore për zhvillimin e një gjykimi të drejtë” vjen si vijimësi e Guidës së Monitorimit për Shoqërinë Civile “Aksesi në Drejtësi dhe Gjykimi i Drejtë”, synimi i së cilës është aftësimi i aktorëve të shoqërisë civile që të ndërmarrin nisma në kuadër të llogaridhënies efektive, rritjes së përgjegjshmërisë nga ana e institucioneve të drejtësisë dhe përmirësimit të legjislacionit nëpërmjet:

- Zhvillimit të një kornize të përgjithshme matjeje për të monitoruar përvojën e qytetarëve në plotësimin e nevojave të tyre të përditshme ligjore dhe në aksesin në sistemin e drejtësisë.
- Ofrimit për organizatat e shoqërisë civile të angazhuara në fushat e sistemit të drejtësisë dhe ndihmës juridike, studentëve të drejtësisë dhe gazetarëve të një kornize të përbashkët referimi, në mënyrë që të nxiten, të përmirësohen dhe të harmonizohen nismat e tyre për të monitoruar aksesin në drejtësi të qytetarëve.

Në vijim të treguesve dhe të faktorëve të përcaktuara në Guidë, nëpërmjet këtij Manuali do të analizohen në mënyrë të detajuar të gjitha elementet dhe standardet që duhet të zbatohen për parimet dhe standardet e aksesit në drejtësi dhe performancën gjyqësore për zhvillimin e një gjykimi të drejtë, duke u ndalur në katër komponentë kryesorë:

1. *Aksesi në cilësinë e dhënies së drejtësisë;*
2. *Cilësia e shërbimit në gjykata dhe komunikimi me përdoruesit e gjykatës dhe publikun;*
3. *Monitorimi i gjendjes së aksesit fizik në gjykata;*
4. *Efektiviteti i të drejtës së ankimit;*
5. *Aksesi në drejtësi nëpërmjet ndihmës juridike.*

Analiza ligjore e akteve ndërkombëtare dhe kuadrit ligjor të brendshëm do të ndërthurren me jurisprudencën e GjEDNj-së dhe jurisprudencën e GjK-së, GjL-së, si dhe do të merren në analizë disa vendime të praktikës gjyqësore me qëllim dhënien e një tabloje të plotë të mënyrës së zbatimit dhe respektimit të këtyre parimeve dhe ofrimit të elementeve të referimit për monitorimin e këtyre elementeve nga aktorët e drejtësisë.

Manuali do të ndahet në 5 module, ku secili modul do të strukturohet në disa aspekte, me qëllim analizimin në mënyrë të detajuar të të gjitha elementeve që përmbajnë komponentët e mësipërm:

**Moduli i parë** do të përmbajë një analizë të detajuar të elementeve kryesore të aksesit në cilësinë e dhënies së drejtë sipas këndvështrimit të akteve ndërkombëtare dhe legjislacionit të brendshëm nëpërmjet analizimit të vendimeve të GjEDNj-së, jurisprudencës së gjykatave të sistemit gjyqësor në RSh, GjK, etj.

**Moduli i dytë** do të përmbajë një analizë të detajuar të elementeve kryesore të cilësisë së shërbimit në gjykata dhe komunikimi me përdoruesit e gjykatës dhe publikun duke u fokusuar te komunikimi midis tyre, kufizimi i aksesit të publikut në të dhënat personale në kuadër të vendimeve gjyqësore dhe monitorimi i përmbushjes së standardeve për cilësinë e shërbimit në gjykata dhe komunikimin e gjykatës me publikun.

**Moduli i tretë** do të përmbajë një analizë të detajuar të elementeve kryesore të gjendjes së aksesit fizik në gjykata duke u fokusuar te standardet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe transparencën e procesit gjyqësor, aksesit në gjykatë i personave me aftësi të kufizuara, zbatimi i procedurave elektronike në gjykimin e mosmarrëveshjeve dhe efektiviteti i hartës gjyqësore në kuadër të aksesit të qytetarëve në proceset gjyqësore dhe shërbimet administrative.

**Moduli i katërt** do të përmbajë një analizë të detajuar të elementeve kryesore të efektivitetit të së drejtës të ankimit duke u fokusuar tek e drejta e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore në çështjet civile, administrative dhe penale.

**Moduli i pestë** do të përmbajë një analizë të detajuar të elementeve kryesore të aksesit në drejtësi nëpërmjet ndihmës juridike duke u fokusuar te ndihma juridike për t'u njohur me legjislacionin dhe zgjidhur problemet ligjore, ndihma juridike për të aksesuar gjykatën, përjashtimi nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore dhe efektiviteti i praktikave të punës të organeve përgjegjëse për funksionimin e skemës shtetërore të ndihmës juridike.

Moduli 2, 3, 4 dhe 5 do të përmbajnë udhëzime në lidhje me indikatorë dhe mënyrën e realizimit të monitorimit.



## OBJEKTIVAT DHE REZULTATI QË SYNOHET TË ARRIHET

Ky Manual ka për qëllim aftësimin e aktorëve të shoqërisë civile, studentëve, gazetarëve, praktikantëve të ligjit dhe thellimin e njohurive të tyre mbi parimet dhe standardet e aksesit në drejtësi dhe performancën gjyqësore për zhvillimin e një gjykimi të drejtë.

Manuali ka për qëllim:

- Të ofrojë njohuri të thelluara mbi standardet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor të brendshëm në lidhje me procesin e rregullt ligjor, me fokus aksesin në drejtësi dhe performancën gjyqësore për zhvillimin e një gjykimi të drejtë.
- Nëpërmjet ndërthurjes së metodës teorike me kazuse dhe ushtrime praktike, do të synojmë aftësimin dhe rritjen e kapacitetit ligjor të aktorëve të shoqërisë civile, studentëve, gazetarëve, praktikantëve të ligjit për zbatimin dhe monitorimin e këtyre parimeve.

Në përfundim të trajnimit përmes këtij manuali, aktorët e shoqërisë civile do të kenë aftësitë e duhura për të ndërmarrë nisma në kuadër të llogaridhënies efektive, rritjes së përgjegjshmërisë nga ana e institucioneve të drejtësisë dhe përmirësimit të legjislacionit të sistemit të drejtësisë dhe ndihmës juridike, për monitorimin e respektimit të parashikimeve ligjore.

## STRUKTURIMI DHE PËRMBAJTJA E MODULEVE

<b>MODULI 1</b>	<p><b>AKSESI NË CILËSINË E DHËNIES SË DREJTËSISË</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hyrje</li> <li>2. Aksesit në cilësinë e dhënies së drejtësisë sipas këndvështrimit të akteve ndërkombëtare</li> <li>3. Aksesit në cilësinë e dhënies së drejtësisë sipas legjislacionit të brendshëm</li> </ol>
<b>MODULI II</b>	<p><b>CILËSIA E SHËRBIMIT NË GJYKATA DHE KOMUNIKIMI ME PËRDORUESIT E GJYKATËS DHE PUBLIKUN</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hyrje</li> <li>2. Komunikimi i gjykatave me publikun</li> <li>3. Kufizimi i aksesit të publikut në të dhënat personale në vendimet gjyqësore</li> <li>4. Monitorimi i përmbushjes së standardeve për cilësinë e shërbimit në gjykata dhe komunikimin e gjykatës me publikun</li> </ol>
<b>MODULI III</b>	<p><b>MONITORIMI I GJENDJES SË AKSESIT FIZIK NË GJYKATA</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hyrje</li> <li>2. Standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me aksesin në gjykatë dhe transparencën e procesit gjyqësor</li> <li>3. Aksesit në gjykatë i personave me aftësi të kufizuara</li> <li>4. Zbatimi i procedurave elektronike në gjykimin e mosmarrëveshjeve</li> <li>5. Efektiviteti i hartës gjyqësore në kuadër të aksesit të qytetarëve në proceset gjyqësore dhe shërbimet administrative</li> <li>6. Monitorimi i respektimit të aksesit fizik në gjykata</li> </ol>
<b>MODULI IV</b>	<p><b>EFektiviteti i të drejtës së ankimit</b></p> <ol style="list-style-type: none"> <li>1. Hyrje</li> <li>2. E drejta e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore në çështjet civile</li> <li>3. E drejta e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore në çështjet administrative</li> <li>4. E drejta e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore në çështjet penale</li> <li>5. Monitorimi i përmbushjes së standardeve për respektimin e së drejtës së ankimit</li> </ol>

**MODULI V****AKSESI NË DREJTËSI NËPËRMJET NDIHMËS JURIDIKE**

1. Hyrje
2. Ndhma juridike për t'u njohur me legjislacionin dhe zgjidhur problemet ligjore
3. Ndhma juridike për të aksesuar gjykatën
4. Përjashtimi nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore
5. Efektiviteti i praktikave të punës së organeve përgjegjëse për funksionimin e skemës shtetërore të ndihmës juridike
6. Monitorimi i përmbushjes së standardeve për respektimin e së drejtës për të përfituar ndihmë juridike falas

## PLANI I TRAJNIMIT

- **Prezantimi i manualit sipas moduleve të strukturuar si më lart mund të realizohet në një kohëzgjatje 3 orë, sipas tabelës së mëposhtme:**

Aktiviteti	Metoda	Kohëzgjatja
<p><b>Aksesi në cilësinë e dhënies së drejtësisë dhe komunikimi me pëdoruesit e gjykatës dhe publikun</b></p> <p><b>(Moduli 1-4)</b></p> <p>Me anë të katër moduleve, pjesëmarrësit do të njihen me aktet ndërkombëtare dhe ligjet e brendshme që parashikojnë standardet për të drejtën për t'u dëgjuar nga gjykata, të drejtën për t'u njohur me proceset gjyqësore dhe vendimet e gjykatave, rastet kur kjo e drejtë kufizohet, detyrimin pozitiv që ka shteti për të ndërmmarë veprime ligjore dhe teknike për të garantuar të drejtën e aksesit në drejtësi, duke e ndërthurur me interpretimet ligjore që janë bërë nga gjykatat e brendshme dhe GjEDNj-ja.</p> <p>Pjesëmarrësit do të trajnohen për treguesit e realizimit dhe metodat për zhvillimin e monitorimit.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/ rasteve studimore</p>	<p>1 orë e 30 minuta</p>
<p><b>Aksesi në drejtësi nëpërmjet ndihmës juridike</b></p> <p><b>(Moduli 5)</b></p> <p>Nëpërmjet këtij moduli pjesëmarrësit do të njihen me aktet ndërkombëtare dhe kuadrin ligjor të brendshëm që parashikon të drejtën për të përfituar ndihmë juridike falas nga shteti, kushtet dhe kriteret që duhet të përmbushen, trajtimi i kërkesave për ndihmë juridike nga ana e aktorëve të drejtësisë, duke e ndërthurur me analizën gjyqësore që është bërë nga gjykatat e brendshme dhe GjEDNj-ja.</p> <p>Pjesëmarrësit do të trajnohen për treguesit e realizimit dhe metodat për zhvillimin e monitorimit.</p>	<p>Prezantim me powerpoint</p> <p>Realizimi i diskutimeve interaktive/ rasteve studimore</p>	<p>1 orë e 30 minuta</p>

# MODULI I

## AKSESI NË CILËSINË E DHËNIES SË DREJTËSISË

### 1. Hyrje

Llogaridhënia, transparenca dhe aksesit në drejtësi konsiderohen si tri shtyllat më të rëndësishme në të cilat mbështetet zhvillimi demokratik, duke u cilësuar kështu si tregues thelbësor në rritjen e cilësisë së qeverisjes dhe forcimin e komunitetit. Arritja e standardeve të plota ndërkombëtare, në fushën e transparencës dhe llogaridhënies mbetet sfidë cilësore dhe jetike për sigurimin e demokracisë sipas standardeve dhe praktikave më të mira ndërkombëtare.<sup>1</sup>

Aksesi në drejtësi, si koncept, përfshin të gjitha elementet e nevojshme për t'u mundësuar individëve të identifikojnë dhe të përmbushin nevojat e tyre të përditshme ligjore, të adresojnë problemet e tyre ligjore, të kërkojnë zgjidhje për ankesat e tyre dhe të kërkojnë që të drejtat e tyre të respektohen<sup>2</sup>.

Parimi i aksesit në drejtësi është i lidhur ngushtë me një parim tjetër garantues të drejtësisë dhe demokracisë në shoqëri, parimit të shtetit të së drejtës. Funksionaliteti i shtetit të së drejtës kuptohet shprehimisht përmes zbatimit të drejtë të ligjeve në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve. Në kuadër të zhvillimit demokratik të shtetit të së drejtës, fokusi duhet të zhvendoset në disponueshmërinë e drejtësisë, qartësinë e procedurës, kostot e arsyeshme të procedurave dhe cilësinë e vendimeve<sup>3</sup>. Mungesa e aksesit në drejtësi pengon zhvillimin e shoqërisë dhe që individët të luftojnë varfërinë<sup>4</sup>.

Garantimi i aksesit në drejtësi dhe gjykimit të drejtë, parashikohet në disa dispozita të Kushtetutës së Shqipërisë, specifikisht në nenet 42 dhe 43 të Kushtetutës. Respektimi dhe garantimi i gjykimit të drejtë është një nga të drejtat themelore të parashikuara në KEDNj. GJEDNj, si një nga gjykatat “gardiane” që gjykon respektimin e të drejtave të njeriut nga shtetet anëtare, ka elaboruar ndër vite kufijtë dhe çfarë do të përfshijë e drejta për t'iu drejtuar gjykatës dhe e drejta për të pasur një gjykim të drejtë.

---

1. Shih Raport Vlerësimi “Plani Kombëtar i Veprimit 2020-2022”, aksesuar në linkun [https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/OGP\\_Komponenti-III-Aksesi-n%C3%AB-Drejt%C3%ABsi\\_Raporti-i-Vler%C3%ABsim-it-p%C3%ABr-periudh%C3%ABn-shtator-2021-2022.pdf](https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/OGP_Komponenti-III-Aksesi-n%C3%AB-Drejt%C3%ABsi_Raporti-i-Vler%C3%ABsim-it-p%C3%ABr-periudh%C3%ABn-shtator-2021-2022.pdf)

2. A2JBC Working Group, School of Criminology, University of the Fraser Valley, & International Centre for Criminal Law Reform and Criminal Justice Policy: Aqess to Justice Measurement Framework, faqe 1.

3. International Development Law Organization: Aqess to Justice: A Conceptual and Practical Analysis with Implications for Justice Reforms, faqe 4.

4. Julio C. Teehankee, Ph.D. De La Salle University – Manila: Aqess to Justice Indicators in the Asia-Pacific Region, faqe 1.

Aksesi në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal.<sup>5</sup> E drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk ka karakter absolut. Ajo mund të ketë kufizime, por ato nuk duhet të kufizojnë hapësirën e aksesit për individin në një mënyrë të tillë sa e drejta të preket në thelbin e saj<sup>6</sup>.

Në radhë të parë, neni 42/2 i Kushtetutës e përcakton si një të drejtë themelore të qytetarëve që për mbrojtje të të drejtave, lirive e interesave të tyre ligjore e kushtetuese, t'i drejtohen gjykatës. Në kuadër të zhvillimit të një procesi të rregullt ligjor, është e nevojshme që drejtësia jo vetëm duhet të bëhet, por ajo gjithashtu duhet të shikohet që bëhet. Me qëllim informimin e publikut, për palët të cilat nuk janë pjesëmarrëse në një proces, administrata gjyqësore duhet të marrë masa të caktuara për mbajtjen dhe publikimin e të dhënave gjyqësore.

Aksesi në drejtësi, si një nga kushtet themelore të procesit të rregullt ligjor, pa të cilin nuk do të mund të diskutonim për ekzistencën e një procesi gjyqësor, është një parim i cili është elaboruar ndër vite nga GjEDNj-ja dhe GjK-ja, të cilët kanë përcaktuar kufijtë e shtrirjes së këtij parim, elementet dhe komponentët që merren në vlerësim për të përcaktuar nëse është respektuar nga gjykatat ky parim.

Ky parim shtrihet në dy paralele dhe e ngarkon shtetin, nga njëra anë me detyrimin për të garantuar dhe njohur këtë të drejtë për të gjithë qytetarët, duke shmangur çdo lloj diskriminimi direkt apo indirekt, si dhe detyrimin pozitiv për të marrë të gjitha masat për të garantuar aksesin efektiv, ligjor, fizik të çdo qytetari.

## **2. Aksesi në cilësinë e dhënies së drejtësisë sipas këndvështrimit të akteve ndërkombëtare;**

Aksesi në drejtësi dhe gjykimi i drejtë janë nga të drejtat më të rëndësishme të njeriut, origjinën e të cilave e gjejmë që në Magna Carta Libertatum (karta e Madhe e Lirive) e vitit 1215, ku neni 39 i saj parashikonte se: *“Asnjë njeri i lirë nuk do të ndalohet ose burgoset, ose hiqet nga të drejtat ose zotërimet e tij, ose të nxirret jashtë ligjit ose të internohet, ose të privohet nga pozita e tij në ndonjë mënyrë tjetër, as nuk do të vijohet me forcë kundër tij, ose nuk do të dërgohen të tjerë për ta bërë këtë, përveçse nga gjykimi i ligjshëm i të barabartëve të tij ose nga ligji i vendit”*.<sup>7</sup> Që nga ajo kohë, në mënyrë graduale, aksesit në drejtësi dhe e drejta për një gjykim të drejtë janë bërë ndër të drejtat më të rëndësishme kushtetuese.

Në një sërë aktesh ndërkombëtare është njohur dhe garantuar e drejta për të aksesuar gjykatën nga çdo qytetar dhe detyrimi i shteteve për të marrë masa për të garantuar efektivisht këtë të drejtë.

Pavarësisht se aksesit në drejtësi ka qenë në fokus të organizmave kombëtare dhe ndërkombëtare, në vitin 2008, Komisioni i Kombeve të Bashkuara për Fuqizimin Ligjor të shtresave në nevojë vlerësoi se më shumë se gjysma e popullsisë së botës jeton jashtë mbrojtjes efektive të ligjit. Garantimi i aksesit në drejtësi lidhet drejtpërdrejt me Objektivin

5. Vendim nr. 14/2009 i GJK; Vendim nr. 42/2011 i GJK.

6. Vendim Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere, datë 23/06/1981, GJEDNJ; Sporong dhe Lönnroth, datë 23/09/1982, GJEDNJ.

7. <https://sourcebooks.fordham.edu/source/magnacarta.asp>

e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Kombeve të Bashkuara (SDG) ku në indikatorin 16.3 vendoset theksi në promovimin e shtetit të së drejtës në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar dhe sigurimin në mënyrë të barabartë të aksesit në drejtësi për të gjithë<sup>8</sup>.

Në dhjetor të vitit 2012, Asambleja e Përgjithshme miratoi njëzëri Parimet dhe Udhëzimet e OKB-së për “Aksesin në Ndhimën Juridike në Sistemet e Drejtësisë Penale (67/187), instrumenti i parë ndërkombëtar mbi të drejtën për ndihmë juridike. Parimet dhe Udhëzimet e OKB-së përcaktojnë standardet minimale për të drejtën për ndihmë juridike në sistemet e drejtësisë penale dhe ofrojnë udhëzime praktike se si të sigurohet akses në shërbimet efektive të ndihmës juridike penale.<sup>9</sup>

GjEDNJ ka konsoliduar praktikën në lidhje me aksesin në drejtësi, duke u shprehur se: *“E drejta për akses në gjykatë duhet të jetë konkrete dhe efektive. (Bellet c. France, § 38). Efektshmëria e së drejtës për akses kërkon që një individ të “gëzojë mundësinë e qartë dhe konkrete për të kundërshtuar një ndërhyrje në të drejtat e tij”.*

E drejta për akses në gjykata nuk është absolute. Aty ka vend për kufizime të pranuar heshturazi në mënyrë të nënkuptuar.<sup>10</sup> Kështu ndodh sidomos për kushtet e pranueshmërisë së një rekursi, sepse për nga natyra ai kërkon një rregullim nga shteti, i cili gëzon në këtë rast një hapësirë të caktuar vlerësimi.<sup>11</sup> Gjithsesi, këto kufizime nuk duhet të kufizojnë aksesin e ofruar individit në një mënyrë apo deri në një pikë ku e drejta për akses të cenohet në vetë përmbajtjen e vet. Për më tepër kufizimet nuk pajtohen me nenin 6 § 1 të Konventës vetëm nëse ato ndjekin një qëllim legjitim dhe nëse ekziston një raport i arsyeshëm proporcionaliteti midis mjeteve të përdorura dhe qëllimit të parashikuar.<sup>12</sup>

Në rrethanat e veçanta të një çështjeje, ky karakter konkret dhe efektiv mund të pengohet, për shembull<sup>13</sup>:

- a. Nga kostoja shumë e lartë e procedurës në raport me kapacitetin financiar të ndërgjyqësit;
- b. Nga probleme afatesh;
- c. Nga ekzistenca e barrierave procedurale që pengojnë ose kufizojnë mundësitë për t’iu drejtuar një gjykate. Një interpretim veçanërisht strikt nga ana e gjykatave të brendshme i një rregulloreje procedurale (formalizëm i tepruar) mund t’i privojë kërkuarët nga e drejta për akses në gjykatë.

Në respektim të shtetit të së drejtës dhe parimit të aksesit në drejtësi, shtetet duhet të marrin masa për të minimizuar kufizimin e aksesit në drejtësi dhe ky kufizim duhet të jetë i përligjur për një interes publik dhe të mos çënojë vetë thelbin e së drejtës.

8. <https://www.un.org/en/development/desa/what-we-do/rule-of-law.html>

9. <https://www.un.org/ruleoflaw/thematic-areas/accès-to-justice-and-rule-of-law-institutions/accès-to-justice/>

10. Shih Vendimin e GJEDNJ-së “*Golder vs. Royaume- Uni*”, Aplikimi nr.4451/70.

11. Shih Vendimin e GJEDNJ-së “*Luordo c. Italie*”, Aplikimi nr.32190/96.

12. Shih Udhëzues mbi nenin 6 të KEDNJ. E drejta për një proces të rregullt ligjor (aspekti civil), Këshilli i Evropës, 2013.

13. Po aty;

### 3. Aksesit në cilësinë e dhënies së drejtësisë sipas legjislacionit të brendshëm

Në nenin 42, pika 2 të Kushtetutës, parashikohet që: *“Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe interesave të tij kushtetues dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”*. Në një shoqëri demokratike, e drejta për administrim të mirë të drejtësisë zë një vend të rëndësishëm dhe administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha standardet dhe garancitë procedurale për shqyrtimin e çështjes nga një gjykatë e pavarur, e paanshme dhe e krijuar me ligj.

Aksesit në drejtësi shihet si aftësi e njerëzve për të arritur zgjidhje përmes institucioneve të drejtësisë. Nuk ka akses në drejtësi nëse qytetarët i tremben shtetit, nuk i drejtohen atij, ai është i pabesueshëm, kur individët nuk kanë mundësinë të kenë avokat, kur ata nuk marrin informacionin dhe njohuritë e duhura mbi të drejtat ose kur ka një sistem të dobët të drejtësisë.<sup>14</sup>

Gjykimi i drejtë është një pjesë e të drejtës për një proces të rregullt ligjor të parashikuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe të materializuar në dispozitat e K.Pr.C., ligjin nr. 49/2012 dhe K.Pr.P. Gjykimi i drejtë ndër të tjera përfshin të drejtën e palëve për t’u mbrojtur, barazinë e armëve dhe kontradiktoritetin, arsyetimin e vendimeve gjyqësore, parimin e sigurisë juridike, parimin e disponibilitetit, parimin e mosrëndimit të pozitës së të pandehurit, parimin e prezumimit të pafajësisë, parimin e mosdënimit pa ligj dhe parimin e ligjit penal favorizues i cili ka fuqi prapavepruese.

Aksesit në drejtësi dhe transparenca e gjyqësorit janë dy elemente kyçe që janë evidentuar dhe vlerësuar në Raportin Analitik të Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri të vitit 2015, përgatitur nga Grupi i Ekspertëve të Nivelit të lartë, i cili ka theksuar: *“...publiciteti i veprimtarisë gjyqësore, aksesit i publikut në drejtësi dhe hapja e kësaj veprimtarie ndaj shoqërisë përmes komunikimit me publikun janë elemente themelore për një sistem gjyqësor transparent”*. Sipas ekspertëve, transparenca e gjyqësorit është një karakteristikë e sistemeve demokratike dhe ndihmon parimin kushtetues të garantimit të një procesi të rregullt ligjor.<sup>15</sup>

E drejta për t’iu drejtuar gjykatës, për t’u dëgjuar dhe për të kërkuar rivendosjen në vend të së drejtës së shkelur, mbart dhe detyrimin për të respektuar rregullat, afatet dhe për të kontribuar në cilësinë e dhënies së drejtësisë.

Për herë të parë me ndryshimet që iu bë K.Pr.P dhe K.Pr.C u parashikua e drejta e palëve për të ndikuar dhe kontribuar në cilësinë e dhënies së drejtësisë dhe përmirësimin të standardit të arsyetimit të vendimeve ose dhënë zgjidhje një çështjeje konkrete. Në nenin 438 të K.Pr.P dhe nenin 481 K.Pr.C parashikohet se për shkak të interesit që paraqet njësimi ose ndryshimi

14. Shih Joniada Musaraj “Çështje të aksesit në drejtësi dhe të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm në kuadrin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përvoja shqiptare në vështrim të krahasuar», aksesuar në linkun: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/JONIADA-MUSARAJ-DISERTACION-P%C3%8BR-MBROJTJEN-E-GRAD%C3%8BS-SHKENCORE-DOKTOR.pdf>

15. Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Tiranë, 2015.



i praktikës gjyqësore, në këto gjykime, kur është rasti, GjL mund të kërkojë mendimin me shkrim nga Avokatura e Shtetit, si dhe nga persona juridikë publikë ose privatë që çmohet se kanë njohuri të posaçme për çështjet ligjore të shtruara për njësim ose ndryshim të praktikës gjyqësore.

GjL në kërkesën për paraqitjen e mendimit me shkrim cakton një afat brenda të cilit mund të paraqitet mendimi, i cili në çdo rast nuk mund të jetë më i vogël se 14 ditë. Mendimet me shkrim nuk janë detyruese dhe publikohen në faqen elektronike të GjL-së.

Ky është mjet i rëndësishëm i aktorëve të drejtësisë, të avokatëve, organizatave të shoqërisë civile, kërkuesve shkencor të cilët edhe pse nuk janë palë në një proces gjyqësor mund të ndikojnë në rritjen e cilësisë së dhënies së drejtësisë.

## MODULI II

# CILËSIA E SHËRBIMIT NË GJYKATË DHE KOMUNIKIMI ME PËRDORUESIT E GJYKATËS DHE PUBLIKUN

### 1. Hyrje

Komunikimi i Gjykatës me subjekte të ndryshme nga ato të përfshira në gjykim, është një nga elementet më të rëndësishme të një sistemi drejtësie të mbështetur në transparencë, demokraci dhe në garantimin e të gjitha të drejtave që lidhen me dhënien dhe marrjen e drejtësisë, mbrojtjen nga veprimet arbitrare, garantimin e jetës dhe të drejtave të tjera kushtetuese.

Proceset e mbajtjes së kontakteve midis gjykatës dhe palëve të tjera janë të rëndësishme për vetë drejtësinë dhe siç është pohuar dhe nga Jeremy Bentham<sup>16</sup> “Aty ku nuk ka publicitet, nuk ka drejtësi”.

Përpyekjet për “drejtësi të hapur” i kanë fillësat e tyre shumë të hershme dhe me kalimin e viteve si koncept po elaborohet dhe për institucionet e tjera. Nëpërmjet një drejtësie të hapur, qytetarët janë të informuar se si po jepet drejtësia. Gjykatat duhet të jenë të hapura me qëllim që palët ndërgjyqëse, media, studiuesit dhe në fund të fundit publiku i gjerë të mund të ndjekin, të shqyrtojnë dhe të kritikojnë atë që bëhet në emër të drejtësisë. Drejtësia e hapur, sado e rëndësishme që është, ka një kosto. Ajo ekziston midis dy elementeve të rëndësishme të privatësisë dhe sigurisë dhe shërben për të kryer tri funksione të rëndësishme:

1. ndihmon në kërkimin e së vërtetës dhe luan rol të rëndësishëm në edukimin e publikut duke lejuar aksesin dhe shpërndarjen e informacionit të saktë;
2. siguron dhe rrit përgjegjshmërinë gjyqësore, duke parandaluar sjelljen e pahijshme nga gjyqtarët, oficerët e policisë dhe prokurorët; dhe
3. kryen një funksion terapeutik duke i lejuar komunitetit të shohë se drejtësia vihet në vend<sup>17</sup>.

---

16. Jonathan R. Bruno, *Vigilance and Confidence: Jeremy Bentham, Publicity, and the Dialectic of Political Trust and Distrust*, *The American Political Science Review*, Vol.111, no. 2, 2017, fq. 302.

17. Beverley McLachlin, *Openness and the rule of law*, Remarks of the Right Honourable Beverley McLachlin, P.C. Chief Justice of Canada At the Annual International Rule of Law Lecture, 2014 aksesuar në linkun: <https://www.barcouncil.org.uk/uploads/assets/f73b28da-a633-4eb2-b9834a15dea0ec80/jan82014-12pruleoflaw-annualinternationalruleoflawlecture.pdf#:~:text=As%20Jeremy%20Bentham%20famously%20put,of%20all%20guards%20against%20improbability.>

Në këto mënyra, parimi i gjykatave të hapura funksionon për të ruajtur besimin e publikut në administrimin e drejtësisë, i cili është thelbësor për sundimin e ligjit.

Këto aspekte janë parë si të rëndësishme dhe nga ana e legjislatorit shqiptar i cili me anë të ligjit nr.115/2016 ka ngarkuar KLGj-në me detyra të veçanta të komunikimit ndërmjet gjykatave dhe publikut. Në zbatim të këtyre detyrave është proceduar dhe me nxjerrjen e akteve plotësuese duke përfshirë këtu:

1. Vendimi nr. 590, datë 26.11.2020 i KLGj-së për miratimin e “Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor”;
2. Plani i komunikimit të gjykatave për periudhën 2022-2024;
3. Vendimi i KLGj-së nr. 592 datë 26.11.2020 për miratimin e Rregullores “Për komunikimin e KLGj-së me medien”.

## **2. Komunikimi i gjykatave me publikun**

Ligji nr. 115/2016<sup>18</sup> i ka dhënë një rëndësi të veçantë komunikimit të gjykatave me publikun dhe ka ngarkuar KLGj-në me detyrat e mëposhtme:

- Krijimin, zhvillimin dhe mirëmbajtjen e një portali elektronik në internet, me qëllim ofrimin e informacionit të duhur për qasjen në drejtësi;
- Bërjen të mundur që secila gjykatë të ketë hapësirën e saj të veçantë në portalin në internet dhe t’i lejohej të publikojë në të të dhëna për gjykatën dhe çështjet gjyqësore;
- Marrjen e masave që publiku dhe palët e interesuara të informohen mbi veprimtarinë e gjykatave, si dhe për çështje të veçanta gjyqësore;
- Miratimin dhe përditësimin e udhëzuesit standard të shtypit.

KL Gj cakton një nga anëtarët e tij për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun dhe cakton të paktën një gjyqtar për mediet për çdo juridiksion apeli.

Nëpërmjet vendimit nr. 590, datë 26.11.2020 KLGj ka miratuar “Planin Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor” nëpërmjet të cilit synohet përcaktimi i bazave për përmirësimin e marrëdhënieve të gjyqësorit me medien dhe publikun, të kuptuarit prej publikut të mjeteve dhe mënyrës së komunikimit me gjykatat, të veprimtarisë dhe shërbimeve që ofrohen nga gjykatat, të mënyrës së marrjes së vendimeve dhe kufizimet në punën e gjyqtarëve.

Në zbatim të Planit Strategjik të Komunikimit për Sistemin Gjyqësor, KLGj ka miratuar planin e komunikimit të gjykatave për periudhën 2022-2024. Me qëllim rritjen e besimit të publikut dhe transparencës në sistemin e drejtësisë, Plani i komunikimit ka përcaktuar si objektiva:

---

18. Neni 91 i ligjit nr. 115/2016.

1. Informimi i publikut dhe promovimi i rezultateve të arritura deri më sot për sistemin gjyqësor nga zbatimi i Reformës në Drejtësi;
2. Identifikimi, promovimi, informimi dhe rritja e transparencës së sistemit gjyqësor nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit, si mjet novator i komunikimit në mënyrë efikase dhe të shpejtë, mes grupeve të interesit dhe gjykatave;
3. Informimi i publikut me një gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, mbi funksionet, veprimtarinë e gjykatave dhe mënyrën se si mund t'i drejtohen gjykatës;
4. Informimi i publikut, veçanërisht i grupeve në nevojë dhe të miturve, lidhur me ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe tarifatat gjyqësore;
5. Forcimi i komunikimit dhe i bashkëpunimit ndërmjet gjykatave dhe medias, OShC-ve, palëve të tjera të interesit;
6. Afrimi i komunitetit me gjykatat përmes organizimit të aktiviteteve publike dhe fushatave ndërgjegjëse që kulmojnë në Javën e Drejtësisë.

Për përmbushjen e objektivave të mësipërme janë parashikuar ndërmarrja e veprimeve konkrete si më poshtë:

*Për objektivin nr. 1:*

- i. Hartimi dhe publikimi i materialeve informuese në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme lidhur me riorganizimin e kompetencave tokësore të gjykatave.
- ii. Hartimi dhe publikimi i materialeve informuese në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme lidhur me organizimin dhe funksionimin e gjykatave dhe rezultatet e arritura.
- iii. Intervista në medie me qëllim informimin mbi ndryshimet/risitë/përfitimet që solli Reforma në Drejtësi dhe promovimi i rezultateve të arritura.

*Për objektivin nr. 2:*

- i. Krijimi, plotësimi ose përditësimi i llogarive në rrjete sociale, Facebook, LinkedIn dhe Twitter për secilën Gjykatë.
- ii. Hartimi i medie-planeve për publikimet në rrjetet sociale të gjykatave.
- iii. Krijimi dhe/ose përditësimi i rubrikave të veçanta në faqen [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al) dedikuar publikimit të informacioneve për qytetarët.
- iv. Video shpjeguese dhe udhëzues mbi mënyrën e kërkimit dhe marrjes së informacionit në faqen [www.gjykata.gov.al](http://www.gjykata.gov.al).
- v. Promovimi i faqes së internetit të gjykatave dhe rrjeteve sociale të gjykatave.
- vi. Publikimi i gazetës elektronike në të cilën do të trajtohen çështje që lidhen me veprimtarinë e Gjykatës së Lartë, ndryshimet në legjislacion, vendime unifikuese, statistika etj.

*Për objektivin nr. 3:*

- i. Hartimi i materialeve informuese mbi procedurën që ndiqet në çështjet penale, civile dhe ato administrative; mënyrën e paraqitjes së çështjeve, kërkesave/ ankesave drejtuar gjykatës; formatet standarde; mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve (ndërmjetësimi); shërbimet që mund të merren nga gjykata; e drejta e ankimit/rekursit dhe afatet.
- ii. Realizimi i një videoje “Turi virtual i gjykatës” duke paraqitur gjykatën dhe ambientet e saj (sportelet, sallat e gjyqit, siguria, kodin e sjelljes, infrastrukturën për PAK, etj.).

*Për objektivin nr. 4:*

- i. Hartimi dhe publikimi i materialeve informuese mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti.
- ii. Hartimi dhe publikimi i materialeve informuese mbi tarifat gjyqësore.
- iii. Përgatitja e materialeve informuese mbi të drejtat e të miturve në konflikt me ligjin gjatë procesit penal dhe të drejtat e të miturve viktima ose dëshmitarë të veprës penale.
- iv. Pjesëmarrja në medien kombëtare ose lokale të përfaqësuesve të gjykatave me qëllim informimin mbi ndihmën juridike të garantuar nga shteti dhe tarifat gjyqësore.

*Për objektivin nr. 5:*

- i. Tryezë diskutimi me OShC-të dhe grupet e interesit me qëllim forcimin e bashkëpunimit.
- ii. Aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere në bashkëpunim me OShC-të.
- iii. Aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere në bashkëpunim me Fakultetet e Drejtësisë.
- iv. Aktivitete informuese me medien dhe studentët e gazetarisë.

*Për objektivin nr. 6:*

- i. Organizimi i Javës së Drejtësisë dhe vendosja e bashkëpunimit me grupet e interesit.
- ii. Përgatitja e materialeve promovuese për “Javën e Drejtësisë”.
- iii. Aktivitete informuese dhe ndërgjegjësuere me komunitetin.

Gjithashtu, KLGj ka miratuar me vendimin nr. 592 datë 26.11.2020 Rregulloren “Për komunikimin e KLGj me medien”, e cila synon lehtësimin e aksesit të informacionit për përfaqësuesit e medieeve. Në nëni 5 të tij është parashikuar që kontaktet e KLGj-së me

përfaqësuesit e medias do të mbahen nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit, sipas udhëzimeve dhe nën mbikëqyrjen e anëtarit të caktuar nga Këshilli, i cili miraton paraprakisht çdo informacion që i përcillet medias. Vendosija e kontaktit dhe komunikimi i mëtejshëm me median realizohet nëpërmjet një adrese të posaçme të postës elektronike (e-mail): media@klgj.al, e cila përdoret nga Koordinatori për të Drejtën e Informimit dhe nëpërmjet një rubrikë e veçantë me emërtimin 'Kontakti me Median' në faqen zyrtare të KLGj-së.

Gazetarët mund të paraqesin kërkesën e tyre edhe nëpërmjet një formulari, sipas një formati të miratuar sëbashku me rregulloren dhe që vendoset në faqen zyrtare të KLGj-së, duke plotësuar informacionin lidhur me të dhënat personale, institucionin që përfaqëson, qëllimin dhe përmbajtjen e shkurtër të problematikës.

KLgj trajton kërkesën për informim, duke parashtruar informacionin e kërkuar sa më shpejt që të jetë e mundur, por jo më vonë se 10 ditë pune nga dita e dorëzimit të saj. Ky afat mund të zgjatet me jo më shumë se 5 ditë pune, kur lind nevoja për të kërkuar dhe shqyrtuar dokumente të shumta e voluminoze, kur lind nevoja për të shtrirë kërkimet pranë gjykatave, kur lind nevoja për t'u konsultuar me autoritete të tjera publike, përpara marrjes së një vendimi për plotësimin ose jo të kërkesës.

Kërkesa për informim mund të refuzohet nëse dhënia e informacionit shkakton një dëm të qartë dhe të rëndë ndaj:

- i. sigurisë kombëtare, sipas përkufizimit të bërë nga legjislacioni për informacionin e klasifikuar;
- ii. parandalimit, hetimit dhe ndjekjes së veprave penale;
- iii. mbarëvajtjes së hetimit administrativ në kuadër të një procedimi disiplinor;
- iv. mbarëvajtjes së procedurave të inspektimit dhe auditimit;
- v. barazisë së palëve në një proces gjyqësor dhe mbarëvajtjes së një procesi gjyqësor;
- vi. këshillimit dhe diskutimit brenda Këshillit.

Kërkesa për informim mund të refuzohet edhe në raste të tjera kur:

- i. Nuk është shprehur qartë ose është haptazi abuzimi;
- ii. Për informacionin e kërkuar ekziston tashmë material i publikuar prej Këshillit;
- iii. Për informacionin e kërkuar i është dhënë informacion i mëparshëm të njëjtit kërkues;
- iv. Çështja për të cilën kërkohet informacion është ende në proces, e papërfunduar.

Në rast të refuzimit, kërkuesit i komunikohet shkakut i refuzimit në mënyrë të arsyetuar.

Në zbatim të nenit 69 të ligjit nr. 115/2016, plani i komunikimit të gjykatave ka përcaktuar që mbledhjet plenare të KLGj-së pasqyrohen në medie, duke postuar në faqen zyrtare në internet edhe një njoftim të shkurtër për shtyp, me përmbledhjen e çështjeve që paraqesin interes për publikun. Përfaqësuesit e medias që dëshirojnë të marrin pjesë në mbledhjen plenare të KLGj-së, duhet të paraqesin dokumentin e akreditimit personal dhe të identifikimit të medias që përfaqësojnë, ndërsa në rastet e zhvillimit të mbledhjeve në distancë (online), dokumenti i akreditimit personal mund të dërgohet elektronikisht.

Një kuadër të rritjes së cilësisë së komunikimit të organeve të drejtësisë, ShM duhet të ofrojë trajnim për anëtarët e KLGj-së, gjyqtarët për mediet, administratën e KLGj-së dhe nëpunësit civilë gjyqësorë të përfshirë në veprimtaritë e marrëdhënieve me publikun.

### **3. Kufizimi i aksesit të publikut në të dhënat personale në vendimet gjyqësore**

Të dhëna personale është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social<sup>19</sup>. Në përmbajtjen e kërkesëpadisë që paraqitet në gjykatë paditësi ndër të tjera ka detyrim të plotësojë për çdonjërin e palët ndërgjyqëse: emrin, atësinë, mbiemrin, vendbanimin ose vendqëndrimin e paditësit e të paditurit dhe të personave që përkatësisht i përfaqësojnë ata, kur ka të tillë<sup>20</sup>. Gjithashtu, vendimi i gjykatës ndër të tjera duhet të përmbajë të dhënat lidhur me palët duke u shënuar identitetin<sup>21</sup> si dhe informacion edhe të dhëna lidhur me identitetin e ekspertëve dhe dëshmitarëve.

Në procesin penal, vendimi i gjykatës sipas rastit përmban të dhëna për identitetin e të pandehurit, subjektit ndaj të cilin kërkohet të zbatohet një masë shtrënguese dhe ndaluese, kallëzuesit, viktimës akuzuese, ekspertëve, dëshmitarëve, etj.

Në këtë mënyrë, Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale ka miratuar Udhëzimin nr. 15 datë 23.12.2011, "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor". Ky udhëzim ndër të tjera parashikon që të dhënat personale ose sensitive që përmban vendimi gjyqësor, bëhen publike vetëm nëse:

- i. nga ky publikim nuk cenohen interesat legjitime të subjekteve të të dhënave dhe
- ii. subjekti i të dhënave personale informohet mbi të dhënat e tij, të cilat do të publikohen me iniciale ose të koduara në faqen zyrtare në internet, me qëllim bërjen e tij të paidentifikueshëm<sup>22</sup>.

Gjykatat duhet të zbatojnë masa organizative dhe teknike për mbrojtjen e të dhënave personale. Personat përgjegjës, gjatë publikimit të vendimeve penale, vendimeve civile

19. Neni 3.1 i ligjit nr.9887, datë 10.3.2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale"

20. Neni 154.1.b i K.Pr.C.

21. Neni 310.4 i K.Pr.C.

22. Paragrafi IV pikat 1 dhe 2 të Udhëzimit nr. 15 datë 23.12.2011, "Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor".

(të cilat janë dhënë mbi kërkesëpadi) në faqen zyrtare në internet, detyrohen të zbatojnë rregullat e mëposhtme, në mbrojtje të privatësisë:

- i. Gjeneralitetet e palëve, personave të tretë, dëshmitarëve dhe ekspertëve të thirrur në gjykim, paraqiten me iniciale ose kodohen.
- ii. Në pjesën arsyetuese të vendimit, ndalohet publikimi i të dhënave personale që cenojnë privatësinë e palëve në gjykim (si p.sh: adresa, targa të makinës, numra të telefonit dhe çdo element tjetër i cili identifikon subjektin e të dhënave).

Gjatë publikimit të vendimeve civile tregtare, gjeneralitetet e palëve/aksionarëve paraqiten me iniciale ose kodohen, ndërsa ndalohet publikimi i përqindjeve të aksioneve/kuotave që zotërojnë palët, i numrave të llogarive bankare, shumat (vlerat) monetare dhe sekretet tregtare, ndërsa gjatë publikimit të vendimeve civile familjare, gjeneralitetet e palëve ndërgjyqjese paraqiten me iniciale ose kodohen, ndërsa ndalohet publikimi i rrethanave që cenojnë dinjitetin dhe jetën private të tyre ose personave të tjerë të lidhur me çështjen gjyqësore, si dhe i të dhënave, mbi dhënien e mendimit të fëmijës, mbi detyrimin ushqimor, mbi takimet e të miturit me prindërit, kohën dhe vendin e takimit, mbi raportin e psikologut, etj.

Në të gjitha rastet kur palët në gjykim janë minorenë, ndalohet publikimi i gjeneraliteteve dhe të dhënave të tjera identifikuese (personale) ose të dhënave lidhur me të tretë, nga të cilat mund të zbulohet edhe indirekt, identiteti i minorenit.

Aksesi në vendimin e plotë të publikuar në faqen zyrtare në internet lejohet vetëm për personat që kanë një interes të ligjshëm në të, ndërsa kopja fizike e vendimit gjyqësor u jepet vetëm personave të interesuar që kanë një interes të ligjshëm në lidhje me çështjen gjyqësore

Vendimet gjyqësore të formës së prerë mund të përdoren për qëllime shkencore, statistikore, literature apo gazetarie, duke siguruar se nuk janë përpunuar, për të marrë masa ose vendime për një individ. Në rastet kur përdorimi i të dhënave bëhet në një formë, që lejon identifikimin e subjektit të të dhënave, të dhënat duhet të kodohen menjëherë, në mënyrë që subjektet të mos jenë më të identifikueshme.

#### **4. Monitorimi i përmbushjes së standardeve për cilësinë e shërbimit në gjykata dhe komunikimin e gjykatës me publikun**

Disa nga indikatorët për monitorimin e standardeve për cilësinë e shërbimit në gjykata dhe komunikimin e gjykatës me publikun janë pasqyruar në tabelat si më poshtë:



<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<b><i>Përqindje</i></b>
Cili është niveli i kënaqësisë së përdoruesve të gjykatave me informacionin e pasqyruar në portalin elektronik në internet <a href="http://www.gjykata.gov.al">www.gjykata.gov.al</a> ?	
Cili është niveli i kënaqësisë së përfaqësuesve të medias me informacionin e pasqyruar në portalin elektronik në internet <a href="http://www.klgj.al">www.klgj.al</a> ?	
Sa funksionale janë të dhënat e kontaktit të publikuara në faqet zyrtare të internetit?	
Cili është niveli i kënaqësisë së përfaqësuesve të medias me informacionin e vendosur në dispozicion nga KLGj-ja nëpërmjet kërkesave për informacion?	
Cili është raporti i gjykatave që kanë ose jo nëpunës të dedikuar për marrëdhëniet me median dhe publikun?	
Cili është raporti i rasteve kur është respektuar ose jo afati për vendosjen në dispozicion të informacionit nëpërmjet kërkesave për informacion?	
Cili është raporti i rasteve kur informacioni i publikuar në faqet në internet është publikuar njëherësh edhe në platformat e mediave sociale?	
Sa efektiv ka qenë komunikimi i përfaqësuesve të medias me gjyqtarët e medias në kuadër të përmirësimit dhe lehtësimit të raportimit të veprimtarisë së gjykatave dhe të informimit sa më të saktë e të shpejtë të publikut?	
A ka marrë administrata gjyqësore masa organizative dhe teknike të parashikuara në ligj për të mbrojtur të dhënat personale nga shkatërrime të paligjshme, aksidentale, humbje aksidentale, për të mbrojtur aksesin ose përhapjen nga persona të paautorizuar?	
A janë informuar të punësuarit në sistemin gjyqësor që vijnë në dijeni me të dhënat e përpunuara gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre, që detyrohen të ruajnë konfidencialitetin edhe pas përfundimit të funksionit?	
A është siguruar aksesin në vendimin e plotë të publikuar në faqen zyrtare në internet vetëm për personat që kanë një interes të ligjshëm në të?	
A i jepet nga administrata gjyqësore kopja fizike e vendimit gjyqësor vetëm personave që kanë një interes të ligjshëm në lidhje me çështjen gjyqësore?	
A është lejuar që vendimet gjyqësore të formës së prerë mund të përdoren për qëllime shkencore, statistikore, literature apo gazetarie sipas kritereve ligjore?	

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Po/Jo</i>
A përmban portali elektronik në internet <a href="http://www.gjykata.gov.al">www.gjykata.gov.al</a> informacion të detajuar për strukturën e gjyqësorit dhe të gjykatave të veçanta, natyrën dhe qëllimin e procedurave gjyqësore, ndihmën juridike, kohëzgjatjen mesatare të çështjeve, tarifat gjyqësore, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe çështje të tjera me interes publik?	
A është bërë publik në faqen zyrtare të Këshillit regjistrimi audio i mbledhjes plenare brenda 24 orëve nga dita e mbledhjes?	
A i është komunikuar medias përmbledhje e vendimeve gjyqësore për çështje që kanë interes të veçantë publik?	
A kanë qytetarët që flasin/lexojnë gjuhët e pakicave kombëtare akses në një version zyrtar në gjuhën e tyre për publikimet në faqet zyrtare në internet?	
A kishte gjykata një zyrë informacioni për vizitorët?	
Nëse po, a ishte zyra e informacionit për vizitorët e hapur gjatë të gjithë orarit zyrtar të punës?	
A kishte gjykata të disponueshme përmbledhje informacioni që shpërndaheshin në formën e fletëpalosjeve ose publikimeve të afishuara në ambientet e saj, për të drejtat e palëve në procesin gjyqësor, ndihmën juridike, tarifat gjyqësore, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve, etj?	
A kanë qenë të mjaftueshme burimet financiare për t'ju përgjigjur nevojave të gjykatave për të ofruar shërbime në kohë dhe cilësore për publikun?	
A kanë qenë të mjaftueshme burimet financiare për të zhvilluar aktivitete sensibilizuese dhe informuese për publikun dhe medien?	
A janë kryer trajnime nga ShM për anëtarët e KLGj-së, gjyqtarët për mediet, administratën e KLGj-së dhe nëpunësit civilë gjyqësorë të përfshirë në veprimtaritë e marrëdhënive me publikun?	
Cili është niveli i kënaqësisë së gazetarëve, avokatëve dhe studiuesve të së drejtës për përdorimin për qëllime shkencore, statistikore, literature apo gazetarie të vendimeve gjyqësore të formës së prerë?	
Cili është niveli i kënaqësisë së qytetarëve për mbrojtjen e aksesit ose përhapjes nga persona të paautorizuar të të dhënave personale ose sensitive që përmban vendimi gjyqësor?	
Cili është niveli i kënaqësisë së avokatëve për krijimin e aksesit nga gjykata të informacionit për mosmarrëveshjet në gjykim?	
Sa është niveli i kënaqësisë së palëve pjesëmarrëse në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit?	
Sa ishin më të ulëta/larta shpenzimet gjyqësore të palëve për të marrë pjesë në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit?	

***Metodat për zhvillimin e monitorimit:***

- Zhvillimi i sondazheve me qytetarët përdorues të gjykatave.
- Zhvillimi i sondazheve me përfaqësuesit e medieve.
- Këqyrja e faqeve zyrtare në internet.
- Paraqitja e kërkesave për informacion.
- Analiza e vendimeve të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale.
- Monitorimit fizik të ofrimit të shërbimeve nga administrata gjyqësore.
- Zhvillimi i sondazheve me gazetarë, avokatë dhe studiues të së drejtës.
- Zhvillimi i sondazheve publike dhe lokale.

## MODULI III

# MONITORIMI I GJENDJES SË AKSESIT FIZIK NË GJYKATA

### 1. Hyrje

E drejta e aksesit në drejtësi është parimi kushtetues me anë të të cilit garantohet ushtrimi i të drejtave dhe lirive themelore të njeriut, një kusht esencial për ekzistencën e shtetit të së drejtës, që udhëheq organizimin dhe funksionimin e drejtësisë në vend. Me aksesin e lirë në gjykatë, kuptohet një e drejtë publike, e cila i jep titullarit të saj garancinë ligjore që të drejtohet për të kërkuar mbrojtjen e shtetit, duke detyruar organet gjyqësore kompetente të prononcohen mbi pretendimet e tij.<sup>23</sup>

Neni 42 i Kushtetues nis me formulimin “Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

Në interpretim të termit “kushdo”, kuptohet që çdo person fizik apo juridik, shtetas shqiptar, i huaj, pa shtetësi ka të drejtë t’i drejtohet gjykatës dhe të kërkojë rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura.

Aksesi në drejtësi përfshin të drejtën për “proces të rregullt ligjor”, “njohjen e barabartë para ligjit dhe përpara organeve të sistemit të drejtësisë”, si dhe “kërkimin dhe pasjen e mjeteve juridike për mbrojtjen e të drejtave të shkelura”. Garantimi i aksesit në drejtësi është i domosdoshëm për sundimin e ligjit në çdo shoqëri demokratike, si dhe për të luftuar marginalizimin social dhe ekonomik në shoqëri.<sup>24</sup>

Në lidhje me të drejtën e aksesit, si element i së drejtës për proces të rregullt, GjK ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t’i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Kjo e drejtë e individit nuk përfshin vetëm të drejtën për të filluar një proces, por edhe të drejtën për të pasur, nga ana e gjykatës, një zgjidhje përfundimtare për mosmarrëveshjen objekt gjykimi, pasi aksesin në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Në rast se mohohet kjo e drejtë, procesi konsiderohet i parregullt, sepse aksesin në gjykatë është,

23. Shih Rekomandimin e Avokatit të Popullit “Rekomandim për rishikimin e propozimit të hartës së re gjyqësore, duke garantuar aksesin në drejtësi të qytetarëve në kuadër të së drejtës për një proces të rregullt ligjor”, aksesuar <https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/ëbsite/media/Rekomandim%20per%20botim.pdf>

24. Shih Raportin e Monitorimit “Garantimi i aksesit në drejtësi për personat me aftësi të kufizuar në Shqipëri”, botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, Dhjetor 2018.

para së gjithash, kusht kryesor për të realizuar mbrojtjen e të drejtave të tjera të individit. Shteti i së drejtës nuk mund të konceptohet pa u njohur individëve të drejtën dhe mundësinë për t'iu drejtuar gjykatës.<sup>25</sup>

Shtetet kanë detyrimin jo vetëm për ta njohur këtë të drejtë (detyrimi negativ), por kanë detyrimin të marrin të gjitha masat për të garantuar ushtrimin efektiv të kësaj të drejte (detyrim pozitiv).

Aktet ligjore duhet të parashikojnë rregulla për pjesëmarrjen e të gjithë personave në gjykatë, të krijojnë kushtet dhe infrastrukturën e duhur për aksesin jo vetëm juridik, por edhe fizik në gjykatë.

*“Aksesi fizik në gjykatë”* përmban disa komponentë që lidhen me:

1. Afërsinë e gjykatës (distanca, koha dhe mundësia për të aksesuar gjykatën);
2. Infrastruktura e gjykatës, mundësia për të marrë pjesë fizikisht në seancat (shkallët, rampa, ashensorë etj.);
3. Mundësia efektive për t'u dëgjuar, kuptuar gjatë pjesëmarrjes në seanca (personat që nuk dëgjojnë, nuk flasin, etj.)
4. Aksesi fizik në gjykatë nëpërmjet sistemit elektronik.

Deri para ndryshimeve të kohëve të fundit në K.Pr.P, miratuar në maj 2017, gjatë procedurave penale shteti nuk garantonte përdorimin e gjuhës së shenjave, të drejtën për një përkthyes të gjuhës së shenjave, si dhe nuk mbulonte pagesat për përkthyesit. Këto të drejta ende nuk garantohen në procedurat civile. Kjo ua vështirëson shumë jetën personave me dëmtim të dëgjimit, 98% e të cilëve janë analfabetë ose kanë aftësi shumë të kufizuara në shkrim dhe lexim.<sup>26</sup>

K.Pr.P pas hyrjes në fuqi të ndryshimeve parashikon që personi nën hetim ose i pandehuri ka të drejtë të përdorë gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmohet nga një interpretues nëse ka aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar. Në rastin e të pandehurit që nuk dëgjon dhe nuk flet ose është me aftësi të kufizuara, që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, organi procedues duhet t'i sigurojë menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti në rast se nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të. Në rastin e pyetjes së dëshmitarëve, nuk mund të pyeten si të tillë personat që, për shkak të aftësive të kufizuara fizike ose psikike, nuk janë në gjendje të bëjnë dëshmi të rregullt.

K.Pr.C., parashikon që kur merret në pyetje një person që nuk flet ose nuk dëgjon, në qoftë se pyetja e tyre nuk mund të bëhet me shkrim, gjykata thërret një person që i kupton shenjat e personit që merret në pyetje.

Në këtë modul do të analizohen të gjitha komponentet për aksesin fizik, efektiv real të

25. Shih vendimin nr. 20, datë 22.09.2022 të GjK-së; vendimin nr. 12 datë 09.03.2021 të GjK-së; Vendimin nr.21, datë 20.03.2017 të GjK-së.

26. Shih Milatovic. S “Studim mbi aksesin në drejtësi në Shqipëri, UNDP, Fq.84, aksesuar në linkun [https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/FINAL\\_DRAFT\\_SURVEY\\_SQ.pdf](https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/FINAL_DRAFT_SURVEY_SQ.pdf)

personave në gjykatë, në mënyrë të barabartë dhe duke shmangur çdo lloj diskriminimi ekonomik, shëndetësor, fetar, politik etj. Në fund të modulit do të pasqyrohen indikatorët për monitorimin e këtij parimi.

## **2. Standardet kombëtare dhe ndërkombëtare në lidhje me aksesin në gjykatë dhe transparencën e procesit gjyqësor**

E drejta për t'iu drejtuar gjykatës nuk parashikohet në mënyrë të shprehur nga instrumentet ndërkombëtare. Megjithatë, GjEDNj-ja ka dalë në përfundimin se aksesin në gjykatë përbën një pjesë të pandashme të së drejtës për një gjykim të drejtë.

Është konstatuar se si pengesat ligjore, ashtu edhe ato praktike, cenojnë të drejtën e aksesit në gjykatë. Një pengesë ligjore që mund të përmendet është vlera e taksave gjyqësore që duhet të parapaguhet për inicimin e një procesi gjyqësor. Vendosja e taksave gjyqësore në vlerë të lartë, e cila është e papërbalueshme nga qytetarët, e cila mund të sjellë mos ushtrimin e të drejtave në gjykatë është konsideruar si cenim i së drejtës së aksesit në gjykatë.

Në çështjen *“Weissman dhe të tjerë kundër Rumanisë”*<sup>27</sup>, GjEDNj-ja doli në përfundimin se vendosja e një tarife gjyqësore prej afërsisht 1 % të vlerës së padisë, duke marrë parasysh dhe rrethanat specifike të çështjes, cenonte të drejtën për t'iu drejtuar gjykatës.

Në çështjen *“Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar”*, GjEDNj-ja doli në përfundimin se pengimi i një të burgosuri për të kontaktuar një avokat, duke mos e lejuar atë praktikisht të nisë një çështje civile, cenonte të drejtën e tij të aksesit në gjykatë.<sup>28</sup>

Krahas pengesave të parashikuara në ligj, aksesin në gjykatë mund të kufizohet edhe për shkak të rrethanave teknike, si p.sh. mungesa e infrastrukturës së gjykatës, p.sh. nuk janë vendosur rampa ose ashensorë për personat me aftësi të kufizuara, mungesa e ekspertëve interpret, etj.

E drejta e aksesit në gjykatë nuk është një e drejtë absolute, pasi ajo mund t'i nënshtrohet edhe kufizimeve të parashikuara në ligj, proporcionale me gjendjen e diktuar, si p.sh. afatet e parashkrimit, rregullat për të miturit apo personat me probleme mendore etj.<sup>29</sup>

Zhvillimi i një procesi gjyqësor transparent dhe publik, i cili garanton pjesëmarrjen e qytetarëve gjatë procesit, është një nga garancitë që është parashikuar në disa akte ndërkombëtare të rëndësishme.

Në nenin 10 të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut, në nenin 10 të saj parashikohet se: *“Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale”*.

Në nenin 14 paragrafi 1 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike parashikohet

27. Shih Vendimin e GjEDNj-së *“Weissman dhe të tjerë kundër Rumanisë”*

28. Shih Vendimin e GjEDNj-së *“Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar”*

29. Shih *“Drejtë Drejtësisë, Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore”*, 2013, OSCE.

se: "...Në përcaktimin e çfarëdolloj akuze penale ndaj tij, apo të të drejtave dhe detyrimeve të tij në një çështje në gjykim, kushdo duhet të ketë të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe të hapur..."

Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut, si një nga instrumentet më të rëndësishme të mbrojtjes dhe garantimit të të drejtave dhe lirive të individit në nenin 6 paragrafi i parë sanksionon se: "Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile apo të dënimit penal ndaj një njeriu, secili ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe të hapur... Vendimi duhet të shpallet publikisht ...".

E drejta e një procesi gjyqësor transparent, nuk do të thotë vetëm garantimin e palëve pjesëmarrëse të procesit gjyqësor, por krijimin e kushteve dhe garancive për pjesëmarrjen e çdo personi të interesuar.

GjEDNj-ja ka theksuar në jurisprudencën e saj se: "një gjyq e përmbush kriterin e të qenit publik vetëm nëse publiku ka mundësi të marrë informacion rreth datës dhe vendit ku ai do të zhvillohet". Gjykata shprehet se pjesë e detyrimit për të garantuar zhvillimin e seancave gjyqësore të hapura për publikun, është dhe përgatitja e informacione për t'ia vënë në dispozicion publikut." Gjykata theksoi se për të respektuar nenin 6 të KEDNj-së, vendi ku zhvillohen seancat gjyqësore duhet të jetë "lehtësisht i aksesueshëm për publikun" që normalisht kërkon mbajtjen e seancave gjyqësore në "salla normale gjyqi aq të mëdha sa të mund të zërë vend publiku"<sup>30</sup>.

Me ndryshimet që i janë bërë ligjit procedural, aksesin në gjykatë dhe pjesëmarrja në një proces gjyqësor mund të realizohet:

- *Fizikisht* - në parim palët ose përfaqësuesit e tyre ligjorë duhet të paraqiten fizikisht në gjykatë në orën dhe datën e seancës së caktuar nga gjykata - neni 174 K.Pr.C.
- *Videokonferencë* - Në lidhje me paditë me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, gjykata vendos që palët të sjellin shpjegimet me shkrim ose nëpërmjet videokonferencës. Aspektet vizuale dhe zanore të seancës të videokonferencës transmetohen në kohë reale të vendndodhjes me sallën ku zhvillohet procesi gjyqësor (neni 285/a K.Pr.C).

Për shkak të infrastrukturës së gjykatës, ende nuk kemi një praktikë të zhvilluar në lidhje me përdorimin e videokonferencave, si një mënyrë për të mundësuar aksesin dhe pjesëmarrjen e personave në procesin gjyqësor.

### **3. Aksesin në gjykatë i personave me aftësi të kufizuara**

Siç kemi analizuar dhe më lart, aksesin në drejtësi është një nga elementet thelbësore të një shoqërie demokratike, i cili ka për qëllim promovimin, respektimin dhe zbatimin praktik të të drejtave të anëtarëve të shoqërisë, pa përjashtime dhe pa diskriminime. Instrumenti i parë ndërkombëtar që garanton aksesin në drejtësi të të gjithë anëtarëve të një shoqërie duke vënë theksin te heqja e barrierave kufizuese dhe penguese për aksesin në drejtësi të

30. Shih Vendimin e GjEDNj-së "Riepan kundër Austrisë", 14 Nëntor 2000.

personave me aftësi të kufizuara, është Konventa për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar (KDPK). Në funksion të këtij të fundit është ngritur edhe Komiteti mbi të drejtat e personave me aftësi të kufizuara, i cili vë theksin te të drejtat dhe mbrojtja që personat me aftësi të kufizuar gëzojnë në të gjitha llojet e proceseve, administrative apo gjyqësore dhe përgjatë gjithë fazave procedurale.

Personat me aftësi të kufizuara ndeshin pengesa të mëdha në aksesin (qasjen) në drejtësi, përfshirë procedimet penale apo njohjen e të drejtave të tyre civile. Këto vështirësi përfshijnë mohimin e të drejtave të tyre ligjore për shkak të mungesës së aksesit fizik dhe në komunikim gjatë aplikimit dhe zhvillimit të procedurave në institucionet e administratës publike si dhe në institucionet e drejtësisë.

Për shkak të problematikave të konstatuara ndër vite, për shkak të zhvillimit të proceseve gjyqësore në zyrat e gjyqtarëve, të cilat shpesh cenonin të drejtën e aksesit të personave në gjykatë dhe ulnin besimin e qytetarëve në sistemin e drejtësisë, Këshilli i Lartë i Drejtësisë, me vendimin nr. 238/1/b, datë 24.12.2008 i *“Për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit”*, parashikoi se të gjitha proceset gjyqësore, për sa është e mundur, duhet të zhvillohen në salla gjykimi të përshtatshme për natyrën e çështjes konkrete.<sup>31</sup>

Gjithashtu, zbatimi i sistemit të regjistrimit digjital audio në gjykata përbën një kërkesë të detyrueshme ligjore, çka garanton saktësi të nivelit të lartë të dokumentimit të seancës gjyqësore dhe rrit transparencën, efikasitetin si dhe përmirëson administrimin e gjykatave.

Në nenin 107 të K.Pr.C. janë parashikuar disa rregulla për pjesëmarrjen në një proces gjyqësor të personave me aftësi të kufizuara në të folur dhe dëgjuar. Nëse një person shurdh, memec apo shurdhmemec dëshiron të marrë pjesë në seancë dhe të dëgjohet nga gjykata, veprohet si më poshtë:

- a. Shurdhit i paraqiten pyetjet dhe paralajmërimi me shkrim dhe ai përgjigjet me gojë;
- b. Memecit i bëhen pyetjet dhe paralajmërimi me gojë dhe ai përgjigjet me shkrim;
- c. Shurdhmemecit i paraqiten pyetjet dhe paralajmërimi me shkrim dhe ai përgjigjet me shkrim.

Në qoftë se shurdhi, memeci ose shurdhmemeci nuk dinë të lexojnë ose të shkruajnë, autoriteti procedues cakton një ose më shumë interpretë.

Personat me aftësi të kufizuara të cilët kanë kufizime në të ecur, gjykata duhet të marrë masat e duhura teknike dhe infrastrukturore për të mundësuar aksesin dhe pjesëmarrjen e tyre në seancë gjyqësore, p.sh. duke vendosur rampa, duke vendosur ashensorë, duke krijuar hapësirat e nevojshme në sallën e gjyqit për qëndrimin e tyre etj.

Përveç aksesit fizik në gjykatë të personave me aftësi të kufizuara, në aktet ligjore në fuqi

---

31. Shih Raporti: Studim dhe Monitorim i Gjykatës së Rrethit Tropojë”, përgatitur nga Qendra Integrim dhe Zhvillim Demokratik”, Viti 2019; Vendimi nr. 238/1/b, datë 24.12.2008 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë *“Për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit”*.



janë parashikuar disa të drejta, rregulla për garantimin e së drejtës për t'iu drejtuar, dëgjuar dhe mbrojtur të drejtat nëpërmjet gjykatës, konkretisht:

- Ligji për ndihmën juridike të garantuar nga shteti, ka parashikuar si përfitues të ndihmës juridike parësore, dytësore dhe përjashtimit nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore, personat të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, personat të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore, personat, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar ose u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar.
- MD duhet të marrë masat e nevojshme për publikimin e formularëve të ndihmës juridike në format të aksesueshëm nga personat me aftësi të kufizuara.
- K.Pr.P. parashikon që personi nën hetim ose i pandehuri ka të drejtë të përdorë gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmohet nga një interpretues nëse ka aftësi të kufizuara në të folur dhe në të dëgjuar. Në rastin e të pandehurit që nuk dëgjon dhe nuk flet ose është me aftësi të kufizuara, që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, organi procedues duhet t'i sigurojë menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti në rast se nuk ka zgjedhur mbrojtës ose ka mbetur pa të. Në rastin e pyetjes së dëshmitarëve, nuk mund të pyeten si të tillë personat që, për shkak të aftësive të kufizuara fizike ose psikike, nuk janë në gjendje të bëjnë dëshmi të rregullt.
- K.Pr.C. parashikon që kur merret në pyetje një person që nuk flet ose nuk dëgjon, në qoftë se pyetja e tyre nuk mund të bëhet me shkrim, gjykata thërret një person që i kupton shenjat e personit që merret në pyetje.

#### **4. Zbatimi i procedurave elektronike në gjykimin e mosmarrëveshjeve**

Në gjykimin e mosmarrëveshjeve civile dhe administrative K.Pr.C. parashikon zbatimin e procedurave elektronike në disa raste gjatë zhvillimit të shqyrtimit gjyqësor.

Gjykata, kur e çmon të dobishme dhe kur pala ose personi i tretë ka dhënë pëlqimin paraprak, urdhëron që thirrja në gjykatë të bëhet nëpërmjet njoftimit me mjete të komunikimit elektronik<sup>32</sup>. Të dhënat elektronike të kontaktit të palës paditëse ose të përfaqësuesit, nëse ka një të tillë, mund të regjistrohen me paraqitjen e kërkesëpadisë<sup>33</sup>, ndërkohë që të dhënat elektronike të kontaktit të palës së paditur mund të regjistrohen nëpërmjet paraqitjes së deklaratës së mbrojtjes.<sup>34</sup> Palët ose personat e tretë, për çdo ndryshim të mëvonshëm të adresës dhe të të dhënave elektronike të kontaktit të tyre ose të përfaqësuesit të tyre, detyrohen të njoftojnë gjykatën. Shkelja e këtij detyrimi e bën të papranueshëm pretendimin

32. Neni 129 paragrafi 2 i K.Pr.C.

33. Neni 154 paragrafi 2.a. i K.Pr.C.

34. Neni 158 paragrafi 42.a. i K.Pr.C.

për pavlefshmëri njoftimi.<sup>35</sup> Në rastin e njoftimit me shpallje, njoftimi botohet edhe në një rubrikë të posaçme në faqen zyrtare në internet të gjykatës, dhe/ose në një portal elektronik kombëtar të krijuar për këtë qëllim.<sup>36</sup>

Njoftimi elektronik i akteve bëhet me mjete të komunikimeve elektronike, nëpërmjet dërgimit nga punonjësi i gjykatës të letërthirrjes ose akteve të tjera që duhet t'i njoftohen personit të caktuar si marrës, në të dhënat e tij të kontaktit. Ky njoftim duhet të pasqyrohet në një procesverbal të posaçëm, në të cilin duhet të tregohen të dhënat e kontaktit dhe mjete i komunikimeve elektronike të përdorura për njoftim, data dhe ora e saktë e komunikimit, personi me të cilin komunikon dhe qëllimi i njoftimit. Procesverbali hartohet nga sekretari gjyqësor dhe nënshkruhet prej tij dhe punonjësit të gjykatës të ngarkuar për kryerjen e njoftimeve. Ky procesverbal bëhet pjesë e dosjes gjyqësore<sup>37</sup>.

Regjistrimi i të dhënave elektronike të kontaktit të palëve është i rëndësishëm edhe në kuadër të shqyrtimit të mosmarrëveshje në apel. Njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton çështjen bëhet nga gjykata e apelit me shpallje në ambientet e saj dhe në gjykatën përkatëse të shkallës së parë. Ky njoftim bëhet gjithashtu në faqen e internetit të gjykatës së apelit, si dhe, nëse ka, edhe në faqen e internetit të gjykatës përkatëse të shkallës së parë, dhe, me njoftim individual në rastin kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit në shkallën e parë të gjykimit. Shpallja ose njoftimi bëhet të paktën 15 ditë para datës së gjykimit<sup>38</sup>. Të njëjtat rregulla zbatohen edhe për shqyrtimin e rekursit në GjL ku sekretaria e GjL-së shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit dhe njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me shpallje në ambientet e GjL-së, si dhe në faqen e saj të internetit dhe me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit<sup>39</sup>.

K.Pr.C. parashikon mundësinë e shqyrtimit të disa prej mosmarrëveshjeve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit. Në lidhje me paditë me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, gjykata vendos që palët të sjellin shpjegimet me shkrim ose nëpërmjet videokonferencës. Me kërkesë të arsyetuar të palëve, si dhe kur gjykata e çmon të arsyeshme, ato mund të pyeten nëpërmjet mënyrave dhe mjeteve të tjera të komunikimit në distancë. Aspektet vizuale dhe zanore të seancës të videokonferencës transmetohen në kohë reale të vendndodhjes me sallën ku zhvillohet procesi gjyqësor. Aspektet vizuale dhe zanore të transmetuara nuk regjistrohen. Vendimet e mësipërme janë të paankimueshme<sup>40</sup>. Në shqyrtimin e padive me vlerë deri në njëzetfishin e pagës minimale në shkallë vendi, gjykata mund të vendosë që dëshmitë e dëshmitarëve të merren me anë të deklaratave me shkrim ose videokonferencës, të siguruara jashtë ambienteve të gjykatës. Në deklaratën me shkrim të dëshmitarit duhet të shënohet paralajmërimi i

35. Neni 129 paragrafi 2 i K.Pr.C.

36. Neni 133/b.3 paragrafi 3 i K.Pr.C.

37. Neni 141 i K.Pr.C.

38. Neni 460.5 i K.Pr.C.

39. Neni 482.3 i K.Pr.C.

40. Neni 285/a i K.Pr.C.

përgjegjesisë ligjore për deklaram të rremë. Vërtetimi i nënshkrimit vërtetohet nga noteri ose sekretaria e gjykatës<sup>41</sup>.

Në rastin e shqyrtimit të akuzave penale, K.Pr.P. ka parashikuar gjithashtu procedura për njoftimin e të pandehurit nëpërmjet të dhënave elektronike të kontaktit. Në rast se njoftimi i të pandehurit person juridik në selinë e tij, nuk është i mundur, ai kryhet nëpërmjet afishimit të njoftimit në adresën e deklaruar të selisë, këndin e afishimit të gjykatës dhe në faqen elektronike të saj, si dhe nëpërmjet afishimit në faqen elektronike të Qendrës Kombëtare të Bizneseve në rastet e personave juridikë të regjistruar në regjistrin tregtar<sup>42</sup>. Në rastin e shqyrtimit të rekursit, sekretaria e GjL-së njofton palët nëpërmjet afishimit në këndin e njoftimeve dhe faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjykimit të paktën 30 ditë përpara. Kur palët kanë adresa elektronike të deklaruara apo të njohura, sekretaria kryen njoftimin edhe në këto adresa<sup>43</sup>.

Lidhur me zhvillimin e seancës gjyqësore dhe pjesëmarrjen e të pandehurit, në rast se ky i fundit me sjelljen e tij pengon zhvillimin e rregullt të seancës, pavarësisht se gjykata ka vendosur t'i caktojë gjobë deri në shumën 30 000 lekë, gjykata mund të urdhërojë largimin e tij nga salla për një kohë të caktuar. Kur i pandehuri vijon të pengojë zhvillimin normal të gjykimit edhe pas kthimit, gjykata mund të urdhërojë largimin e tij deri në shpalljen e vendimit. Kur është e mundur, i pandehuri i larguar nga salla e ndjek seancën nëpërmjet lidhjes audio dhe/ose video<sup>44</sup>.

KL Gj ka raportuar se rritja e transparencës dhe efijencës për përdoruesit e brendshëm dhe të jashtëm të sistemeve të teknologjisë së informacionit përmes përmirësimeve të sistemeve aktuale gjyqësore ICMIS dhe ARKIT është një dimension i rëndësishëm i veprimtarisë së Komisionit. Për këtë qëllim, gjatë vitit 2022 janë mundësuar zhvillime të reja si dhe janë trajtuar 686 kërkesave për mbështetje teknike, ka përfunduar me sukses migrimi i gjithë bazës së të dhënave të 5 gjykatave të mëparshme të apelit në Gjykatën e Apelit të Juridiksionin të Përgjithshëm mundësuar në kuadër të zbatimit të Hartës së Re Gjyqësore, si dhe janë përcaktuar rregulla të hollësishme për ndarjen e çështjeve me short.<sup>45</sup>

## **5. Efektiviteti i hartës gjyqësore në kuadër të aksesit të qytetarëve në proceset gjyqësore dhe shërbimet administrative**

Një ndër qëllimet kryesore të Reformës në Drejtësi ishte garantimi i aksesit në drejtësi të qytetarëve, reduktimi i kostove, si dhe rritja e cilësisë dhe performancës në dhënien e drejtësisë, si një shërbim publik i barabartë për të gjithë qytetarët.

Në kushtet në të cilat ndodhet aktualisht sistemi ynë i drejtësisë, si pasojë e vakancave të shumta të krijuara si rrjedhojë e procesit të vetingut të magistratëve, burimeve gjithmonë

41. Neni 236/a i K.Pr.C.

42. Neni 436 i K.Pr.P.

43. Neni 436 i K.Pr.P.

44. Neni 436 i K.Pr.P.

45. Raporti vjetor për vitin 2022 i KLGJ-së

e më të pakta për plotësimin e këtyre vakancave nga ana e ShM, si dhe rritjes së backlog-ut të çështjeve gjyqësore në gjykata, gjë e cila cenon aksesin në drejtësi të qytetarëve, harta e re gjyqësore do të duhet të realizojë një ekuilibër të drejtë ndërmjet faktorëve të mëposhtëm:

- Garantimit të aksesit në drejtësi, që lidhet me afërsinë e individit me gjykatën;
- Uljen e kostove, me qëllim përdorimin me efektshmëri të burimeve publike;
- Rritjen e cilësisë dhe përshtatshmërisë së shërbimeve të ofruara.

Përpara miratimit të hartës së re gjyqësore, sistemi gjyqësor në Shqipëri përbëhej nga 29 gjykata të shkallës së parë, ku 22 ishin gjykata rrethi me juridiksion të përgjithshëm, 6 gjykata administrative dhe 1 gjykatë të posaçme, 8 gjykata apeli, ku 6 ishin gjykata apeli me juridiksion të përgjithshëm, 1 gjykatë administrative dhe 1 gjykatë e posaçme dhe 1 GjL.

Nëpërmjet Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 495, datë 21.7.2022 *“Për riorganizimin e rretheve gjyqësore dhe kompetencave tokësore të gjykatave”* është vendosur: riorganizimi i gjykatave të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm, nga njëzet e dy gjykata të rretheve gjyqësore në trembëdhjetë gjykata të tilla dhe riorganizimi i gjykatave administrative të shkallës së parë, nga gjashtë gjykata administrative në dy gjykata të tilla.

Sipas propozimit të KLGj-së, rezultatet e pritshme të reduktimit të numrit të gjykatave të shkallës së parë janë:

- Shërbime të përmirësuara për qytetarët, duke përqendruar shërbimet në gjykatat më të mëdha;
- Reduktimi i vonësave në procedurat gjyqësore dhe kohët e gjykimit.
- Zvogëlimi i ndjeshëm i delegimeve, që nënkupton një shpërndarje më të mirë të kohës gjyqësore, duke rritur kështu cilësinë dhe sasinë e vendimmarrjes.

Gjithashtu, vendimi i mësipërm i Këshillit të Ministrave ka vendosur riorganizimin e gjykatave të apelit të juridiksionit të përgjithshëm, nga gjashtë gjykata apeli, në një Gjykatë Apeli të Juridiksionit të Përgjithshëm, që organizohet dhe funksionon në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, me seli në qytetin Tiranë.

Sipas propozimit të KLGj-së, rezultatet e pritshme të reduktimit të numrit të gjykatave të apelit janë:

- Zvogëlimi i afatit kohor për shqyrtimin e mosmarrëveshjeve të regjistruara në gjykatat e shkallës së dytë.
- Uniformizimi i praktikës gjyqësore të gjykatës së apelit dhe vetë të praktikës gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë.
- Ulja graduale e numrit të çështjeve të prapambetura, nëpërmjet krijimit të shumë seksioneve me gjyqtarë të specializuar dhe rritjes të efikasitetit në ushtrimin e veprimtarisë gjyqësore.

- Lehtësira në menaxhimin nga KLGj të nevojave për gjyqtarë në gjykatat e apelit.

Miratimi i hartës së re gjyqësore është kundërshtuar nga shumë aktorë të drejtësisë, pasi harta e re e sistemit gjyqësor mund të cenojë të drejtën e qytetarëve për t’iu drejtuar gjykatës dhe mund të sjellë kosto më të larta gjyqësore për qytetarët. Riorganizimi dhe reduktimi i gjykatave mund të ndikojë në mënyrë të veçantë të personat që janë vulnerabel, të cilët janë në pamundësi financiare, të mitur, persona me aftësi të kufizuara, të cilët mund të kenë vështirësi në aksesimin e gjykatave.

Personat me aftësi të kufizuara apo ata që ndodhen në pamundësi ekonomiko-financiare nuk janë marrë në analizë në studimin e kryer dhe si pasojë duke qenë edhe pjesa më vulnerabel e shoqërisë mund të mbeten edhe më të diskriminuar në krahasim me qytetarët e tjerë. Mbyllja e një gjykate rrethi apo apeli qoftë mund të largojë profesionistët dhe shërbimet e nevojshme (ekspertë, noter, përkthyes etj.) nga ai vend dhe mund të çojë edhe në mungesë të theksuar shërbimesh e detyrojë këtë kategori që të mos ndërmarrin veprime për të kërkuar respektimin e së drejtës apo mbrojtjen e interesit të ligjshëm, ose t’i kenë këto veprime me kosto shtesë ndoshta edhe më të lartë për shkak të kufizimit fizik apo pamundësive të tjera në lëvizje.<sup>46</sup>

## 6. Monitorimi i respektimit të aksesit fizik në gjykata

Disa nga indikatorët për monitorimin e respektimit të gjendjes të aksesit fizik në gjykata janë pasqyruar në tabelat si më poshtë:

<i><b>Treguesit e realizimit</b></i>	<i><b>Po/Jo</b></i>
A kanë hartuar rregullore të brendshme institucionet e drejtësisë me qëllim garantimin e aksesit të plotë dhe efektiv për personat me aftësi të kufizuara?	
A janë vendosur pajisje/mekanizma të cilat bëjnë të mundur aksesin e plotë dhe efektiv për personat me aftësi të kufizuara të ambienteve të gjykatës?	
A është trajnuar administrata gjyqësore për ofrimin e shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara?	
A janë caktuar persona të cilët bëjnë të mundur shoqërimin e personave me aftësi të kufizuara në ambientet e gjykatës?	
A është e pajisur gjykata me hapësirë parkimi me vende të rezervuara për personat me aftësi të kufizuara?	
A janë vendosur pajisje/mekanizma të cilat bëjnë të mundur aksesin e plotë dhe efektiv për personat me aftësi të kufizuara të ambienteve të ofruesve të shërbimit të ndihmës juridike?	
A janë publikuar formularët e ndihmës juridike në format të aksesueshëm për personat me aftësi të kufizuara?	

46. Shih Alushaj, L “Harta e re gjyqësore me probleme të vjetra”, aksesuar në linkun <https://www.monitor.al/harta-e-re-gjyqesore-me-probleme-te-vjetra>

A rezulton që gjykatat të komunikojnë me mjete të përshatshme për dhënien e informacionit për personat me aftësi të kufizuara?	
Në rastin e personit nën hetim ose të pandehurit, a i është siguruar nga organi procedues e drejta të përdorë gjuhën e shenjave, si dhe të ndihmohet nga një interpretues nëse ka paaftësi të kufizuar në të folur dhe në të dëgjuar?	
Në rastin e të pandehurit që nuk dëgjon dhe nuk flet ose është me aftësi të kufizuara që e pengojnë për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, a i është siguruar mbrojtja e detyrueshme nga organi procedues duke i siguruar menjëherë një mbrojtës të paguar nga shteti?	
A është zbatuar nga organi procedues ndalimi i pyetjes në cilësinë e dëshmitarëve të personave që nuk janë në gjendje të bëjnë dëshmi të rregullt, për shkak të aftësive të kufizuara fizike ose psikike?	
Kur është marrë në pyetje një person që nuk flet ose nuk dëgjon në një proces civil ose administrativ dhe pyetja e tyre nuk mund të bëhet me shkrim, a ka thirrur gjykata një person që i kupton shenjat e personit që merret në pyetje?	
Në rastin kur paditësi/i padituri nuk fliste ose ishte me aftësi të kufizuara, që e pengonin për të realizuar vetë të drejtën e mbrojtjes, a ka mundur t'i realizojë plotësisht të drejtat procedurale?	
A ka pasur raste në të cilat nuk kanë përfituar ndihmës juridike subjekte të cilët përfshihen te kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike për shkak të aftësive të kufizuara mendore ose psikike?	
A është ulur/rritur numri i qytetarëve që kanë adresuar mosmarrëveshjet në gjykatë për shkak të rritjes së distancës ndërmjet vendbanimit/vendqëndrimit të tyre dhe gjykatës mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
A janë rritur/ulur kostot e qytetarëve për të zhvilluar një proces gjyqësor mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
A është ulur/rritur numri i qytetarëve që kanë paraqitur ankim pranë Gjykatës së Apelit për shkak të rritjes së distancës ndërmjet vendbanimit/vendqëndrimit të tyre dhe gjykatës mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
A është ulur/rritur numri i qytetarëve që kanë marrë pjesë në seancën gjyqësore për shqyrtimin e ankimit pranë Gjykatës së Apelit për shkak të rritjes së distancës ndërmjet vendbanimit/vendqëndrimit të tyre dhe gjykatës mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
A janë rritur/ulur kostot e qytetarëve për të ndjekur shqyrtimin e ankimit pranë Gjykatës së Apelit mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
A është kryer nga gjykata e shkallës së parë njoftimi i palës e cila ka regjistruar të dhënat e saj elektronike të kontaktit me mjete të komunikimit elektronik për ditën dhe orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton çështjen?	
A është kryer njoftimi në adresën e re të deklaruar nga palët në rast se palët kanë ndryshuar të dhënat elektronike të kontaktit të tyre?	

A është kryer njoftimi me shpallje në faqen zyrtare në internet të gjykatës, dhe/ose në një portal elektronik kombëtar të krijuar për këtë qëllim?	
A është pasqyruar njoftimi me mjete të komunikimit elektronik në një proces-verbal të posaçëm?	
A është kryer nga Gjykata e Apelit njoftimi me mjete të komunikimit elektronik për ditën dhe orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton çështjen e palës e cila ka lënë të dhënat e saj elektronike të kontaktit në shkallën e parë të gjykimit?	
A është kryer nga GjL njoftimi me mjete të komunikimit elektronik për ditën dhe orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton çështjen i palës, e cila ka lënë të dhënat e saj elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit?	
A u respektua e drejta e mbrojtjes, barazia e armëve dhe kontradiktoriteti në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit?	
A ishte e mundur për palët të komunikojnë me gjykatën për paraqitjen e shpjegimeve/prapësimeve në mënyrë elektronike?	
A u respektuan detyrimet që burojnë nga legjislacioni për mbrojtjen e të dhënave personale në shqyrtimin e mosmarrëveshjeve nëpërmjet përdorimit të teknologjisë së informacionit?	

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Përqindje</i>
A kanë informacion personat me aftësi të kufizuara mbi të drejtat e tyre dhe si të kërkojnë këto të drejta?	
A janë të efektshme rregulloret e brendshme të hartuara nga institucionet e drejtësisë me qëllim garantimin e aksesit të plotë dhe efektiv për personat me aftësi të kufizuara?	
A janë të efektshme pajisjet/mekanizmat e vendosura nga institucionet e drejtësisë me qëllim aksesin e ambienteve të tyre nga personat me aftësi të kufizuara?	
Sa është niveli i kënaqësisë së përfituesve për cilësinë e shërbimit ligjor të përfituar nga çdonjëri nga subjektet e parashikuar në ligj për ofrimin e ndihmës juridike parësore dhe dytësore?	
Cili është raporti i rasteve në të cilat kërkesat për ndihmë juridike dytësore dhe përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore për shkak të aftësive të kufizuara mendore ose psikike të kërkuesit, janë rrëzuar nga gjykatat e shkallëve të para dhe vendimet janë ndryshuar nga Gjykata e Apelit?	
Sa është niveli i kënaqësisë së qytetarëve me shërbimet administrative të ofruara nga gjykatat mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
Sa përqind janë rritur kostot e qytetarëve për të ndjekur shqyrtimin e ankimit pranë Gjykatës së Apelit?	
Sa është niveli i kënaqësisë së qytetarëve me shërbimet administrative të ofruara nga gjykatat mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	

Sa është niveli i kënaqësisë së qytetarëve me vendimmarrjen e Gjykatës së Apelit mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
Sa është niveli i vendimeve të Gjykatës së Apelit të lëna në fuqi, të ndryshuara dhe të prishura nga GjL mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
Sa është niveli i kënaqësisë së juristëve dhe avokatëve lidhur me përmirësimin e uniformizimit të praktikës gjyqësore të gjykatës së apelit dhe praktikës gjyqësore të gjykatave të shkallës së parë mbas zbatimit të hartës së re gjyqësore?	
Cili është raporti i seancave të zhvilluara në salla dhe zyra?	
Cili është raporti i seancave të regjistruara në sistem audio dhe të regjistruara në mënyrë manuale?	
Në cilën masë janë plotësuar nga KLP dhe KLGj rekomandimet e përcjella në rezolutën e miratuar nga Kuvendi për raportet e tyre vjetore?	
Në cilën masë janë plotësuar nga KLGj rekomandimet për përmirësimin e efikasitetit të gjykatave ose për zvogëlimin e ngarkesës së punës së gjyqtarëve dhe personelit të gjykatës?	

#### **Metodat për zhvillimin e monitorimit:**

- Analiza e raportit vjetor të KLGj-së mbi gjendjen e sistemit gjyqësor dhe veprimtarinë e KLGj-së.
- Analiza e raportit vjetor të KLGj-së vjetor për ngarkesën e çështjeve gjyqësore dhe të punës së gjykatave për vitin kalendarik të mëparshëm.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e vjetarit statistikor të MD-së.
- Paraqitja e kërkesave për informacion.
- Monitorimi në ambientet e gjykatave.
- Zhvillimi i sondazheve lokale dhe kombëtare.
- Paraqitja e kërkesave për informacion.
- Analiza e vendimeve të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e dispozitave ligjore për procedimin dhe gjykimin penal të personave nën hetim ose të pandehurve me aftësi të kufizuara mendore ose psikike.
- Këqyrja e faqeve zyrtare në internet të DNJF dhe MD.



## MODULI IV

### EFEKTIVITETI I SË DREJTËS SË ANKIMIT

#### 1. Hyrje

Në nenin 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë deklarohet shprehimisht se “Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveç se kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”.

E drejta e ankimit në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, duhet kuptuar si një mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar në një gjykatë më të lartë vendimin e dhënë ndaj tij nga një gjykatë më e ulët. Pra, me Kushtetutë, kujdo i garantohet e drejta për t’u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është edhe një tejkalim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim KEDNj. Në nenin 6 të kësaj Konvente nuk parashikohet e drejta për të pretenduar mjete ankimi kundër vendimeve gjyqësore, e për pasojë, as detyrimi i shteteve palë për të ngritur gjykata apeli ose rishikimi (Gjykata të Larta ose Kasacioni)<sup>47</sup>.

Megjithatë, në nenin 2 të Protokollit 7 të Konventës, vetëm për çështjet penale, është parashikuar e drejta e çdo personi të dënuar për kryerjen e një veprë penale që të paraqesë të paktën një herë për shqyrtim në një gjykatë më të lartë çështjen e deklarimit të fajësisë ose të masës së dënimit të tij. Por, sipas paragrafit të dytë të nenit 2 të Protokollit 7 të Konventës, edhe në këto raste, shtetet palë kanë liri mjaft të gjerë vlerësimi dhe veprimi për të përjashtuar nga e drejta e ankimit vepra të lehta penale ose rastet kur personi është gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, etj. Madje, edhe në rastet kur parashikohet shprehimisht e drejta e ankimit në çështjet penale, ato (pra shtetet palë) janë të lira ta vlerësojnë e lejojnë atë edhe për çështje të faktit dhe të ligjit ose ta kufizojnë vetëm për çështje të ligjit.<sup>48</sup>

E drejta e ankimit nuk është një e drejtë absolute, ajo mund të kufizohet me ligj, për shkak të një interesi publik dhe duke mos cenuar vetë thelbin e së drejtës. Edhe në kuadrin ligjor të brendshëm janë parashikuar rastet kur ndaj një vendimi nuk mund të ushtrohet ankimi.

Neni 6 § 1 nuk i detyron shtetet kontraktuese të krijojnë gjykata apeli ose kasacioni. Sidoqoftë, një shtet që ka krijuar gjykata të kësaj natyre ka detyrimin të kujdeset që ndërgjyqësit të përfitojnë nga garancitë themelore të nenit 6 § 1 (Platakou c. Grèce, § 38):<sup>49</sup>

47. Vendim Frowein–Peukert, EMRK–Komentar, 2.Auflage, Engel Verlag 1996, f.209.

48. Vendim Krombach kundër Francës, datë 13.02.2001 GjEDNj.f

49. Shih Udhëzues mbi nenin 6 të KEDNj-së. E drejta për një proces të rregullt ligjor (aspekti civil), Këshilli i Evropës, 2013.

Hierarkia e sistemit gjyqësor në Shqipëri përbëhet nga 3 shkallë gjykimi - gjykata e shkallës së parë, gjykata e apelit, gjykata e lartë dhe në rastin e pretendimeve në lidhje me cenimin e procesit të rregullt ligjor dhe GjK. Në K.Pr.C., K.Pr.P. dhe ligjin nr. 49/2012 janë parashikuar rregullat, afatet dhe mjetet për të kundërshtuar në gjykatën më të lartë një vendim të gjykatës më të ulët.

Referuar këtyre parashikimeve, mjetet e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor janë:

- *Ankimi në Gjykatën e Apelit* - Ankimi është akti me të cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës dhe veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre. (neni 442/a K.Pr.C)
- *Rekursi në Gjykatën e Lartë* - Rekursi është akti me të cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ose të gjykatës së apelit në GjL, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod. (442/b K.P.C)
- *Kërkesa për rishikim* - Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. (neni 494 K.P.C)

Në varësi të llojit të vendimit, natyrës së çështjes, janë parashikuar afate specifike për dërgimin e çështjes në një gjykatë më të lartë, përmbajtja që duhet të ketë ankimi, provat që duhet t'i bashkangjiten, me efekt mos pranimit për shqyrtim nga gjykatë.

## **2. E drejta e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore në çështjet civile**

### **2.1 Ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë**

Në K. Pr.C. nga neni 442 deri në nenin 471/a janë parashikuar afatet e ankimit të vendimit në Gjykatën e Apelit, procedura dhe kufijtë e zhvillimit të gjykimit në apel, vendimmarrja e gjykatës së apelit.

Në Kod janë parashikuar dy afate për paraqitjen e ankimit në gjykatën e apelit ndaj një vendimi të gjykatës së shkallës së parë:

- *Afati 15 ditë* - për vendime përfundimtare (që është vendosur pranimin/rrëzimin e padisë;
- *Afati 5 ditë* - konsiderohet ankim i veçantë dhe në parim u referohet ankimeve ndaj vendimeve jopërfundimtare ose vendimeve të ndërmjetme (p.sh. vendimi i pushimit, vendimi për marrjen e masës së sigurimit etj. Në rastet kur ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim i veçantë, është parashikuar nga vetë dispozita në mënyrë eksplicite.

Afati për të paraqitur ankimin fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të arsyetuar, prandaj është shumë e rëndësishme që gjykatat të arsyetojnë vendimet në një kohë shumë të shpejtë dhe brenda afateve të parashikuara në ligj. Kur palët kanë humbur të drejtën e ankimit për shkaqe të arsyeshme, mund të paraqesin kërkesë për rivendosje në afat, përpara gjykatës që ka dhënë vendimin.

Pala që nuk ka bërë ankim apo pala kundër së cilës është bërë ankimi, mund ta kundërshtojë atë me kundërankim brenda 5 ditëve nga dita që ka marrë njoftim për ankimin e palës tjetër (neni 456 K.Pr.C).

Ankim duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- a) palët ndërgjyqëse;
- b) vendimi kundër të cilit bëhet ankimi;
- c) shkaqet për të cilat bëhet ankimi;
- ç) çfarë kërkohet me ankimin.

Ankimi duhet të paraqitet në një kopje për gjykatën dhe aq kopje sa janë personat që marrin pjesë në çështje si palë, si dhe prokura kur ankimi paraqitet nga avokati ose përfaqësuesi i palës. Nëse avokati ka paraqitur prokurën në shkallë të parë, nuk është e nevojshme paraqitja e prokurës. Ankimi paraqitet në gjykatën e shkallës së parë që ka shqyrtuar çështjen. Në rast se ankimi nuk plotëson kushtet e mësipërme, gjykata njofton palën që të ndreqë të metat brenda 5 ditëve, në të kundërt ankimi kthehet (neni 455 K.Pr.C.).

Verifikimi i plotësimin të kushteve dhe elementeve të ankimit, afatit të paraqitjes, njoftimi i ankimit dhe apelit kundërshtues palëve ndërgjyqëse shqyrtohen në dhomë këshillimi nga gjyqtari i shkallës së parë që ka dhënë vendimin (neni 450 K.Pr.C.).

Pas verifikimit dhe realizimit të veprimeve të mësipërme, sekretaria e gjykatës së shkallës së parë depoziton në gjykatën e apelit ankimin, apelin kundërshtues (nëse ka), vendimin e gjykatës së shkallës së parë, ndaj të cilit është bërë ankim së bashku me dosjen gjyqësore.

Pas regjistrimit të çështjes në gjykatën e apelit, caktohet me short relatori i çështjes, i cili cakton datën dhe orën e gjykimit në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën, sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit.

Bazuar në nenin 460 pika 2 e K.Pr.C. dhe vendimit nr.78, datë 30.05.2019 të KLGj-së kur njëra nga palët kërkon përshpejtimin e çështjes për shkaqe të motivuara dhe veçanërisht të rënda, si dhe plotësohen kushtet për shqyrtimin e çështjes në një afat më të shpejtë, relatori merr vendim për pranimin e kërkesës për përshpejtimin e gjykimit të çështjes dhe cakton një datë dhe orë të seancës.

Njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton çështjen bëhet nga gjykata e apelit:

a) *Me shpallje:*

- Në ambientet e saj dhe në gjykatën përkatëse të shkallës së parë;
- Në faqen e internetit të gjykatës së apelit, si dhe, nëse ka, edhe në faqen e internetit të gjykatës përkatëse të shkallës së parë;

b) *Me njoftim individual* - Në rastin kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat elektronike të kontaktit në shkallën e parë të gjykimit.

Shpallja ose njoftimi bëhet të paktën 15 ditë para datës së gjykimit. Në rast se përbërja e trupit gjykues nuk është njoftuar sipas rregullave të përcaktuara në këtë pikë, palët mund të kërkojnë shtyrjen e gjykimit, përveç rasteve kur marrin pjesë në gjykim dhe nuk kërkojnë përjashtimin e gjyqtarëve. Palët kanë të drejtë që deri në 5 ditë para shqyrtimit të çështjes të paraqesin parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim. (neni 460 K.Pr.C.)

Gjykata e apelit gjykon dhe si gjykatë fakti dhe si gjykatë ligji, që do të thotë që gjykata e apelit brenda kufijve të pretendimeve të paraqitura në ankim shqyrton nëse gjykata e shkallës së parë ka zhvilluar një proces të rregullt ligjor, ka zbatuar dhe interpretuar drejt ligjin material dhe procedural, si dhe ka vlerësuar drejt provat dhe pretendimet e palëve.

Në rastet kur gjykata e apelit konstaton që janë cenuar dispozitat dhe parimet e gjykimit të drejtë, mund të kthejë çështjen për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë. Gjykata zhvillon gjykimin në dhomë këshillimi ose seancë gjyqësore. Në të dyja rastet duhet të njoftojë palët për datën dhe orën e gjykimit sipas mënyrave të sipërcituara. Mosnjoftimi i palëve për orën, datën, trupin gjykues përbën shkak për shtyrjen e seancës dhe nëse procesi zhvillohet pa realizuar në mënyrë të rregullt njoftimin, përbën shkelje të procesit të rregullt ligjor; konkretisht cenon aksesin në drejtësi dhe të dejtën për t'u dëgjuar nga gjykata.

Seanca gjyqësore fillon me relacionin e njërit prej anëtarëve të trupit gjykues. Pas kësaj palët, në rast se janë paraqitur, japin shpjegime. Së pari e merr fjalën pala që ka bërë ankimin, pastaj pjesëmarrësit e tjerë në gjykim. Kur ky ka paraqitur mendimin me shkrim, lexohet nga një anëtar i trupit gjykues. Kur prokurori, mbi bazën e padisë së paraqitur prej tij, bën ankim ndaj vendimit të gjykatës, ai e merr fjalën i pari. (neni 464 K.Pr.C.).

Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor gjykata vendos:

- Lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;
- Ndryshimin e vendimit;
- Prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes;
- Prishjen e vendimit dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në gjykatën e shkallës së parë në rastet e parashikuara nga neni 467 iK.Pr.C.

Nëse shikojmë shkaqet e prishjes së vendimit dhe dërgimit të çështjes për rigjykim në

gjykatën e shkallës së parë, konstatojmë që një pjesë e shkaqeve lidhen me mosrespektim të ligjit procedural dhe cenim të procesit të rregullt ligjor, prandaj është thelbësore respektimi i rregullave procedurale dhe elementeve të procesit të rregullt ligjor, pasi nuk përbën shkak vetëm për prishjen e vendimit por ndikon dhe në cenimin e gjykimit të çështjes brenda afatit të arsyeshëm.

## 2.2 Rekursi ndaj vendimeve të gjykatës së apelit

GjL është instanca më e lartë ankimese për çështjet civile, administrative dhe penale në Shqipëri, që gëzon kompetencën për të prishur (latinisht: “cassare”) vendimet e gjykatave më të ulëta. Roli i GjL-së si “Gjykatë Kasacioni” parashikohet nga neni 141 i Kushtetutës ku sanksionohet se GjL shqyrton çështje lidhur me kuptimin dhe zbatimin e ligjit për të siguruar njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, sipas ligjit. Pra, gjykimi kasacional nënkupton shfuqizimin e një vendimi gjyqësor mbi bazën e një mjeti ligjor. Gjykata nuk mund të vendosë zgjidhjen e ndryshme të çështjes duke marrë prova të reja, por ka të drejtë vetëm ta kthejë për gjykim çështjen në gjykatën kompetente, vendimi i së cilës shfuqizohet. Gjykata e Kasacionit shqyrton dhe analizon ligjin dhe rrethanat e çështjes vetëm për atë që sa i nevojitet asaj për të interpretuar ligjin ose një koncept të së drejtës, pa bërë një shqyrtim të ri të fakteve dhe provave. Në këtë kuptim, funksioni i GjL-së sot është të kontrollojë nëse ligji është interpretuar dhe zbatuar në mënyrë korrekte nga gjykatat më të ulëta, vendimi i të cilave kundërshtohet. GjL-ja nuk ka si thelb të veprimtarisë së saj shqyrtimin e fakteve dhe të provave në një çështje konkrete, por në raste të caktuara në lidhje dhe për atë që ndihmon Gjykatën të interpretojë ligjin e zbatueshëm.<sup>50</sup>

Nëse pala pretendon që gjykata e apelit ka zbatuar dhe interpretuar gabim ligjin material ose procedural, të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore, kur vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika gjyqësore e Kolegjit Civil ose praktika e njehsuar e Kolegjeve të Bashkuara të GjL-së, ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjykimit, ka të drejtë të ushtrojë të drejtën e rekursit në GjL.

Rekuret për çështje civile, shqyrtohen nga Kolegji Civil i GjL-së. Në K.Pr.C. janë parashikuar dy afate për paraqitjen e rekursit ndaj një vendimi të gjykatës së apelit:

- *Afati 30 ditë* - Për vendime përfundimtare (që është vendosur pranimin/rrëzimin e padisë;
- *Afati 5 ditë* - Konsiderohet rekurs i veçantë dhe në parim u referohet ankimeve ndaj vendimeve jopërfundimtare ose vendimeve të ndërmjetme (p.sh. Vendimi i pushimit, vendimi për marrjen e masës së sigurimit etj. Në rastet kur ndaj vendimit mund të ushtrohet ankim i veçantë, është parashikuar nga vetë dispozita në mënyrë eksplicite.

50. Shih “Udhëzues për paraqitjen dhe shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë”, aksesuar në linkun [http://www.gjykatelarte.gov.al/web/rregullat\\_e\\_rekursit\\_ne\\_gjl\\_2021\\_5779.pdf](http://www.gjykatelarte.gov.al/web/rregullat_e_rekursit_ne_gjl_2021_5779.pdf)

Në kod është parashikuar kufizim për ushtrimin e rekursit në rastin e padive me vlerë deri në 150 000 lekë, që do të thotë edhe nëse pretendoni që gjykata e shkallës së parë ose gjykata e apelit ka shkelur rëndë ligjin material ose procedural, vendimi i apelit përbën vendimin përfundimtar dhe të formës së prerë, dhe nuk mund t'i drejtohesh GjL-së për të konstatuar dhe shqyrtuar këto shkelje. (neni 472/2 K.Pr.C.).

Rekursi duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- a) palët ndërgjyqëse;
- b) vendimin që kundërshtohet;
- c) paraqitjen e përmbledhur të fakteve të çështjes;
- ç) shkaqet për të cilat kundërshtohet vendimi, si dhe argumentet që mbështesin pretendimin se ekzistojnë shkaqe për recurs sipas parashikimeve të nenit 472 të këtij Kodi;
- d) prokurën nëse recursi është bërë nga avokati ose nga përfaqësuesi i ankuesit. Recursi mund të paraqitet sipas formatit të miratuar nga KLGj.

Rekursi depozitohet në sekretarinë e gjykatës që ka dhënë vendimin, parimisht në gjykatën e apelit, brenda afatit prej 30 ditësh nga dita e njoftimit që u është bërë palëve. Së bashku me rekursin duhet të depozitohet:

- a) *kopja e vërtetuar e vendimit të kundërshtuar dhe, kur është rasti, edhe e njoftimit kur ky është bërë;*
- b) *prokura e posaçme;*
- c) *aktet dhe dokumentet mbi të cilat është bazuar recursi në atë kopje sa janë palët.*

Kur recursi nuk plotëson kushtet e parashikuara dhe nuk është nënshkruar ose nuk është paraqitur në përputhje me parashikimet e mësipërme, relatori që ka dhënë vendimin ose gjyqtari i vetëm njofton palën për të plotësuar të metat e rekursit brenda 5 ditëve. Në këtë rast shqyrtimi i rekursit bëhet në dhomë këshillimi. Kur ankuesi nuk plotëson ose korrigjon të metat brenda afatit, recursi quhet se nuk është paraqitur dhe i kthehet palës së bashku me aktet e tjera të paraqitura prej tij. Kur të metat e rekursit janë plotësuar në afatin e caktuar, konsiderohet i regjistruar në datën e depozitimit në gjykatë. (neni 475, 476, 480 K.Pr.C.).

Pas regjistrimit të çështjes në GjL, çështja hidhet në short dhe caktohet relatori, i cili vendos datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në përputhje me rregullat e planifikimit të gjykimit të parashikuara në ligj. (482/1 K.Pr.C.).

Shqyrtimi i çështjes në GjL, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Gjyqtari relator i caktuar me short vendos datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në përputhje me rregullat e planifikimit të gjykimit të parashikuara në

ligj. Palët mund t'i kërkojnë me shkrim relatorit përshpejtimin e shqyrtimit të çështjes për shkaqe veçanërisht të rënda dhe të motivuara, kur kjo nuk vjen në kundërshtim me ligjin.

Sekretaria e GjL-së shpall listat e shqyrtimit të rekurseve të paktën 15 ditë përpara datës së shqyrtimit. Njoftimi për ditën, orën, si dhe përbërjen e trupit gjykues që shqyrton rekursin bëhet me:

- *Shpallje në ambientet e GjL-së;*
- *Publikim në faqen e internetit të GjL-së;*
- *Me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit.*

Gjykata pas diskutimit të çështjes tërhiqet në dhomën e këshillimit dhe merr vendimin përkatës. Në raste të veçanta, për shkak të natyrës së ndërlikuar apo rëndësisë së çështjes, marrja e vendimit mund të shtyhet për aq ditë sa është e nevojshme.

Kolegji Civil, kryesisht ose me kërkesë të palëve, mund të vendosë nisjen e procedurës së gjykimit për të njëzuar ose ndryshuar praktikën gjyqësore. Nisja e procedurës për ndryshimin e praktikës gjyqësore mund të vendoset edhe nga Kryetari i GjL-së. Gjykimi për njësimin e praktikës gjyqësore bëhet nga Kolegji Civil me trup gjykues prej 5 gjyqtarësh, në të cilin marrin pjesë trupi gjykues që po gjykon rekursin dhe dy gjyqtarë të tjerë të Kolegjit, të caktuar me short. Gjykimi për ndryshimin e praktikës gjyqësore të njëzuar bëhet nga Kolegjet e Bashkuara të GjL-së. Kryetari i GjL-së, si kryesues i Kolegjeve të Bashkuara, cakton datën dhe orën e gjykimit të çështjes për ndryshimin e praktikës gjyqësore. Kolegjet e Bashkuara të GjL-së gjykojnë sipas rregullave të caktuara për kolegjin kur marrin pjesë jo më pak se dy të tretat e të gjithë anëtarëve të GjL-së. (Neni 481 K.Pr.C.)

Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të GjL-së vendosin:

- a. mospranimin e rekursit në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 472 i K.Pr.C.;
- b. prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;
- c. prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues;
- a. prishjen e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë kur vendimi jopërfundimtar i gjykatës së shkallës së parë është marrë në kundërshtim me ligjin dhe kjo shkelje nuk është konstatuar nga gjykata e apelit;
- a. prishjen e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes;

- b. ndryshimin e vendimit të shkallës së parë dhe të vendimit të gjykatës së apelit dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes kur zbatimi i ligjit procedural apo material nuk diktohet nga nevoja për rishqyrtimin dhe rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes;
- c. lënien në fuqi të vendimit të apelit.

Në rastet kur Kolegji Civil ose Kolegjet e Bashkuara të GjL-së vendosin njësimin ose ndryshimin e praktikës gjyqësore, në vendim gjykata formulon edhe rregullin e së drejtës për çdo çështje të shtruar për zgjidhje në vendimin e ndërmjetëm të marrë gjatë gjykimit të çështjes. Në këtë rast vendimi botohet në Fletoren Zyrtare. (neni 481 pika 3&4 K.Pr.C).

### **2.3. Kërkesa për rishikimin e vendimit gjyqësor të formës së prerë**

Në nenin 451/a të K.Pr.C. është parashikuar se: *“Vendimi që ka marrë formë të prerë është i detyrueshëm për palët, për trashëgimtarët e tyre, për personat që heqin të drejta nga palët, për gjykatën që ka dhënë vendimin dhe për të gjitha gjykatat dhe institucionet e tjera. Vendimi që ka marrë formë të prerë ka fuqi vetëm për ç’ka është vendosur midis po atyre palëve për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak. Një konflikt që është zgjidhur me vendim të formës së prerë nuk mund të gjykohet përsëri, përveç kur ligji e parashikon ndryshe”.*

Referuar dispozitës vendimi gjyqësor i cili ka marrë formë të prerë përbën gjë të gjykuar/res judicata, që do të thotë që i njëjti konflikt gjyqësor, midis të njëjtave palë nuk mund ti nënshtrohet dhe njëherë shqyrtimit gjyqësor.

Vendimi gjyqësor i formës së prerë që përbën gjë të gjykuar është shprehje e konkretizim i të drejtës mbi marrëdhënien juridike dhe ka qëllim t’i japë jo vetëm qartësi, por dhe siguri kësaj marrëdhënie. Cenimi i parimit të gjësë së gjykuar do të çonte në cenimin e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetuese e ligjore të garantuara nga neni 42 i Kushtetutës, pra në cenim të vetë sigurisë juridike. Siguria juridike nënkupton, ndërmjet të tjerash, garantimin e besueshmërisë së individit të shteti, institucionet e tij dhe të aktet që ato nxjerrin. Ndërsa, në kontekstin e çështjes në shqyrtim, siguria juridike nënkupton që, në rastet kur gjykata ka vendosur përfundimisht për një çështje, vendimi i saj nuk duhet të vihet në dyshim. Në këtë aspekt, GjK çmon se gjëja e gjykuar përfshin jo vetëm urdhërimet e dispozitivit të vendimit gjyqësor, por dhe vërtetimet e fakteve dhe zbatimin e së drejtës, të përcaktuara në pjesën përshkruese arsyetuese të vendimit me kusht, që të jenë kryer me qëllim të dhënies së vendimit gjyqësor dhe t’u përkasin fakteve ose marrëdhënieve që kanë formuar objektin e gjykimit mbi të cilin gjykata ka dhënë vendimin e saj.”<sup>51</sup>

Rishikimi i vendimeve është një mjet i jashtëzakonshëm për goditjen e vendimeve dhe ka për qëllim rishikimin e çështjes së përfunduar me vendim të formës së prerë, për shkak se vendimi i gjykatës është i gabuar përse i përket çmuarjes së faktit<sup>52</sup>.

51. Shih Vendimin nr.2, datë 16.01.2013 të GjK-së; Vendimin nr. 24, datë 21.11.2008 të GjK-së; Vendim nr.29, datë 21.12.2006 të GjK-së; Vendimin Nr. 5, datë 2 .02.2001 të GjK-së.

52. Shih Vendimin Unifikues nr. 1, datë 31.01.2006 të Kolegjeve të Bashkuara të GjL-së.



Rishikimi gjyqësor si institut është një mjet për të kundërshtuar një vendim gjyqësor që ka marrë formë të prerë. Kjo e drejtë procedurale, që përbën një mjet të jashtëzakonshëm ankimi, bëhet vetëm për shkaqe të parashikuara në nenin 494 të K.Pr.C. dhe është e kufizuar, pasi ka të bëjë me një situatë të supozuar jonormale, e cila e ka penguar gjykatën që të zbatojë drejt ligjin dhe të zgjidhë drejt çështjen. Kjo e drejtë procedurale në mënyrë që të jetë efektive dhe të merret në shqyrtim nga ana e GjL-së (në rast se plotësohen kushtet e parashikuara në nenin 494 të K.Pr.C.), duhet të ushtrohet nga pala e interesuar brenda afateve të parashikuara shprehimisht në ligj, konkretisht në nenin 496 të K.Pr.C.<sup>53</sup>

Nisur nga natyra që paraqet kërkesa për rishikim, e cila konsiderohet “si mjet i jashtëzakonshëm” për efekt të sigurisë juridike, ajo nuk mund të paraqitet sa herë që palët që kanë marrë pjesë në një gjykim gjejnë nga një provë të re dhe sa herë që ato mendojnë se fakte, prova, dëshmitare apo ngjarje, të cilat i nënshtroreshin gjykimit të zakonshëm duhet të trajtohen në kërkesën për rishikim. Kërkesa për rishikim në të cilën jepet shkaku/shkaqet e rishikimit dhe që parashikohet nga neni 494 i K.Pr.C. paraqitet vetëm brenda afateve dhe kushteve të parashikuara shprehimisht në ligj.”

Në nenin 494 të K.Pr.C. parashikohen rastet se kur mund të bëhet rishikimi i një vendimi gjyqësor, i cili ka marrë formë të prerë, konkretisht parashikohet se: *“Kërkesa për rishikim është akti me të cilin kërkohet rishikimi i një vendimi të formës së prerë të gjykatës. Pala e interesuar mund të kërkojë rishikimin e një vendimi që ka marrë formë të prerë, kur:*

- a. zbulohen rrethana të reja apo prova të reja me shkresë që kanë rëndësi për çështjen, të cilat nuk mund të dihen nga pala gjatë shqyrtimit të saj;*
- b. vërtetohet se thëniet e dëshmitarëve apo mendimet e ekspertëve, mbi të cilat është bazuar vendimi, kanë qenë të rreme;*
- c. palët ose përfaqësuesit e tyre apo ndonjë anëtar i trupit gjykues, që ka marrë pjesë në gjykimin e çështjes, kanë kryer vepra të dënueshme penalisht, të cilat kanë ndikuar në dhënien e vendimit;*
- d. vërtetohet se vendimi i dhënë është bazuar në dokumente të falsifikuara;*
- e. vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës ose të një institucioni tjetër që më pas është prishur;*
- f. vendimi është në kundërshtim të hapur me një vendim tjetër të formës së prerë të dhënë midis po atyre palëve, për të njëjtin objekt dhe për të njëjtin shkak.*
- g. kur GjEDNj gjen shkelje të konventës europiane “Për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” dhe të protokolleve të saj, të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë”.*

Kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga dita që pala provon se ka marrë dijëni për shkakun e rishikimit. Në rastet e parashikuara në nenin 495, afati prej 30 ditësh fillon nga dita që vendimi ka marrë formën e prerë. (neni 496 K.Pr.C).

53. Shih vendimin nr. 370, datë 11.06.2013 të Kolegjit Civil i GjL-së;

Kërkesa për rishikim paraqitet para gjykatës së shkallës së parë që ka dhënë vendimin, por në rast se vendimi është ankimuar në gjykatat më të larta, kompetente është gjykata më e lartë që ka shqyrtuar çështjen në themel. Gjykata kompetente për shqyrtimin e kërkesës për rishikim gjykon sipas rregullave të zbatueshme për atë shkallë gjykim (neni 497 K.Pr.C).

### **3. E drejta e ankimit ndaj vendimeve gjyqësore në çështjet administrative**

Mjetet dhe afatet e ankimit të vendimeve të gjykatave administrative janë të njëjta me ato të parashikuara në K.Pr.C., përveç kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Procedura për ankimet dhe zhvillimin e gjykimit në apel parashikohen në ligjin nr.49/2012. Afatet për të paraqitur ankim ose rekurs janë të njëjta me afatet e parashikuara në K.Pr.C, të analizuara në pikën 2 të këtij moduli.

#### **3.1 Ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë**

Ligji ka parashikuar disa kufizime për të drejtën e ankimit ndaj një vendimi gjyqësor me natyrë administrative, ku ndaj disa vendimeve nuk mund të bëhet ankim në apel, si rrjedhojë me përfundimin e gjykimit në shkallë të parë këto vendime marrin formë të prerë dhe janë të ekzekutueshme nga përmbaruesi gjyqësor.

Nuk mund të ushtrohet e drejta e ankimit ndaj vendimeve (neni 45 ligji nr. 49/2012):

- a. Kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;
- b. Kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;
- c. Kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;
- d. Mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se njëzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.

Përveç rasteve të mësipërme, palët kanë të drejtë të ankimojnë vendimin e shkallës së parë, i cili duhet të përmbajë elementet e mëposhtme:

- a) palët ndërgjyqëse;
- b) vendimi kundër të cilit bëhet ankimi;
- c) shkaqet për të cilat bëhet ankimi;
- ç) çfarë kërkohet me ankimin. Ankimi duhet të paraqitet në një kopje për gjykatën dhe aq kopje sa janë persomat që marrin pjesë në çështje si palë, si dhe prokura kur ankimi paraqitet nga avokati ose përfaqësuesi i palës. Nëse avokati ka paraqitur

prokurën në shkallë të parë nuk është e nevojshme paraqitja e prokurës. Ankimi paraqitet në gjykatën e shkallës së parë që ka shqyrtuar çështjen. Në rast se ankimi nuk plotëson kushtet e mësipërme, gjykata njofton palën që të ndreqë të metat brenda 5 ditëve, në të kundërt ankimi kthehet.

Verifikimi i plotësimit të kushteve dhe elementeve të ankimit, afatit të paraqitjes, njoftimi i ankimit dhe apelit kundërshtues palëve ndërgjyqëse shqyrtohen në dhomë këshillimi nga gjyqtari i shkallës së parë që ka dhënë vendimin (neni 46 i ligjit nr. 49/2012).

Gjykata, ku është paraqitur ankimi, dërgon ankimin, së bashku me aktet që i bashkëlidhen atij, vendimin e gjyqtarit për pranimin e ankimit, aktet e komunikimit të ankimit, si dhe dosjen e gjykimit në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 15 ditëve nga data e depozitimit të ankimit.

Shqyrtimi i ankimit në Gjykatën Administrative të Apelit si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomën e këshillimit, por në rastet kur gjykata çmon se debati gjyqësor është i nevojshëm për të vlerësuar çështjen, duhet të merren prova të reja etj. dhe zhvillon gjykimin në seancë gjyqësore. (neni 49, 51 i ligjit 49/2012)

Kryetari i trupit gjykues përgatit relacionin dhe cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Njoftimi bëhet nga sekretaria e gjykatës, e cila njofton palët për përbërjen e trupit gjykues, datën, orën dhe vendin e shqyrtimit të çështjes të paktën 15 ditë përpara me:

- *Shpallje në ambientet e Gjykatës Administrative të Apelit;*
- *Publikim në faqen e internetit të Gjykatës Administrative të Apelit;*
- *Me njoftim individual kur palët ose përfaqësuesit e tyre kanë lënë të dhënat e tyre elektronike të kontaktit në shkallët e tjera të gjykimit.*

Palët kanë të drejtë të paraqesin deri 5 ditë para seancës së shqyrtimit të çështjes parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim dhe kundërankim.

Gjykata Administrative e Apelit shqyrton çështjen brenda 30 ditëve nga data e ardhjes së ankimit nga gjykata ku është paraqitur ankimi.

Gjykata Administrative e Apelit në dhomë këshillimi vendos:

- a. Mospranimin e ankimit, në rastet kur ankimi nuk plotëson kushtet e pranueshmërisë dhe gjykata administrative e shkallës së parë nuk e ka bërë një gjë të tillë;
- b. Lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë;
- c. Ndryshimin e vendimit;
- d. Prishjen e vendimit dhe kthimin e çështjes për rigjykim, në rastet kur shkeljet procedurale janë të rënda dhe për të cilat ligji parashikon shprehimisht pavlefshmërinë e vendimit apo të procedurës së gjykimit;

- e. Prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes, në rastet kur çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, si dhe kur padia nuk mund të ngrihej ose gjykimi nuk mund të vazhdonte.

Vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar. Në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 5 ditë. Brenda 7 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore. Gjykata Administrative e Apelit dërgon dosjen në gjykatën administrative të shkallës së parë jo më vonë se 3 ditë pas kryerjes së njoftimit të vendimit të palëve. (neni 48/2, neni 55 i ligjit nr. 49/2012).

### **3.2 Rekursi ndaj vendimit të gjykatës së apelit**

E drejta për të ushtruar rekurs ndaj vendimit të apelit, afatet procedurale dhe rregullat e zhvillimit të gjykimit në Kolegjin Administrativ të GjL-së parashikohen në nenet 56-64 të ligjit nr. 49/2012.

Në ligj janë parashikuar disa raste, ku pala nuk mund të ushtrojë ankim ndaj vendimit të gjykatës së apelit, kur çështja ka objekt (neni 56 i ligjit nr. 49/2012):

- a. Kundërshtimin e dënimit për kryerjen e kundërvajtjeve administrative, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;
- b. Kundërshtimin e aktit administrativ që përmban detyrim në të holla, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;
- c. Kundërshtimin e aktit administrativ që ka refuzuar dhënien e detyrimit në të holla, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi;
- d. Mosmarrëveshjet që lidhen me mbrojtjen e të drejtave, lirive dhe interesave kushtetues dhe ligjorë, që rrjedhin nga sigurimet shoqërore dhe shëndetësore, ndihma ekonomike dhe pagesa e aftësisë së kufizuar, me vlerë më të vogël se dyzetfishi i pagës minimale, në shkallë vendi.

Mund të ushtrohet rekurs ndaj vendimeve të gjykatës së apelit vetëm për shkaqet e parashikuara në ligj:

- Për zbatim të gabuar të ligjit material ose procedural, të një rëndësie themelore për njehsimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore;
- Kur vendimi i ankimuar është i ndryshëm nga praktika e Kolegjit Administrativ ose e Kolegjeve të Bashkuara të GjL-së;
- Ka shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procedurës së gjykimit.

Kushtet e parashikuara në nenin 58, janë të vetmet raste kur ndaj një vendimi mund të bëhet rekurs. Nëse rekursi nuk përmban asnjë prej shkaqeve të parashikuara në këtë nen, ai nuk

mund të pranohet për shqyrtim nga Kolegji Administrativ i GjL-së (neni 60/1 i ligjit nr. 49/2012).

Shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Administrativ të GjL-së, si rregull bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillimi. Gjykata vendos shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se rekursi është paraqitur ndaj një vendimi të apelit administrativ, lidhur me gjykimin e aktit nënligjor normativ, konstaton se vendimi i apelit administrativ është i ndryshëm nga praktika e kolegjit administrativ ose edhe e kolegjeve të bashkuara të GjL-së, vlerësohet e nevojshme nga kolegji administrativ thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes. (neni 61, 62 ligjit nr. 49/2012).

Gjyqtari relator cakton datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi, duke urdhëruar njoftimin e palëve. Sekretaria e gjykatës njofton me shpallje, ditën dhe orën e shqyrtimit të rekursit, si dhe përbërjen e trupit gjykues të paktën 21 ditë përpara.

Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Administrativ ose Kolegjet e Bashkuara të GjL-së vendosin (neni 63 i ligjit nr. 49/2012):

- a) lënien në fuqi të vendimit;
- b) prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës administrative të shkallës së parë;
- c) prishjen e vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën Administrative të Apelit me tjetër trup gjykues;
- ç) prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes.

Vendimi, pavarësisht formës së gjykimit, duhet të shpallet detyrimisht i arsyetuar. Në raste përjashtimore dhe vetëm për shkak të pamundësisë absolute, gjykata shtyn shpalljen e arsyetuar të vendimit deri në 10 ditë. Brenda 10 ditëve nga shpallja e vendimit, dosja dorëzohet në sekretarinë gjyqësore. (neni 64 i ligjit nr. 49/2012).

#### **4. E drejta e ankimit ndaj vendimit gjyqësor në çështjet penale**

Ndaj vendimeve të ndërmjetme, jopërfundimtare dhe përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë ose të apelit bëhet ankim sipas afateve, mjeteve dhe procedurës të parashikuar nga neni 422 deri në nenin 461 të K.Pr.P.

Në lidhje me afatet për paraqitjen e ankimit/rekursit K.Pr.P parashikon se:

- a. *15 ditë* - Afati për të bërë ankim ndaj vendimit të shkallës së parë është pesëmbëdhjetë ditë. Ky afat fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit;
- b. *Afate të veçanta*: p.sh. 5 ditë në rastin e ankimit të masave të sigurimit; 10 ditë në rastin e ankimit ndaj zgjatjes së afatit të hetimit;

- c. 45 ditë - Afati për të paraqitur rekurs në GjL, i cili fillon nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të gjykatës së apelit.
- d. 20 ditë - Afati për paraqitjen e rekursit kundër një vendimi të gjykatës së apelit me të cilin është vendosur prishja e vendimit dhe kthimi i akteve gjykatës së shkallës së parë është 20 ditë.

#### 4.1 Ankimi ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë

Prokurori, i pandehuri dhe palët private mund të apelojnë vendimet e gjykatës së shkallës së parë. Pala që nuk ka bërë ankim brenda afatit mund të bëjë apel kundërshtues brenda pesë ditëve nga dita kur ka marrë njoftimin për apelin e palës tjetër.

Gjykata e apelit e shqyrton çështjen në tërësi dhe nuk kufizohet vetëm me shkaqet e paraqitura në ankim. Ajo shqyrton edhe pjesën që u takon bashkë të pandehurve që nuk kanë bërë ankim brenda kufijve që referojnë shkaqet e ngritura në ankim.

Gjyqtari relator i çështjes në gjykatën e apelit caktohet me short. Çështjet gjyqësore, me paraqitjen në gjykatë, regjistrohen menjëherë në sistemin elektronik të menaxhimit të çështjeve nga sekretaria gjyqësore, sipas kategorive të sistemit, nën mbikëqyrjen e kryesekretarit dhe kancelarit.<sup>54</sup>

Gjyqtari relator cakton datën dhe orën e gjykimit në përputhje me kalendarin e shqyrtimit të çështjeve, duke marrë për bazë radhën sipas kohës së ardhjes së dosjes në gjykatën e apelit. Kanë përparësi në shqyrtim çështjet në lidhje me ekstradimet për jashtë shtetit, çështjet në të cilat i pandehuri është i paraburgosur dhe çështjet për të cilat GjL-ja ka vendosur prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë. (neni 426 K.Pr.P.).

GjK ka konsoliduar praktikën duke u shprehur se shteti ka detyrimin për ta njoftuar të pandehurin në mënyrë efektive dhe të përshtatshme për seancën, si dhe të marrë masa për të siguruar praninë e tij.<sup>55</sup> Në jurisprudencën kushtetuese janë përcaktuar disa standarde kushtetuese, të cilat janë të lidhura nga pikëpamja organike dhe funksionale me njëra-tjetrën në mënyrë të tillë që cenimi i njërit standard ndikon në mënyrë të pashmangshme në cenimin e të tjerave. Konkretisht, e drejta për t'u njoftuar për një gjykim dhe pjesëmarrja në të është e lidhur me vendimmarrjen e gjykatës, e cila ndikon drejtpërsëdrejti mbi të drejtat subjektive ose interesat e ligjshme të individit.

Në varësi të palës që ka bërë ankim, gjykata e apelit ka të dejtë:

- a) *Kur apelles është prokurori* - mund t'i japë faktit një cilësim juridik më të rëndë, të ndryshojë llojin ose ta rrisë masën e dënimit, të ndryshojë masat e sigurimit dhe të marrë çdo masë tjetër që urdhëron ose lejon ligji, mund t'i japë dënim atij

54. Shih vendimin nr.554, datë 29.12.2022 të KLGj-së.

55. Shih vendimin nr. 14, datë 21.06.2022 të KLGj-së; Vendimi nr. 8, datë 23.02.2021; Vendimi nr. 37, datë 30.06.2016 i GjK-së.

që është deklaruar i pafajshëm, t'i japë pafajësi për një shkak të ndryshëm nga ai që pranohet në vendimin e apeluar, të marrë masat e treguara në shkronjën "a", të zbatojë, të ndryshojë ose të përjashtojë dënimet plotësuese dhe masat e sigurimit.

- b) *Kur apelles është vetëm i pandehuri* - gjykata nuk mund të caktojë një dënim më të rëndë, të zbatojë një masë sigurimi më të rëndë, t'i japë pafajësisë një shkak më pak të favorshëm nga ai i vendimit të apeluar.

Gjykata e apelit, pasi shqyrton çështjen, vendos:

- a. Lënien në fuqi të vendimit;
- b. Ndryshimin e vendimit;
- c. Prishjen e vendimit dhe pushimin e çështjes kur janë rastet që nuk lejojnë fillimin ose vazhdimin e procedimit ose kur nuk vërtetohet fajësia e të pandehurit;
- d. Prishjen e vendimit dhe kthimin e akteve gjykatës së shkallës së parë kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar ose ndihmësgjyqtar në çështjen konkrete, numrin e gjyqtarëve dhe ndihmësgjyqtarëve që është i domosdoshëm për formimin e kolegjeve të caktuara në këtë Kod, me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe pjesëmarrjen e tij në procedim, me pjesëmarrjen e përfaqësuesit të të dëmtuarit akuzues dhe të mbrojtësit të të pandehurit, me shkeljen e dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja, si dhe në çdo rast kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit.

Vendimi shpallet në seancë nga kryetari ose një anëtar i trupit gjykues me anë të leximit të dispozitivit. Pas dispozitivit kryetari lexon vendimin e arsyetuar. Arsyetimi i vendimit mund të jepet me shkrim edhe në mënyrë të përmbledhur, duke treguar shkaqet kryesore mbi të cilat bazohet vendimi. Në këtë rast gjykata u jep palëve në seancë vendimin e përmbledhur me shkrim. Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas shpalljes. Nëpunësi i caktuar vë nënshkrimin dhe shënon datën e depozitimit. Kur vendimi shpallet i përmbledhur, ai arsyetohet brenda 30 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar në Gjykatën e Apelit kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar. Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura (neni 430/1 K.Pr.P.).

#### **4.2 Rekursi ndaj vendimit të gjykatës së apelit**

Nëse prokurori, i pandehuri ose palët private pretendojnë që gjykata e apelit nuk ka respektuar ose ka zbatuar në mënyrë të gabuar ligjin penal, ka shkelur ligjin procedural, ka bërë shkelje që kanë si pasojë pavlefshmërinë absolute të vendimit të gjykatës kanë të drejtë të bëjnë rekurs në GjL.

Bazuar në nenin 434/2 të K.Pr.P., GjL ka miratuar formatin për paraqitjen e rekursit, i cili është publikuar në faqen e gjykatës, në linkun:

[http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Rezultatet\\_e\\_Kerkimit\\_2254\\_1.php?search=Format](http://www.gjykataelarte.gov.al/web/Rezultatet_e_Kerkimit_2254_1.php?search=Format).

Formati i rekursit është i ndarë në disa seksione, të cilat sipas rastit konkret duhet të plotësohen nga pala që paraqet rekursin, konkretisht rekursi duhet të përmbajë:

1. **Gjeneralitet e palëve;**
2. **Bazën Ligjore;**
3. **Rrethanat e çështjes** - Paraqiten në mënyrë të përmbledhur rrethanat e çështjes, pa përfshirë shkaqet e rekursit;
4. **Vendimet e Gjykatave:**
  - a. *Vendimi i gjykatës së shkallës së parë* - Citohet dispozitivi i vendimit;
  - b. *Shkaqet e ankimit në apel* - Renditen në mënyrë të përmbledhur shkaqet e ankimit;
  - c. *Vendimi i Gjykatës së Apelit* - Citohet dispozitivi i vendimit.

5. Shkaqet e rekursit:

*Zbatimi i gabuar i ligjit procedural të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore* - Paraqiten shkeljet e pretenduara të dispozitave konkrete procedurale të kryera nga gjykatat më të ulëta, duke argumentuar rëndësinë që ka shkelja e konstatuar në funksion të nevojës për njësimin, zhvillimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore të Gjykatës së Lartë. Në mbështetje të argumentave mund të citohen vendime të tjera të Gjykatës së Lartë, të GJK-së, të GjEDNj-së dhe të gjykatave ndërkombëtare, ose akte ndërkombëtare, të cilat trajtojnë ose kanë lidhje me natyrën a llojin e shkeljes procedurale të pretenduar, duke paraqitur informacion të saktë lidhur me burimin nga ku është marrë;

- a. *Zbatimi i gabuar i ligjit material të një rëndësie themelore për njësimin, sigurinë dhe/ose zhvillimin e praktikës gjyqësore* – Evidentohen shkeljet e kryera nga ana e gjykatave më të ulëta lidhur me mënyrën e interpretimit apo zbatimit të dispozitave materiale, duke argumentuar mjaftueshëm rëndësinë që ka shkelja e konstatuar në funksion të nevojës për njësimin, zhvillimin apo ndryshimin e praktikës gjyqësore të GjL-së. Citoni në mbështetje të argumenteve tuaja dhe vendime të tjera të GjL-së, të GJK-së, të GjEDNj-së dhe të gjykatave ndërkombëtare, ose akte ndërkombëtare, të cilat trajtojnë ose kanë lidhje me natyrën a llojin e shkeljes së ligjit material të pretenduar, duke paraqitur informacion të saktë lidhur me burimin nga ku është marrë;
- b. *Shmangia nga praktika e kolegjit/kolegjeve të bashkuara* – Në këtë seksion argumentohet mospërputhja ose shmangia e vendimit objekt kundërshtimi nga praktika gjyqësore e njësuar e kolegjit/ Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- c. *Shkelje të rënda të normave procedurale, me pasojë pavlefshmërinë e vendimit, të*



*procedurës së gjykimit, ose pavlefshmërinë e provave – Paraqiten argumente në favor të pretendimit se vendimi i gjykatave më të ulëta është marrë si pasojë e shkeljeve të rënda procedurale, të tilla që sjellin si pasojë pavlefshmërinë e vendimit ose të procesit të gjykimit (KPC/LGJA), (apo pavlefshmërinë absolute të akteve ose papërdorshmërinë e provave të marra gjatë gjykimit - KPP.*

6. **Objekti i rekursit** - në fund të rekursit pala konkudon se çfarë kërkon nga Kolegji Penal i GjL-së p.sh. lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit ose prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të shkallës së parë.

Pas regjistrimit të çështjes në GjL zhvillohet procedura e hedhjes së shortit elektronik për ndarjen e çështjeve dhe caktimin e relatorit, procedurë e cila zhvillohet çdo ditë pune në orën 15:00.<sup>56</sup> Gjyqtari relator i caktuar me short vendos datën dhe orën për shqyrtimin e çështjes në dhomë këshillimi në përputhje me rregullat e planifikimit të gjykimit të parashikuara në ligj. (neni 436 K.Pr.P.)

Sekretaria e gjykatës njofton palët nëpërmjet:

- Afishimit në këndin e njoftimeve;
- Faqen elektronike zyrtare për datën dhe orën e gjykimit të paktën 30 ditë përpara.
- Adresat elektronike të deklaruara apo të njohura nga palët, të cilat i janë vënë në dispozicion gjykatës;

Shqyrtimi i rekursit në Kolegjin Penal të GjL-së, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh në dhomë këshillim dhe në rastet kur çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës, për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore ose vlerësohet e nevojshme nga Kolegji Penal thirrja dhe dëgjimi i palëve për shkak të problematikës ose kompleksitetit të çështjes zhvillohet në seancë gjyqësore (neni 436/a dhe 437 K.Pr.P.).

Pas shqyrtimit të çështjes, Kolegji Penal ose Kolegjet e Bashkuara të GjL-së vendosin:

- a. *Mospranimin e rekursit në rastet kur është bërë për shkaqe të ndryshme nga ato që parashikon neni 432 i këtij Kodi;*
- b. *Prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së shkallës së parë;*
- c. *Prishjen e vendimit të gjykatës së apelit dhe dërgimin e çështjes për rishqyrtim në këtë gjykatë me tjetër trup gjykues;*
- d. *Prishjen e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në shkallë të parë kur nuk janë respektuar dispozitat që lidhen me kushtet për të qenë gjyqtar në çështjen konkrete, me numrin e gjyqtarëve që është i domosdoshëm për formimin e kolegeve të caktuara në këtë*

---

56. Shih Urdhër nr.54, datë 09.03.2023 “Për caktimin e orarit të hedhjes së së shortit elektronik për ndarjen e çështjeve gjyqësore”.

*Kod, me ushtrimin e ndjekjes penale nga prokurori dhe pjesëmarrjen e tij në procedim, me pjesëmarrjen e të pandehurit, të mbrojtësit të tij, ose përfaqësuesit të viktimës akuzuese, me shkeljen e dispozitave për paraqitjen e akuzave të reja, si dhe në çdo rast kur në dispozita të veçanta është parashikuar pavlefshmëria e vendimit;*

- e. Prishjen e vendimeve të gjykatës së shkallës së parë dhe të gjykatës së apelit dhe pushimin e gjykimit të çështjes pa e kthyer për rishqyrtim;*
- f. Ndryshimin e vendimeve të gjykatës së apelit dhe të gjykatës së shkallës së parë dhe zgjidhjen përfundimisht të çështjes kur zbatimi i ligjit procedural ose material nuk diktohet nga nevoja për rivlerësimin e fakteve apo të provave të çështjes;*
- g. Lënien në fuqi të vendimit të gjykatës së apelit.*

Vendimi shpallet në seancë nga kryetari ose një anëtar i trupit gjykues me anë të leximit të dispozitivit. Pas dispozitivit kryetari lexon vendimin e arsyetuar. Arsyetimi i vendimit mund të jepet me shkrim edhe në mënyrë të përmbledhur, duke treguar shkaqet kryesore mbi të cilat bazohet vendimi. Kur shpallet i përmbledhur, vendimi arsyetohet brenda 60 ditëve nga shpallja e tij. Ky afat mund të zgjatet për një periudhë tjetër 30-ditore nëse çështja është gjykuar nga Kolegjet e Bashkuara. Afati i parashikuar për të arsyetuar vendimin me shkrim, mund të zgjatet në raste përjashtimore, për shkaqe të përligjura. Vendimi depozitohet në sekretari menjëherë pas shpalljes. Nëpunësi i caktuar vë nënshkrimin dhe shënon datën e depozitimit. (neni 448/1 K.Pr.P.)

### **4.3 Rishikimi i vendimeve të formës së prerë**

Në rastet dhe kushtet e parashikuara nga K.Pr.P., rishikimi i vendimeve që kanë marrë formë të prerë lejohet në çdo kohë, edhe kur dënimi është ekzekutuar ose shuar. Nuk lejohet rishikimi i vendimit të pafajësisë dhe as rishikimi i vendimit të dënimit kur synohet rëndimi i pozitës së të dënuarit. (neni 449 K.Pr.P.).

Instituti i rishikimit ka për qëllim ndreqjen e gabimeve të mundshme gjyqësore në lidhje me vendimet e formës së prerë. Në veçanti, ndryshimet e bëra në nenin 450 kanë për qëllim përafrimin e legjislacionit shqiptar në fushën e rishikimit të vendimeve penale me standardet ndërkombëtare në lidhje me gjykimin në mungesë, ekstradimin dhe zbatimin e vendimeve të GjEDNj-së.<sup>57</sup>

Në nenin 450 janë parashikuar rastet kur mund të kërkohet rishikimi i një vendimi penal, i cili ka marrë formë të prerë:

- a. kur faktet e vëna në themel të vendimit nuk pajtohen me ato të një vendimi tjetër të formës së prerë;

<sup>57</sup>. <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2017/7905/450>

- b. kur vendimi është bazuar në një vendim të gjykatës civile ose administrative, i cili është revokuar më pas;
- c. kur pas vendimit kanë dalë ose janë zbuluar prova të reja, të cilat vetëm ose së bashku me ato që janë vlerësuar njëherë, tregojnë se vendimi është i gabuar;
- d. kur vërtetohet se vendimi është dhënë si pasojë e falsifikimit të akteve të gjyqimit ose të një fakti tjetër të parashikuar nga ligji si vepër penale.
- e. kur shkakua për rishikimin e vendimit të formës së prerë rezulton nga një vendim i GjEDNj-së që e bën të domosdoshëm rigjykimin e çështjes. Kërkesa paraqitet brenda 6 muajve nga njoftimi i vendimit;
- f. kur ekstradimi i të dënuarit të gjykuar në mungesë jepet me kushtin e shprehur të rigjyqimit të çështjes. Kërkesa për rishikim mund të paraqitet brenda tridhjetë ditëve nga data kur personi është ekstraduar. Kërkesa e paraqitur brenda afatit nuk mund të refuzohet;
- g. kur personi është gjykuar në mungesë sipas nenit 352 të këtij Kodi dhe kërkon rigjykimin e çështjes. Kërkesa paraqitet brenda tridhjetë ditëve nga data e marrjes dijeni. Kërkesa e paraqitur brenda afatit nuk mund të refuzohet.

Me ligjin nr. 35/2017 janë shtuar germat “d”, “dh”, “e” në nenin 450 K.Pr.P. Siç u përmend më sipër, ky ndryshim synon përafrimin e legjislacionit shqiptar, me atë ndërkombëtar. Germa “d” mundëson rishikimin e vendimit penal në rastet kur ky është i domosdoshëm si pasojë e zbatimit të një vendimi të GjEDNj-së. Kërkesa për rishikim duhet të paraqitet brenda 6 muajve nga njoftimi i vendimit. Sipas nenit 452 pika 2 K.Pr.P., kërkesës duhet t’i bashkëngjitet dhe vendimi i GjEDNj-së. Germa “dh” parashikon rishikimin kur ekstradimi i personit të gjykuar në mungesë është bërë me kushtin e shprehur të rigjyqimit të çështjes. Kërkesa paraqitet brenda 30 ditëve nga momenti i ekstradimit dhe ajo nuk mund të refuzohet. Sërish, sipas nenit 452 pika 2 K.Pr.P., kërkesa duhet të dokumentohet me kushtin e shprehur të rigjyqimit të çështjes. Germa “e” bën të mundur rishikimin kur vendimi është dhënë në mungesë, sipas nenit 352 K.Pr.P. Edhe kjo kërkesë mund të paraqitet brenda 30 ditëve nga marrja dijeni për vendimin dhe ajo nuk mund të refuzohet.<sup>58</sup>

58. <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2017/7905/450>

## 5. Monitorimi i përmbushjes së standardeve për respektimin e së drejtës së ankimit

Disa nga indikatorët për monitorimin e respektimit të së drejtës për ankim janë pasqyruar në tabelat si më poshtë:

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Po/Jo</i>
A është paraqitur ankim/rekurs kundër një vendimi ndaj të cilit ligji parashikon të drejtën e ankimit?	
A është paraqitur ankim/rekursi brendra afatit të parashikuar në ligj?	
A është paraqitur ankim/rekursi përpara gjykatës kompetente?	
A u është njoftuar ankim/rekursi palëve pjesëmarrëse në gjykim?	
A është nënshkruar ankimi që i drejtohet gjykatës së apelit nga vetë pala, avokati ose përfaqësuesi i pajisur me prokurë?	
A janë pasqyruar në përmbajtjen e ankimit palët ndërgjyqëse, vendimi kundër të cilit bëhet ankimi, shkaqet për të cilat bëhet ankimi dhe çfarë kërkohet me ankimin?	
A i janë bashkëlidhur ankimit kopje të ankimit/rekursit dhe të dokumenteve të tjera, aq sa janë personat që marrin pjesë në çështje si palë dhe prokura kur ankimi paraqitet nga avokati ose përfaqësuesi i palës?	
A ka paraqitur apel kundërshtues ose kundër recurs pala që nuk ka bërë ankim/rekurs?	
A është paraqitur apeli kundërshtues ose kundër recursi brenda afateve ligjore?	
A ka qenë gjykata përpara rastit për të vendosur mospranimin e ankimit/rekursit?	
A është kryer njoftimi për ditën dhe orën e gjykimit, si dhe përbërjen e trupit gjykues në përputhje me procedurën e parashikuar në ligj?	
Në rastet kur palët kanë depozituar të dhënat elektronike, a është bërë njoftimi për datën dhe orën e seancës në të dhënat elektronike?	
A është kryer shpallja ose njoftimi për seancën në gjykatën e apelit/Lartë të paktën 15 ditë para datës së gjykimit?	
A e ka shqyrtuar gjykata e apelit çështjen në mungesë pavarësisht se dëgjimi i palëve ishte një nga detyrat e rigjykimit ose kur njoftimi ka qenë i parregullt?	
A e ka shqyrtuar gjykata e apelit/GjL çështjen brenda kufijve të ankimit/rekursit?	
A e ka shqyrtuar gjykata e apelit çështjen duke mbajtur parasysh, për aq sa janë të zbatueshme, dispozitat mbi procedurën e gjykimit në shkallë të parë?	

A ka vendosur gjykata e apelit në dhomë këshillimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se debati gjyqësor ishte i nevojshëm?	
A janë nënshkruar rekursi dhe të gjitha kërkesat e tjera që paraqiten në GjL nga avokati që e përfaqëson palën?	
A janë pasqyruar në përmbajtjen e rekursit palët ndërgjyqëse, vendimi që kundërshtohet, paraqitja e përmbledhur të fakteve të çështjes, shkaqet për të cilat kundërshtohet vendimi, si dhe argumentet që mbështesin pretendimin se ekzistojnë shkaqe për rekurs?	
A e ka vendosur GjL në dhomë këshillimi për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore me praninë e palëve në rast se debati gjyqësor ishte i nevojshëm ose çështja paraqet rëndësi nga pikëpamja e së drejtës për njësimin ose zhvillimin e praktikës gjyqësore?	
A është paraqitur kërkesë për rishikim vendimi?	
A është paraqitur kërkesa për rishikim për shkaqet e parashikuara në nenin 454 të K.Pr.C. dhe nenin 450 të K.Pr.P.?	
A është paraqitur kërkesa për rishikim brenda afatit 30-ditor nga vënia në dijeni për shkakun e rishikimit?	

**Metodat për zhvillimin e monitorimit:**

- Analiza e vendimeve të gjykatave më të larta për vendimet e gjykatave më të ulëta për rastet kur është konstatuar shkelja e të drejtës së ankimit.
- Analiza e jurisprudencës të GjK-së për vendimet e ankimeve të paraqituara bazuar në nenin 131/f të Kushtetutës, në kuadër të respektimit të drejtës së ankimit.
- Analiza e jurisprudencës të GjEDNj-së, për vendimet kundër Shqipërisë për respektimin e nenit 6 të KEDNj-së, në kuadër të të drejtës së ankimit.
- Analiza e raporteve vjetore të gjykatave.
- Analiza e statistikave vjetore për veprimtarinë e GjK-së.

## MODULI V

### AKSESI NË DREJTËSI NËPËRMJET NDIHMËS JURIDIKE

#### 1. Hyrje

Aksesi në drejtësi është një mundësi efektive e qytetarëve për të arritur zgjidhje përmes institucioneve të drejtësisë. Miratimi i ligjit të ri nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti” i cili hyri në fuqi në qershor të vitit 2018, parashikoi një shtrirje më të plotë nga pikëpamja normative në krahasim me ligjin e mëparshëm duke e zgjeruar objektin e ndihmës juridike falas dhe rrethin e subjekteve që do të përfitojnë nga ky sistem. Npërmjet tij ndryshoi i gjithë sistemi i ndihmës juridike, mënyra e funksionimit dhe organizimit të këtij sistemi duke parashikuar tashmë në mënyrë të detajuar cilët do të jenë ofrues të këtij shërbimi.

Legjislacioni për ndihmën juridike përbëhet nga një paketë e plotë e cila përveç ligjit përmban dhe aktet nënligjore që kanë dalë në zbatim të tij. Standardizimi është një tjetër risi thelbësore që solli ky ligj për ndihmën juridike duke krijuar kështu një institucion të ri me procese të standardizuara në përputhje me të gjitha kriteret e kërkuara nga konventat dhe angazhimet mbikombëtare. Për herë të parë u krijua Drejtoria e Mbikëqyrjes së Standardeve të Ofrimit të Shërbimit të Ndihmës Juridike si një mekanizëm për mbikëqyrjen dhe kontrollin e shërbimeve të ndihmës juridike të garantuar nga shteti.

Ndihma juridike nuk gjen një parashikim të drejtëpërdrejtë në KEDNj, por pavarësisht kësaj, praktikat e GjEDNj-së kanë qenë të shumta dhe e kanë trajtuar dhe elaboruar këtë institut. Në rastin Airey kundër Irlandës, kërkuësja kërkoi zgjidhjen e martesës, por nuk ishte në gjendje të aksesonte gjykatën sepse ajo nuk kishte mundësi financiare për të kontaktuar një avokat pa ndihmë juridike.

GjEDNj-ja konfirmoi se, megjithëse neni 6 (1) i KEDNj-së nuk parashikon në mënyrë eksplicite ndihmën juridike në proceset civile, shtetet mund të detyrohen ta ofrojnë atë kur ndihma juridike është e domosdoshme për të siguruar akses efektiv në gjykatë. Megjithatë nuk vlen për të gjitha rastet që kanë të bëjnë me të drejtat dhe detyrimet civile. Në rastin konkret, faktorët përcaktues në favor të dhënies së ndihmës juridike ishin: kompleksiteti i procedurës dhe i çështjeve ligjore, nevoja për të vërtetuar faktet përmes provave të ekspertëve dhe marrjes në pyetje të dëshmitarëve dhe se kjo ishte një mosmarrëveshje martesore që përfshinte përfshirjen emocionale. Gjykata konstatoi shkelje të nenit 6 të KEDNj-së.

Në çështjen Gnahoré kundër Francës, për të shmangur arbitraritetin, një sistem i ndihmës juridike duhet të krijojë një mekanizëm të drejtë për përzgjedhjen e çështjeve që mund të përftojnë. U takon shteteve të krijojnë sisteme që të përputhen me KEDNj-në. Mosmarrja e një vendimi zyrtar mbi një kërkesë për ndihmë juridike përbën shkelje. Qëndrimi i GjEDNj-së është gjetur sinkron me jurisprudencën e GjK-së<sup>59</sup>, e cila e ka konsideruar ndihmën juridike të garantuar nga shteti si një pjesë themelore e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

## **2. Ndihma juridike për t'u njohur me legjislacionin dhe zgjidhur problemet ligjore**

Ndihma juridike për t'u njohur me legjislacionin dhe zgjidhur problemet ligjore quhet ndihmë juridike parësore dhe përfshin:

- i. dhënien e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
- ii. dhënien e këshillimit;
- iii. dhënien e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;
- iv. dhënien e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
- v. përfaqësimin përpara organeve administrative;
- vi. dhënien e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.<sup>60</sup>

*Ligji ka parashikuar dy kategori përfituesish të ndihmës juridike parësore:*

1. Kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike<sup>61</sup>. Ndihma juridike u ofrohet personave të mëposhtëm, pavarësisht të ardhurave dhe pasurisë së tyre:

- i. viktimave të dhunës në familje;
- ii. viktimave të abuzuar seksualisht dhe viktimave të trafikimit të qenieve njerëzore, në çdo fazë të procedimit penal;
- iii. viktimave të mitur dhe të miturve në konflikt me ligjin, në çdo fazë të procedimit penal;
- iv. fëmijëve, të cilët jetojnë në institucionet e përkujdesjes shoqërore;
- v. fëmijëve nën kujdestari, të cilët kërkojnë të nisin një proces pa miratimin e kujdestarit të tyre ligjor ose kundër kujdestarit të tyre ligjor;

59. Vendim nr. 7/2013 i GjK-së.

60. Neni 3.b i ligjit Nr. 111/2017.

61. Neni 11 i ligjit Nr. 111/2017.

- vi. personave që përfitojnë nga pagesa për aftësinë e kufizuar, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndihmën dhe shërbimet shoqërore, duke përfshirë edhe personat që përfitojnë nga statusi i të verbrit;
- vii. personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit të pavullnetshëm në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor, sipas dispozitave të legjislacionit në fuqi për shëndetin mendor;
- viii. personave, të cilët i nënshtrohen trajtimit vullnetar në institucionet e shërbimit të shëndetit mendor për sëmundjet e rënda mendore;
- ix. personave, ndaj të cilëve kërkohet heqja ose kufizimi i zotësisë për të vepruar, në çdo fazë të këtij procesi;
- x. personave, të cilëve u është hequr ose kufizuar zotësia për të vepruar, që kërkojnë të nisin një proces kundër kujdestarit të tyre ligjor, për rifitimin e zotësisë për të vepruar, pa miratimin e kujdestarit ligjor;
- xi. personave, të cilët janë përfitues të skemave të mbrojtjes sociale;
- xii. personave, të cilëve u është cenuar e drejta nëpërmjet një veprimi ose mosveprimi që përbën diskriminim, bazuar në vendimin e organit kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për mbrojtjen nga diskriminimi.

2. Përfituesit e ndihmës juridike me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme<sup>62</sup>. Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e ka çdokush që provon se ka të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme për të përballuar shpenzimet për këshillim, përfaqësim dhe/ose mbrojtje në çështjet penale, në çështjet administrative dhe në çështjet civile.

- i. Të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuar për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.
- ii. Të ardhurat e një personi, i cili nuk jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.
- iii. Pasuria e një personi konsiderohet e pamjaftueshme, nëse vlera e saj në total nuk tejkalon vlerën e 36 pagave minimale mujore sipas legjislacionit në fuqi.

Ndihma juridike parësore jepet nga:

- a. *Punonjësit me trajnim të posaçëm*; Ndihma juridike parësore jepet pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, nga punonjësit me trajnim të posaçëm të punësuar pranë këtyre qendrave.

62. Neni 12 i ligjit Nr. 111/2017.



- b. *Nga OJF të autorizuar*; OJF japin shërbime të ndihmës juridike parësore në përputhje me autorizimin e miratuar nga MD. Procedurat dhe dokumentacioni për autorizimin e tyre përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. OJF të autorizuar për dhënien e ndihmës juridike parësore përfitojnë financime nga buxheti i shtetit, pas një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje.
- c. *Nga klinikat ligjore pranë institucioneve të arsimit të lartë*; DNJF bashkëpunon me klinikat ligjore, sipas kushteve dhe kritereve të parashikuara në marrëveshjet përkatëse të bashkëpunimit për trajnimin dhe përditësimin e njohurive të studentëve të përfshirë pranë këtyre klinikave, mbi çështjet e lidhura me ndihmën juridike parësore<sup>63</sup>.

Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike parësore bëhet me gojë ose me shkrim nga personi i interesuar pranë një qendre shërbimi për ndihmë juridike parësore ose një OJF të autorizuar. Personi, i cili kërkon të përfitojë ndihmën juridike parësore duhet të nënshkruajë një vetëdeklarim se përmbush kriteret e përcaktuara në këtë ligj, sipas formularit të vetëdeklarimit të miratuar nga MD, të shoqëruar me dokumentacionin justifikues<sup>64</sup>.

Kërkuesi duhet të paraqesë dokumentacionin e mëposhtëm:

- i. Certifikatë familjare;
- ii. Certifikatë personale;
- iii. Vërtetim që nuk ka pasuri të paluajtshme personi si dhe të gjithë anëtarët e familjes me të cilët rezulton në certifikatë familjare (gjenerohet në e-albania);
- iv. Vërtetim nga Drejtoria Rajonale e Shërbimit të Transportit Rrugor që personi si dhe të gjithë anëtarët e familjes me të cilët rezulton në certifikatë familjare nuk kanë në pronësi automjete;
- v. Vërtetim që personi si dhe të gjithë anëtarët e familjes me të cilët rezulton në certifikatë familjare nuk kanë biznes (gjenerohet në e-albania);
- vi. Vërtetim page të personit si dhe të gjithë anëtarëve të familjes me të cilët rezulton në certifikatë familjare;
- vii. Të dhëna nga llogaria bankare;
- viii. Vërtetim papunësie nga Zyra e Punës të personit si dhe të gjithë anëtarëve të familjes me të cilët rezulton në certifikatë familjare.

---

63. Nenet 13, 14 dhe 15 i ligjit Nr. 111/2017.

64. Neni 17 i ligjit Nr. 111/2017.

### 3. Ndhimja juridike për të aksesuar gjykatën

Ndhimja juridike për të aksesuar gjykatën quhet ndihmë juridike dytësore dhe përfshin:

- a. shërbimin juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën;
- b. ofrimin e këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal<sup>65</sup>.

Ndhimja juridike dytësore jepet nga avokatët që përfshihen në listën e miratuar nga DHKA, në bazë të kërkesës së personit që gëzon të drejtën për përfitimin e ndihmës juridike dytësore.

Kategoritë e përfituesve dhe kriteret për përfitimin e ndihmës juridike dytësore janë të njëjta me ato për përfitimin e ndihmës juridike parësore, me përjashtim të rastit kur nëse një person, i cili jeton në një familje, kërkon ndihmë juridike dytësore për një çështje kundër një anëtari tjetër të së njëjtës familje, nuk do të zbatohet rregulli që të ardhurat e një personi, i cili jeton në një familje, konsiderohen të pamjaftueshme, nëse të ardhurat në total të të gjithë pjesëtarëve të familjes, të pjesëtuara për numrin e anëtarëve të familjes, janë më të ulëta se 50 për qind e pagës minimale mujore të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. Në këtë rast, të ardhurat e këtij personi konsiderohen të pamjaftueshme, nëse janë më të ulëta se niveli i pagës minimale të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi.

Kërkesa hartohet sipas formularit të kërkesës, të miratuar nga MD. Kërkesa për dhënien e ndihmës juridike dytësore paraqitet nga personi i interesuar personalisht ose me anë të shërbimit postar pranë gjykatës ose organit procedues që fillon hetimet, përpara fillimit të një procesi gjyqësor, në fillim të një procesi gjyqësor dhe/ose në çdo fazë të procesit gjyqësor, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin procedural. Personi që gëzon të drejtën për ndihmë juridike dytësore, mund ta paraqesë kërkesën e parashikuar nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor apo të pajisur me prokurë, ose nëpërmjet bashkëshortit/es, bashkëjetuesit/es ose një të afërmi të shkallës së parë. Personi, i cili kërkon të përfitojë ndihmë juridike dytësore, nënshkruan një vetëdeklarim se përmbush kriteret e përfitimit, të përcaktuara në këtë ligj, sipas formularit të vetëdeklarimit të miratuar nga MD, të shoqëruar me dokumentacionin justifikues. Vendimi në lidhje me kërkesën për ndihmë juridike dytësore merret nga gjykata kompetente:

- a) brenda 5 ditëve nga data e regjistrimit të kërkesës, kur kërkesa paraqitet përpara fillimit të procesit gjyqësor;
- b) gjatë veprimeve paraprake ose në seancën përgatitore përpara se të caktohet seanca gjyqësore, kur kërkesa për ndihmë juridike është paraqitur bashkë me kërkesë-padinë;
- c) sipas parashikimeve të legjislacionit procedural dhe dispozitave të këtij ligji, kur kërkesa paraqitet gjatë shqyrtimit gjyqësor.

65. Neni 3.c i ligjit Nr. 111/2017.

Kundër vendimit të gjykatës për rrëzimin e kërkesës për ndihmën juridike dytësore mund të bëhet ankimi i veçantë. Ankimi i vendimit nuk pengon vazhdimin e shqyrtimit të çështjes. Ankimi bëhet sipas formularit tip të miratuar nga MD, i cili i jepet kërkuarit së bashku me vendimin për rrëzimin e kërkesës. Gjykata e apelit shqyrtton çështjen në dhomë këshillimi dhe merr vendim brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes. Kundër këtij vendimi nuk lejohet rekurs në GjL. DNJF mund të ankimojë vendimin e gjykatës për pranimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, nëse pretendon se kjo kërkesë është dukshëm abuzive ose haptazi e pabazuar. Kundër vendimit të gjykatës së apelit nuk lejohet rekurs në GjL<sup>66</sup>.

Kërkesa për ndihmë juridike dytësore paraqitet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Kërkesa për ndihmë juridike dytësore e të pandehurit pa mjete të mjaftueshme financiare paraqitet pranë organit procedues që fillon hetimet.<sup>67</sup> Kërkuari mund ta kundërshtojë vendimin e organit procedues për rrëzimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore, me padi në gjykatën penale të shkallës së parë, kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel, brenda 5 ditëve nga marrja dijani për këtë vendim. Gjykata shqyrtton çështjen me një gjyqtar, sipas rregullave të parashikuara në legjislacionin procedural, brenda 15 ditëve nga regjistrimi i çështjes. Kundër këtij vendimi lejohet ankimi i veçantë në gjykatën e apelit brenda 5 ditëve nga marrja dijani. Gjykata e apelit e shqyrtton ankimin në dhomë këshillimi brenda 10 ditëve nga data e marrjes së akteve<sup>68</sup>.

#### **4. Përjashtimi nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore**

Kategoritë e përfituesve dhe kriteret për përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore janë të njëjta me ato për përfitimin e ndihmës juridike dytësore. Personat, të cilët kanë të drejtën për të marrë ndihmë juridike dytësore, gëzojnë të drejtën për përjashtim nga:

- a) pagimi i tarifave të përgjithshme dhe të veçanta, sipas përcaktimeve të ligjit për tarifën gjyqësore në Republikën e Shqipërisë;
- b) pagimi i shpenzimeve gjyqësore (shpenzimet për dëshmitarët, ekspertët, përkthyesit dhe për këqyrjen e sendeve ose këqyrjen në vend), sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural;
- c) detyrimi për të parapaguar tarifën e vënies në ekzekutim të urdhrit të ekzekutimit pranë shërbimit përmbarimor gjyqësor shtetëror.

Përjashtimi nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore jepet në bazë të një kërkesë që hartohet sipas formularit të kërkesës së miratuar nga MD. Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet personalisht ose nëpërmjet shërbimit postar.

66. Neni 22 i ligjit Nr. 111/2017.

67. Nenet 18, 19 dhe 20 ligjit Nr. 111/2017.

68. Neni 21 i ligjit Nr. 111/2017.

Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore mund të paraqitet:

- a) së bashku me kërkesën për ndihmë juridike dytësore;
- b) bashkëlidhur kërkesëpadisë, në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural;
- c) në çdo fazë të procesit, derisa nuk është deklaruar i mbyllur hetimi gjyqësor.

Kërkesa për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore paraqitet në gjykatën kompetente për shqyrtimin e çështjes në themel. Vendimi i pranimit të kërkesës për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore i njoftohet menjëherë DNJF. Vendimi gjyqësor për përjashtimin nga pagimi i tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore përbën titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në përputhje me parashikimet e legjislacionit procedural.<sup>69</sup>

## **5. Efektiviteti i praktikave të punës së organeve përgjegjëse për funksionimin e skemës shtetërore të ndihmës juridike**

Institucionet përgjegjëse për administrimin dhe funksionimin e sistemit të ndihmës juridike janë:

- i) MD;
  - ii) DNJF;
  - iii) DhKA;
  - iv) gjykatat kompetente, sipas parashikimeve të këtij ligji.
- 
- i) MD ka përgjegjësitë dhe kryen detyrat e mëposhtme:
    - a) zhvillon politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
    - b) i propozon Ministrisë së Financave projektbuxhetin vjetor për ndihmën juridike, në përputhje me rregullat e parashikuara në legjislacionin për menaxhimin e sistemit buxhetor;
    - c) mbikëqyr mirëfunksionimin e sistemit të ndihmës juridike dhe zbatimin e buxhetit vjetor për ndihmën juridike;
    - ç) raporton çdo vit në Kuvend për gjendjen e sistemit të ndihmës juridike;
    - d) miraton formularët për paraqitjen e kërkesës për ndihmë juridike parësore, dytësore dhe për përjashtim nga pagimi i tarifave gjyqësore dhe i shpenzimeve gjyqësore, vetëdeklarimin për ndihmë juridike parësore, vetëdeklarimin e të

<sup>69</sup>. Nenet 25, 26, 27 dhe 28 të ligjit Nr. 111/2017.

ardhurave dhe të pasurive, vetëdeklarimin për kategoritë e veçanta, formatin e regjistrit për regjistrimin e kërkesave dhe vetëdeklarimeve të mësipërme, e regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe të ankimit ndaj vendimit të rrëzimit të kërkesës për ndihmë juridike dytësore.

- dh) miraton krijimin e qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore, pasi të ketë marrë më parë mendimin e KLGJ;
- e) miraton kontratën tip me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të këtij ligji, pasi të ketë marrë më parë mendimin e ministrisë përgjegjëse për financat;
- ë) miraton kontratën tip me avokatët për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore;
- f) miraton, pasi të ketë marrë më parë mendimin e DNJF-së dhe DhKA-së, kriteret dhe metodologjinë për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga DNJF të shërbimeve të ndihmës juridike;
- g) miraton me udhëzim të përbashkët me ministrin përgjegjës për financat, pasi të ketë marrë më parë mendimin e DhKA-së, kriteret e përfitimit të pagesave dhe tarifave përkatëse të shpërblimit të avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore;
- gj) miraton procedurat që ndiqen nga DNJF në lidhje me pagesat për shpenzimet gjyqësore, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- h) publikon listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe listën e organizatave jofitimprurëse të autorizuara që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore në faqen zyrtare të MD;
- i) miraton rregullat dhe procedurat për mbledhjen, plotësimin dhe administrimin e të dhënave të regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore;
- ii) DNJF është person juridik publik nën varësinë e ministrit të Drejtësisë, në kuptimin e ligjit për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore. DNJF kryen këto detyra:
  - a) zbaton politikën shtetërore në fushën e ndihmës juridike;
  - b) i paraqet ministrit të Drejtësisë raporte tremujore mbi zbatimin e këtij ligji dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike;
  - c) vlerëson kostot dhe planifikon shpenzimet e lidhura me dhënien e ndihmës juridike dhe ia paraqet ministrit të Drejtësisë për t'u përfshirë në buxhetin e shtetit;

- ç) menaxhon fondet buxhetore për dhënien e ndihmës juridike;
- d) mbledh dhe analizon informacionin mbi dhënien e ndihmës juridike për të përmirësuar funksionimin e sistemit të ofrimit të ndihmës juridike dhe organizon fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përfundimin e saj;
- dh) harton raportet vjetore për veprimtarinë e saj në lidhje me zbatimin e këtij ligji dhe të politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike dhe ia paraqet ministrit të Drejtësisë;
- e) bashkëpunon me organizata ndërkombëtare, me klinika ligjore dhe me organizata jofitimprurëse vendase dhe të huaja në zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut;
- ë) harton kontratën tip me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të këtij ligji;
- f) lidh kontrata me organizatat jofitimprurëse për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe kryen pagesat përkatëse;
- g) bashkëpunon me Departamentin e Administratës Publike për miratimin e programeve të trajnimit fillestar dhe të vazhdueshëm për punonjësit me trajnim të posaçëm, mbikëqyr zbatimin e tyre dhe rishqyrton periodikisht standardet për trajnimin dhe performancën profesionale të punonjësve me trajnim të posaçëm;
- gj) administron, bazuar në urdhrin përkatës të ministrit të Drejtësisë, qendrat e shërbimit të ndihmës juridike parësore, në ambientet e gjykatave të rretheve gjyqësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për administratën shtetërore;
- h) publikon listën e avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në faqen zyrtare të DNJF-së;
- i) publikon kontratën tip me avokatët për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike dytësore, pas miratimit nga ministri i Drejtësisë;
- j) kryen pagesat, bazuar në tarifin përkatës të shpërblimit të avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, sipas përcaktimeve të këtij ligji;
- k) lidh, deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga DhKA për ofrimin e ndihmës juridike dytësore;
- l) zbaton sistemin e vlerësimit të cilësisë së dhënies së ndihmës juridike;

- ll) mbikëqyr çdo vit standardet e ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike parësore dhe dytësore nga organizatat jofitimprurëse dhe avokatët;
  - m) zbaton rregullat për rimbursimin e pagesave, sipas parashikimeve të këtij ligji dhe mbron interesat e buxhetit të shtetit;
  - n) harton dhe i propozon ministrit të Drejtësisë aktet nënligjore, sipas parashikimeve të këtij ligji;
  - nj) mban, mbledh, plotëson dhe administron të dhënat e regjistrit të kërkesave dhe vetëdeklarimeve të subjekteve të këtij ligji dhe të dhënat e regjistrit të organizatave jofitimprurëse që ofrojnë ndihmë juridike parësore, sipas rregullave dhe procedurave të miratuara nga ministri i Drejtësisë;
- iii) DhKA kryen këto detyra:
- a) miraton me udhëzim të përbashkët me DNJF-në kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore;
  - b) miraton, në bashkëpunim me Ministrinë e Drejtësisë, rregullat për zbatimin e parimit të rotacionit në caktimin e avokatëve që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore, sipas parashikimeve të nenit 24, të këtij ligji, dhe mbikëqyr zbatimin e tyre nga dhomat vendore të avokatisë;
  - c) brenda datës 1 shkurt të çdo viti kalendarik, DhKA miraton listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe ia përcjell këtë listë MD-së, DNJF-së dhe dhomave vendore të avokatisë. Në hartimin e kësaj liste, DhKA mban parasysh, për aq sa është e mundur, përfshirjen e avokatëve të të gjitha specialiteteve dhe niveleve dhe respektimin e barazisë gjinore;
  - ç) publikon listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në faqen zyrtare të DHKA;
  - d) përgatit dhe organizon programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore, në bashkëpunim me DNJF-në;

## **6. Monitorimi i përmbushjes së standardeve për respektimin e së drejtës për të përfituar ndihmë juridike falas**

Disa nga indikatorët për monitorimin e respektimit të së drejtës për të përfituar ndihmë juridike janë pasqyruar në tabelat si më poshtë:

<b><i>Treguesit e realizimit</i></b>	<i>Po/Jo</i>
A është miratuar një strategji kombëtare për edukimin ligjor të publikut?	
A janë publikuar në një format të aksesueshëm formularët për të kërkuar përfitimin e ndihmës juridike parësore?	
A janë themeluar në një numër të mjaftueshëm Qendrat e Ndihmës Juridike Parësore?	
A janë vendosur Qendrat e Ndihmës Juridike Parësore pranë vendeve që mund të aksesohen lehtësisht nga qytetarët?	
A janë autorizuar OJF-të për të ofruar ndihmë juridike?	
A kanë përfituar mbështetje financiare nga buxheti i shtetit OJF të autorizuara për të ofruar ndihmë juridike?	
A është publikuar lista e OJF-ve të autorizuara që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore dhe adresat e tyre të kontaktit?	
A janë lidhur kontrata me OJF-të për shërbimet e ndihmës juridike parësore, sipas parashikimeve të ligjit dhe a janë kryer pagesat përkatëse?	
A janë Klinikat e Ligjit një instrument efektiv për ofrimin e ndihmës juridike parësore?	
A janë trajnuar mjaftueshëm punonjësit që ofrojnë shërbim pranë qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore ose në ambiente të tjera të përshtatshme?	
A ka pasur raste në të cilat nuk kanë përfituar ndihmës juridike parësore subjekte të cilat përfshihen te kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike ose te përfituesit e ndihmës juridike me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme?	
A ka qenë i përjashtuar nga konflikti i interesit subjekti i cili ka ofruar shërbimin e ndihmës juridike parësore?	
A janë publikuar në një format të aksesueshëm formularët për të kërkuar përfitimin e ndihmës juridike dytësore?	
A është publikuar lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore?	
A është publikuar lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore në faqen zyrtare të DhKA-së?	
A janë caktuar avokatët që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike dytësore duke zbatuar parimin e rotacionit?	
A janë trajnuar mjaftueshëm avokatët që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore?	
A janë respektuar nga prokuroria dhe gjykatat afatet për shqyrtimin e kërkesave për ndihmë juridike dytësore?	



A ka pasur raste kur qytetarët janë asistuar nga ofruesit e ndihmës juridike parësore për paraqitjen e kërkesave për ndihmë juridike dytësore dhe kërkesat nuk janë pranuar nga gjykata për shkak se dokumentacioni përkatës nuk ishte plotësuar në përputhje ligjin?	
A ka qenë i përjashtuar nga konflikti i interesit subjekti i cili ka ofruar shërbimin e ndihmës juridike dytësore?	
A janë ankimuar nga DNJF-të vendimet e gjykatave për miratimin e kërkesës për ndihmë juridike dytësore dhe janë lënë në fuqi këto vendime nga gjykatat më të larta?	
A janë publikuar në një format të aksesueshëm formularët për të kërkuar përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore?	
A ka pasur raste kur qytetarët janë asistuar nga ofruesit e ndihmës juridike parësore për paraqitjen e kërkesave për përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore dhe kërkesat nuk janë pranuar nga gjykata për shkak se dokumentacioni përkatës nuk ishte plotësuar në përputhje ligjin?	
A është ekzekutuar vullnetarisht vendimi i gjykatës për përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore?	
Në rast se jo, a është realizuar ekzekutimi i detyrueshëm nëpërmjet shërbimit përmbartimor gjyqësor?	
A ka qenë i mjaftueshëm buxheti i alokuar për pagimin e tarifave gjyqësore dhe e shpenzimeve gjyqësore nga skema shtetërore e ndihmës juridike?	
A janë miratuar nga MD kriteret dhe metodologjia për vlerësimin e cilësisë së ofrimit të shërbimeve të ndihmës juridike dhe procedurat e mbikëqyrjes nga DNJF të shërbimeve të ndihmës juridike?	
A janë miratuar nga DhKA dhe DNJF kriteret dhe procedurat për përzgjedhjen e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore?	
A janë miratuar nga MD formularët, kontratat dhe aktet e tjera të përcaktuara në ligj?	
A është miratuar nga DHKA lista e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore brenda datës 1 shkurt të çdo viti kalendarik?	
Nëse po, në hartimin e kësaj liste, a është mbajtur parasysh, përfshirja e avokatëve të të gjitha specialiteteve dhe niveleve dhe respektimin e barazisë gjinore?	
A janë lidhur deri më 1 mars të çdo viti kalendarik, kontratat e përvitshme të shërbimit me avokatët e përfshirë në listën e miratuar nga DhKA për ofrimin e ndihmës juridike dytësore?	
A janë kryer pagesat, bazuar në tarifën përkatëse të shpërblimit të avokatëve, të cilët ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore?	
A është kryer autorizimi i OJF-ve për të ofruar ndihmë juridike në mënyrë periodike?	

A i kanë përmbushur kriteret e parashikuara në ligj OJF-të që autorizohen për dhënien e shërbimeve të ndihmës juridike parësore?	
A janë zbatuar procedurat dhe rregullat e përzgjedhjes së OJF-ve të autorizuara, që përfitojnë financime nga buxheti i shtetit nëpërmjet një procesi konkurrues dhe transparent përzgjedhjeje?	
A janë lidhur kontratat me OJF-të për shërbimet e ndihmës juridike parësore dhe janë kryer pagesat përkatëse?	
A e ka publikuar MD dhe DNJF listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore dhe listën e OJF-ve të autorizuara që ofrojnë shërbime të ndihmës juridike parësore në faqen e saj zyrtare?	
A janë përgatitur dhe organizuar programet e trajnimit të vazhdueshëm për avokatët e përfshirë në listën e avokatëve që ofrojnë shërbimet e ndihmës juridike dytësore?	
A është kryer në mënyrë periodike nga DNJF vlerësimi i cilësisë së dhënies së ndihmës juridike?	
Nëse po, a ka zbatuar DNJF një sistem për të kryer vlerësimin e cilësisë së dhënies së ndihmës juridike?	
A janë realizuar nga DNJF fushata për rritjen e ndërgjegjësimit publik për kushtet për përftimin e ndihmës juridike?	
A janë ndërmarrë nisma nga DNJF për të bashkëpunuar me organizata ndërkombëtare, me klinika ligjore dhe me OJF vendase dhe të huaja për zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike?	
A ka rezultuar i mjaftueshëm planifikimi i kostove dhe shpenzimeve të lidhura me dhënien e ndihmës juridike nga DNJF?	
A janë menaxhuar fondet buxhetore për dhënien e ndihmës juridike nga DNJF në përputhje me ligjin?	

<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Përqindje</i>
Sa janë të informuar qytetarët për mundësinë për të përfituar ndihmë juridike parësore falas?	
Sa janë të informuar qytetarët për kriteret për të përfituar ndihmë juridike parësore falas?	
Sa janë të informuar qytetarët për mënyrën e plotësimit të formularëve për të përfituar ndihmë juridike parësore falas?	
Sa janë të informuar qytetarët për procedurat për të përfituar ndihmë juridike dytësore falas?	
Sa janë të informuar qytetarët për vendodhjen e subjekteve që ofrojnë ndihmë juridike parësore falas?	

Sa është niveli i kënaqësisë së përfituesve për cilësinë e shërbimit ligjor të përfituar nga çdonjëri nga subjektet e parashikuara në ligj për ofrimin e ndihmës juridike parësore falas?	
Cili është raporti ndërmjet ankesave të paraqitura kundër ofruesve të shërbimit dhe masave disiplinore të zbatuara?	
Sa është niveli i kënaqësisë i përfituesve për cilësinë e komunikimit të ofruesve të ndihmës juridike parësore falas?	
Sa është niveli i kënaqësisë i përfituesve për vendndodhjen e subjekteve të parashikuara në ligj për ofrimin e ndihmës juridike parësore falas?	
Cili është raporti i përfituesve të cilët do të riktheheshin ose jo për të përfituar sërish shërbime nga subjektet të cilat ofrojnë ndihmë juridike parësore falas?	
Cili është raporti i rasteve në të cilat nuk kanë përfituar ndihmë juridike parësore subjekte të cilat përfshihen te kategoritë e veçanta të përfituesve të ndihmës juridike ose te përfituesit e ndihmës juridike me të ardhura dhe pasuri të pamjaftueshme?	
Cili është raporti ndërmjet numrit total të përfituesve të ndihmës juridike parësore dhe përfituesve nga pakicat kombëtare?	
Sa janë të informuar qytetarët për mundësinë për të përfituar ndihmë juridike parësore dytësore?	
Sa janë të informuar qytetarët për kriteret për të përfituar ndihmë juridike dytësore falas?	
Sa janë të informuar qytetarët për mënyrën e plotësimit të formularëve për të përfituar ndihmë juridike dytësore falas?	
Sa janë të informuar qytetarët për procedurat për të përfituar ndihmë juridike dytësore falas?	
Sa është niveli i kënaqësisë së përfituesve për cilësinë e shërbimit të ndihmës juridike dytësore falas të përfituar nga avokatët?	
Cili është raporti ndërmjet ankesave të paraqitura kundër ofruesve të shërbimit dhe masave disiplinore të zbatuara?	
Sa është niveli i kënaqësisë i përfituesve për cilësinë e komunikimit të avokatëve gjatë ofrimit të shërbimit të ndihmës juridike dytësore falas?	
Cili është raporti i përfituesve të cilët do të riktheheshin ose jo për të përfituar sërish shërbime të ndihmës juridike dytësore falas nga avokatët?	
Cili është raporti i rasteve në të cilat kërkesat për ndihmë juridike dytësore janë rrëzuar nga gjykatat e shkallëve të para dhe vendimet janë ndryshuar nga gjykatat e apelit?	
Cili është raporti ndërmjet numrit total të përfituesve të ndihmës juridike dytësore dhe përfituesve nga pakicat kombëtare?	

Sa janë të informuar qytetarët për mundësinë për të përfituar përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore?	
Sa janë të informuar qytetarët për kriteret për të përfituar përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore?	
Sa janë të informuar qytetarët për mënyrën e plotësimit të formularëve për të përfituar përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe shpenzimeve gjyqësore?	
Sa janë të informuar qytetarët për procedurat për të kërkuar përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore?	
Cili është raporti i përfituesve të cilët do të riktheheshin ose jo për të përfituar sërish shërbime të ndihmës juridike dytësore falas nga avokatët?	
Cili është raporti i rasteve në të cilat kërkesat për përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore janë rrëzuar nga gjykatat e shkallëve të para dhe vendimet janë ndryshuar nga gjykatat e apelit?	
Sa të efektshme kanë qenë fushatat e organizuara nga DNJF për rritjen e ndërgjegjësimit publik mbi ofrimin e ndihmës juridike dhe kushtet për përftimin?	
Sa është niveli i kënaqësisë i qendrave të shërbimit të ndihmës juridike parësore për administrimin e tyre nga DNJF?	
Sa është niveli i kënaqësisë i OJF-ve dhe i Klinikave të Ligjit për bashkëpunimin nga ana e DNJF-së?	
Sa është niveli i kënaqësisë i OJF-ve për transparencën dhe bazueshmërinë në ligj të procedurës për dhënien e autorizimit për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore?	
Sa është niveli i kënaqësisë i OJF-ve për transparencën dhe bazueshmërinë në ligj të procedurës për financimin nga buxheti i shtetit për ofrimin e shërbimeve të ndihmës juridike parësore?	
Sa është niveli i kënaqësisë së OJF-ve lidhur me disbursimin e pagesave brenda afateve?	
Sa është niveli i kënaqësisë së avokatëve lidhur me disbursimin e pagesave brenda afateve?	
Sa është niveli i kënaqësisë i avokatëve për cilësinë e programeve të trajnimit të vazhdueshëm të përgatitura dhe të organizuara nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në bashkëpunim me DNJF?	
<i>Treguesit e realizimit</i>	<i>Shifra</i>
Sa është numri i ofruesve të ndihmës juridike parësore për 100 000 banorë?	
Sa është numri i ofruesve të ndihmës juridike dytësore për 100 000 banorë?	

### ***Metodat për zhvillimin e monitorimit:***

- Analiza e vendimeve të gjykatave të apelit për vendimet për vendimet e gjykatave të shkallës së parë për rastet që kanë shqyrtuar kërkesat për përjashtimin nga pagesa e tarifave dhe e shpenzimeve gjyqësore.
- Analiza e raportit vjetor që paraqet MD në Kuvend për gjendjen e sistemit të ndihmës juridike;
- Analiza e raporteve tremujore mbi zbatimin e ligjit dhe mbi përdorimin e mjeteve financiare buxhetore të alokuara për ofrimin e ndihmës juridike që DNJF i paraqet MD-së;
- Analiza e raporteve vjetore për veprimtarinë e saj në lidhje me zbatimin e ligjit dhe të politikës shtetërore në fushën e ndihmës juridike që DNJF i paraqet MD-së;
- Monitorimi i bashkëpunimit të DNJF-së me organizata ndërkombëtare, me klinika ligjore dhe me OJF-të vendase dhe të huaja në zhvillimin e sistemit të ndihmës juridike, nëpërmjet rritjes së ndërgjegjësimit dhe edukimit ligjor të publikut;
- Analiza e buxhetit vjetor për ndihmën juridike;
- Monitorimi i publikimeve në faqet zyrtare në internet të MD-së, DNJF-së dhe DhKA-së.
- Analiza e raporteve të Këshillit të Lartë të Shtetit mbi menaxhimin e fondeve buxhetore për dhënie të ndihmës juridike nga DNJF;
- Paraqitja e kërkesave për informacion drejtuar MD-së dhe DNJF-së.
- Zhvillimi i intervistave të thelluara me juristët të cilët ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe avokatët të cilët ofrojnë ndihmë juridike dytësore.
- Zhvillimi i intervistave *focus groups* me juristët të cilët ofrojnë ndihmë juridike parësore dhe avokatët të cilët ofrojnë ndihmë juridike dytësore.
- Zhvillimi i sondazheve lokale dhe kombëtare.

## RASTE STUDIMORE

### Kazus 1

Personi A është me aftësi të kufizuara dhe jeton në qytetin e Bajram Currit. Për shkak se Bashkia Tropojë nuk e rimbursos për shpenzimet e naftës, i drejtohet gjykatës administrative të shkallës së parë Tiranë për të kërkuar detyrimin e Bashkisë për të rimbursuar naftën. Gjykata cakton orën dhe datën e seancës gjyqësore, seancë e cila do të zhvillohet në sallën e katit të 3.

Shtetasi A udhëton nga Tropoja në Tiranë (sipas hartës gjyqësore dhe bashkimit të gjykatave, kompetente është gjykata e shkallës së parë Tiranë për gati 7 orë).

#### **Variant A:**

Personi A ndonëse ishte nisur 6 orë përpara seancës, rreth 1 orë 30 minuta përpara orarit të llogaritur nga studimi i hartës së re gjyqësore (sipas studimit distanca është 4 orë e 30 minuta), nuk arrin të mbërrijë në orën e caktuar në gjykatë, si rrjedhojë seanca është zhvilluar në mungesë të tij.

#### **Varianti B:**

Personi paraqitet 5 minuta përpara orës së seancës në ndërtesën e gjykatës, por konstaton se gjykata nuk ka ashensor, si rrjedhojë për shkaqe objektive dhe pamundësisë për të ngjitur 3 kate të gjykatës, nuk merr pjesë në seancën që po zhvillohet.

### Pyetje:

- **A është cenuar aksesi në drejtësi në variantin A?**
- **A është cenuar aksesi në drejtësi në variantin B?**
- **A ka detyrim gjykata për të marrë masa për vendosjen e ashensorit, rampave me qëllim që t'u mundësojë personave me aftësi të kufizuara aksesin në gjykatë?**
- **A ka cenuar miratimi i hartës së re gjyqësore aksesin në drejtësi?**
- **A i ka vlerësuar KLGj të gjitha rrethanat, mundësitë dhe askesueshmërinë e të gjitha grupeve gjatë hartimit të hartës së re gjyqësore?**

## Kazus 2

Personi A është në pamundësi financiare për të zgjedhur një avokat dhe për të paguar shpenzimet gjyqësore. Me ndihmën e një OJF-je që ofron ndihmë juridike falas, harton një padi dhe i bashkangjit padisë një kërkesë për përjashtimin nga taksa dhe shpenzimet e tjera gjyqësore, si dhe depoziton provat për të vërtetuar pamundësinë financiare. Gjykata vendos kthimin e akteve të padisë me argumentimin që nuk është përmbushur një kusht për paraqitjen e padisë, konkretisht padisë nuk i është bashkangjitur mandati për pagimin e tarifës së padisë.

Në nenin 154 pika 2 germa dh) të K.Pr.C. parashikohet se:

*2. Përveç këtyre kërkesave, paditësi në kërkesëpadi duhet të tregojë saktë dhe/ose të bashkëngjisë:*

*dh) aktin provues të pagimit të tarifës së padisë, sipas ligjit.*

**Në nenin 154 të K.P.C. parashikohet se:**

*“Kur kërkesëpadi nuk plotëson kushtet e përmendura në këtë kre, gjyqtari i vetëm ia kthen paditësit në kohën e paraqitjes së saj ose ai njoftohet me shkrim për plotësimin e të metave dhe, pasi të jetë shënuar në padi data e paraqitjes, caktohet një afat për plotësimin e të metave”.*

### Pyetjet:

1. **Si e vlerësoni vendimin e gjykatës?**
2. **A është cenuar aksesin në drejtësi në rastin konkret?**
3. **A është cenuar e drejta për të përfituar nga ligji për ndihmën juridike?**
4. **A duhet të paraqiste personi A së pari kërkesën për përjashtim nga taksa dhe shpenzimet e tjera gjyqësore dhe më pas t'i drejtohej gjykatës me padi?**

## EKSTRAKTE

### **Neni 10 i Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut:**

*“Gjithkush gëzon njëlloj të drejtën për një proces gjyqësor objektiv e publik para një gjykate të pavarur e të paanshme, në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve të veta dhe për vendimin mbi çfarëdo lloj akuze penale”.*

### **Në nenin 14 paragrafi 1 i Paktit Ndërkombëtar për të Drejtat Civile dhe Politike:**

“...Në përcaktimin e çfarëdolloj akuze penale ndaj tij, apo të të drejtave dhe detyrimeve të tij në një çështje në gjykim, kushdo duhet të ketë të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe të hapur...”

### **Në nenin 6 paragrafi 1 i Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut:**

“Në përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve civile apo të dënimit penal ndaj një njeriu, secili ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe të hapur... Vendimi duhet të shpallet publikisht...”.

### **Neni 2 Protokollit 7 i KEDNj-së:**

1. Çdo person i shpallur fajtor për një vepër penale nga një gjykatë ka të drejtë të paraqesë për shqyrtim përpara një gjykate më të lartë deklarinimin e fajësisë ose dënimit. Ushtrimi i kësaj të drejte, duke përfshirë shkaqet për të cilat ajo mund të ushtrohet, përcaktohet me ligj.
2. Nga kjo e drejtë mund të ketë përjashtime për vepra të lehta penale, siç përcaktohen me ligj, ose kur i interesuari ka qenë gjykuar në shkallë të parë nga gjykata më e lartë, ose shpallur fajtor dhe dënuar në vijim të një apeli kundër pafajësisë së tij.

### **Kushtetuta:**

#### **Neni 42**

“**Kushdo**, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.

#### **Neni 43**

“Kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe”.



## **Kodit i Procedurës Civile:**

### **Neni 26**

“Seancat gjyqësore janë të hapura, përveç kur parashikohet ndryshe sipas këtij Kodi. Gjykata mund të mos lejojë pjesëmarrjen e medias, kur çmon se nuk është në dobi të gjykimit. Në çdo rast vendimi përfundimtar i gjykatës shpallet publikisht”.

### **Neni 442**

Mjetet për t’u ankuar ndaj vendimeve të gjykatave janë: ankimi në gjykatën e apelit, rekursi në Gjykatën e Lartë, kërkesa për rishikim.

#### **Neni 442/a:**

Ankimi është akti me të cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës dhe veprimeve të përmbaruesit gjyqësor, për të mbrojtur të drejtat dhe interesat e tyre.

#### **Neni 442/b:**

Rekursi është akti me të cilin palët ose pjesëmarrësit e tjerë në proces parashtrojnë kundërshtimet e tyre ndaj vendimit të gjykatës së shkallës së parë ose të gjykatës së apelit në Gjykatën e Lartë, sipas rregullave të përcaktuara në këtë Kod.

### **Neni 443:**

Afati i ankimit në gjykatën e apelit, kundër vendimeve përfundimtare të gjykatës së shkallës së parë, është 15 ditë.

Afati për të bërë rekurs në Gjykatën e Lartë, kundër vendimeve të gjykatës së apelit, është 30 ditë.

Afati për të kërkuar rishikimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë dhe kundërshtimin e të tretit është 30 ditë.

Afati i ankimeve dhe rekurseve të veçanta është 5 ditë.

### **Neni 444:**

Afatet e caktuara në nenin 443 janë të prera dhe fillojnë nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit të arsyetuar

## **Kodi Procedurë Penale:**

### **Neni 1:**

Legjislacioni procedural penal ka për detyrë të sigurojë një procedim të drejtë, të barabartë e të rregullt ligjor, të mbrojtë liritë personale dhe të drejtat e interesat e ligjshme të shtetasve, të ndihmojë për forcimin e rendit juridik dhe zbatimin e Kushtetutës e të ligjeve të shtetit.

### **Neni 11:**

1. Gjykata është organi që realizon dhënien e drejtësisë.
2. Askush nuk mund të deklarohet fajtor dhe të dënohet për kryerjen e një vepre penale pa vendim të gjykatës.

### **Neni 12:**

Drejtësia penale jepet nga:

- a) gjykatat penale të shkallës së parë;
- b) gjykatat e apelit;
- c) Gjykata e Lartë.

### **Neni 107**

Pjesëmarrja e shurdhit, memecit dhe e shurdhmemecit në bërjen e akteve procedurale:

1. Kur shurdhi, memeci apo shurdhmemeci dëshirojnë ose duhet të japin shpjegime, veprohet në këtë mënyrë:
  - a) shurdhit i paraqiten pyetjet dhe paralajmërimi me shkrim dhe ai përgjigjet me gojë;
  - b) memecit i bëhen pyetjet dhe paralajmërimi me gojë dhe ai përgjigjet me shkrim;
  - c) shurdhmemecit i paraqiten pyetjet dhe paralajmërimi me shkrim dhe ai përgjigjet me shkrim.
2. Në qoftë se shurdhi, memeci ose shurdhmemeci nuk dinë të lexojnë ose të shkruajnë, autoriteti procedues cakton një ose më shumë interpretë të zgjedhur ndërmjet atyre personave që janë të mësuar të merren vesh me ta.

### **Neni 407/3**

Mjetet e ankimit janë: apeli, rekursi në Gjykatën e Lartë dhe kërkesa për rishikim.

### **Neni 415**

1. Përveç rasteve të parashikuara ndryshe në këtë Kod, afati për të bërë ankim është pesëmbëdhjetë ditë. Ky afat fillon nga dita e nesërme e njoftimit të vendimit.
2. Ai që ka bërë ankim ka të drejtë që deri pesë ditë para seancës të paraqesë në sekretarinë e gjykatës që do të shqyrtojë çështjen, parashtrime me shkrim lidhur me shkaqet e ngritura në ankim.
3. Afatet e parashikuara nga ky nen nuk mund të zgjaten për asnjë shkak, përveç rasteve të parashikuara me ligj.

## **Neni 422**

### **E drejta e apelit**

Prokurori, i pandehuri dhe paditësi dhe i padituri civil kanë të drejtë të apelojnë vendimet e gjykatës së shkallës së parë.

## **Neni 423**

### **Apeli kundërshtues**

1. Pala që nuk ka bërë ankim brenda afatit mund të bëjë apel kundërshtues brenda pesë ditëve nga dita kur ka marrë njoftimin për apelin e palës tjetër.

## **Neni 435**

### **Paraqitja e rekursit**

1. Rekursi paraqitet me shkrim brenda 45 ditëve nga e nesërmja e njoftimit të vendimit të gjykatës së apelit. Afati për paraqitjen e rekursit kundër një vendimi të gjykatës së apelit me të cilin është vendosur prishja e vendimit dhe kthimi i akteve gjykatës së shkallës së parë është 20 ditë. Rekursi shqyrtohet nga Gjykata e Lartë jo më vonë se dy muaj nga momenti i regjistrimit të tij në sekretarinë gjyqësore.
2. Akti i rekursit dhe memoriet duhet të nënshkruhen, me pasojë mospranimi, nga mbrojtësit. Kur i pandehuri nuk ka mbrojtës të zgjedhur, kryetari i kolegjit cakton një mbrojtës kryesisht dhe në këtë rast lajmërimet i bëhen edhe të pandehurit.

## **Neni 435/a**

### **Kundërrekursi**

1. Pala kundër së cilës është paraqitur rekurs mund ta kundërshtojë atë me kundërrekurs brenda 20 ditëve nga dita kur ka marrë njoftimin për rekursin e palës tjetër. Në rastin kur rekursi është paraqitur kundër një vendimi të gjykatës së apelit me të cilin është vendosur prishja e vendimit dhe kthimi i akteve gjykatës së shkallës së parë, afati për paraqitjen e kundërrekursit është 10 ditë.
2. Kundërrekursi i njoftohet atij që ka bërë rekursin brenda 20 ditëve nga komunikimi i rekursit

## **Neni 3 i ligjit Nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”**

Në këtë ligj termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

- a) “Ndihmë juridike” është shërbimi juridik falas dhe shërbimet e tjera të parashikuara në këtë ligj, për personat që përmbushin kriteret e këtij ligji, të cilat garantohen dhe financohen nga shteti.
  - b) “Ndihmë juridike parësore” është:
    - i) dhënia e informacioneve në lidhje me sistemin ligjor të Republikës së Shqipërisë, aktet normative në fuqi, të drejtat dhe detyrimet e subjekteve të ligjit dhe metodat për ushtrimin e këtyre të drejtave në procesin gjyqësor dhe në atë jashtëgjyqësor;
    - ii) dhënia e këshillimit;
    - iii) dhënia e këshillimit mbi procedurat e ndërmjetësimit dhe zgjidhjeve alternative të mosmarrëveshjeve;
    - iv) dhënia e ndihmës në hartimin dhe përpilimin e dokumenteve të nevojshme për të vënë në lëvizje administratën shtetërore ose për të kërkuar ndihmë juridike dytësore;
    - v) përfaqësimi përpara organeve administrative;
    - vi) dhënia e të gjitha formave të tjera të mbështetjes së nevojshme juridike që nuk përbëjnë ndihmë juridike dytësore.
  - c) “Ndihmë juridike dytësore” është shërbimi juridik që ofrohet për përpilimin e akteve të nevojshme për të vënë në lëvizje gjykatën; ofrimi i këshillimit, përfaqësimit dhe mbrojtjes para gjykatës në çështjet administrative, civile dhe në çështjet penale, për të cilat nuk zbatohet mbrojtja e detyrueshme, sipas përcaktimeve të legjislacionit procedural penal.
- (...) h) “Përjashtim nga tarifat dhe shpenzimet gjyqësore” është një formë e ndihmës juridike falas për përjashtimin nga pagesa e tarifave gjyqësore dhe shpenzimeve gjyqësore, me vendim të gjykatës kompetente, nëse plotësohen kriteret e vendosura nga ky ligj.

#### **Neni 91 i ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”**

1. Këshilli i Lartë Gjyqësor është përgjegjës për mbarëvajtjen e marrëdhënieve të gjyqësorit me publikun. Në këtë kuadër, Këshilli kryen detyrat e mëposhtme:
  - a) krijon, zhvillon dhe mirëmban një portal elektronik në internet, me qëllim ofrimin e informacionit të duhur për qasjen në drejtësi, përfshirë informacion të detajuar për strukturën e gjyqësorit dhe të gjykatave të veçanta, natyrën dhe qëllimin e procedurave gjyqësore, ndihmën juridike, kohëzgjatjen mesatare të çështjeve, tarifat gjyqësore, mjetet alternative të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve dhe çështje të tjera me interes publik;
  - b) bën të mundur që secila gjykatë të ketë hapësirën e saj të veçantë në portalin në internet dhe t’i lejohej të publikojë në të të dhëna për gjykatën dhe çështjet gjyqësore;

- c) merr masa që publiku dhe palët e interesuara të informohen mbi veprimtarinë e gjykatave, si dhe për çështje të veçanta gjyqësore;
  - ç) miraton dhe përditëson, pas konsultimit me këshillat e gjykatave, udhëzuesit standard të shtypit.
2. Këshilli cakton një nga anëtarët e tij për kryerjen e detyrave në lidhje me marrëdhëniet me publikun.
  3. Këshilli i Lartë Gjyqësor cakton të paktën një gjyqtar për mediet për çdo juridiksion apeli. Në ato raste kur komunikimi me publikun nuk mund të kryhet prej tij, shërbimi kryhet nga shërbimi i shtypit i Këshillit.
  4. Shkolla e Magjistraturës ofron trajnim për anëtarët e Këshillit, gjyqtarët për mediet, administratën e Këshillit dhe nëpunësit civilë gjyqësorë të përfshirë në veprimtaritë e marrëdhënieve me publikun.

**Kreu II i Udhëzimit nr. 15 datë 23.12.2011, “Për përpunimin dhe publikimin e të dhënave personale në sistemin gjyqësor”.**

1. Sipas ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, gjykatat janë kontrolluese, sepse mbajnë, përpunojnë, administrojnë, publikojnë, arkivojnë dhe për këtë shkak kontrollojnë të dhënat personale.
2. Përpunimi i ligjshëm i të dhënave personale bëhet duke respektuar dhe garantuar të drejtat dhe liritë themelore të njeriut dhe, në veçanti, të drejtën e ruajtjes së jetës private.
3. Gjatë përpunimit të të dhënave në sistemin gjyqësor, është e rëndësishme të respektohet parimi i ligjshmërisë, proporcionalitetit dhe qëllimit të mbledhjes së tyre. Të dhënat personale mblidhen vetëm për qëllime specifike, të qarta dhe të ligjshme në kuadër të përmbushjes së detyrave të këtij sistemi dhe përpunohen vetëm për të njëjtin qëllim për të cilin të dhënat janë grumbulluar.

## BIBLIOGRAFIA

### Ligjet

- Ligji nr. 49/2012      Ligji nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar
- Ligji nr. 111/2017      Ligji nr. 111/2017 “Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti”
- Ligji nr.115/2016      Ligji nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”
- Ligji nr. 96/2016      Ligji nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarit dhe prokurorit në Republikën e Shqipërisë”.
- Ligji nr. 10385/2011      Ligji nr. 10385, datë 24.02.2011 “Për ndërmjetësimin në zgjidhjen e mosmarrëveshjeve”

### Literaturë

- A2JBC Working Group, School of Criminology, University of the Fraser Valley, & International Centre for Criminal Law Reform and Criminal Justice Policy: Access to Justice Measurement Framework;
- International Development Law Organization: Access to Justice: A Conceptual and Practical Analysis eith Implications for Justice Reforms;
- Julio C. Teehankee, Ph.D. De La Salle University – Manila: Access to Justice Indicators in the Asia-Pacific Region;
- Udhëzues mbi nenin 6 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut. E drejta për një proces të rregullt ligjor (aspekti civil), Këshilli i Evropës, 2013;
- Joniada Musaraj “Çështje të aksesit në drejtësi dhe të gjykimit brenda një afati të arsyeshëm në kuadrin e të drejtës për një proces të rregullt ligjor. Përvoja shqiptare në vështrim të krahasuar”, aksesuar në linkun: <http://www.doktoratura.unitir.edu.al/wp-content/uploads/2017/03/JONIADA-MUSARAJ-DISERTACION-P%C3%8BR-MBROJTJEN-E-GRAD%C3%8BS-SHKENCORE-DOKTOR.pdf>;
- Milatovic.S “Studim mbi aksesin në drejtësi në Shqipëri, UNDP, aksesuar në linkun [https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/FINAL\\_DRAFT\\_SURVEY\\_SQ.pdf](https://www.undp.org/sites/g/files/zskgke326/files/migration/al/FINAL_DRAFT_SURVEY_SQ.pdf)

- Analizë e Sistemit të Drejtësisë në Shqipëri, Komisioni i Posaçëm Parlamentar për Reformën në Sistemin e Drejtësisë, Tiranë, 2015.
- Studimi “Drejt Drejtësisë, Analizë e procesit civil në gjykatat e rretheve gjyqësore”, 2013, OSCE.
- Rekomandimin e Avokatit të Popullit “Rekomandim për rishikimin e propozimit të hartës së re gjyqësore, duke garantuar aksesin në drejtësi të qytetarëve në kuadër të së drejtës për një proces të rregullt ligjor”, aksesuar:  
<https://www.avokatipopullit.gov.al/media/manager/ëeb/site/media/Rekomandim%20per%20botim.pdf>.
- Alushaj. L “Harta e re gjyqësore me probleme të vjetra”, aksesuar në linkun <https://www.monitor.al/harta-e-re-gjyqesore-me-probleme-te-vjetra>
- Raportin e Monitorimit “Garantimi i aksesit në drejtësi për personat me aftësi të kufizuar në Shqipëri”, botim i Fondacionit Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuar, Dhjetor 2018.
- Raporti: Studim dhe Monitorim i Gjykatës së Rrethit Tropojë”, përgatitur nga Qendra Integrim dhe Zhvillim Demokratik”, Viti 2019.
- Raport Vlerësimi “Plani Kombëtar i Veprimit 2020-2022”, aksesuar në linkun [https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/OGP\\_Komponenti-III-Akresi-n%C3%AB-Drejt%C3%ABsi\\_Raporti-i-Vler%C3%ABsimi-t-p%C3%ABrperiudh%C3%ABn-shtator-2021-2022.pdf](https://www.drejtësia.gov.al/wp-content/uploads/2022/11/OGP_Komponenti-III-Akresi-n%C3%AB-Drejt%C3%ABsi_Raporti-i-Vler%C3%ABsimi-t-p%C3%ABrperiudh%C3%ABn-shtator-2021-2022.pdf).
- Vendimi nr. 238/1/b, datë 24.12.2008 i Këshillit të Lartë të Drejtësisë “Për solemnitetin e gjykimit dhe veshjen e posaçme të gjyqtarit”.
- “Udhëzues për paraqitjen dhe shqyrtimin e çështjeve në Gjykatën e Lartë”, aksesuar në linkun. [http://www.gjykataelarte.gov.al/ëeb/rregullat\\_e\\_rekursit\\_ne\\_gjl\\_2021\\_5779.pdf](http://www.gjykataelarte.gov.al/ëeb/rregullat_e_rekursit_ne_gjl_2021_5779.pdf)
- Vendimin nr.554, datë 29.12.2022 të Këshillit të Lartë Gjyqësor.
- Urdhër nr.54, datë 09.03.2023 “Për caktimin e orarit të hedhjes së së shortit elektronik për ndarjen e çështjeve gjyqësore”.

### **Vendime GjEDNj**

- Vendim Le Compte, Van Leuven dhe De Meyere, datë 23/06/1981, GjEDNj;
- Vendimi Sporrang dhe Lönnroth, datë 23/09/1982, GjEDNj.
- Vendimin e GjEDNj-së “Golder vs. Royaume-Uni”, Aplikimi nr.4451/70;

- Vendimin e GjEDNj-së “Luordo c. Italie”, Aplikimi nr.32190/96;
- Vendimin e GjEDNj-së “Weissman dhe të tjerë kundër Rumanisë”
- Vendimin e GjEDNj-së “Golder kundër Mbretërisë së Bashkuar”
- Vendimin e GjEDNj-së “Riepan kundër Austrisë”, 14 Nëntor 2000;
- Vendim Frowein-Peukert, EMRK-Komentar, 2.Auflage, Engel Verlag 1996, f. 209.
- Vendim Krombach kundër Francës, datë 13.02.2001, GjEDNj.

#### **Jurisprudenca vendase:**

- Vendimi nr. 20, datë 22.09.2022 i GjK-së;
- Vendimi nr. 14, datë 21.06.2022 të GjK-së;
- Vendimi nr. 8, datë 23.02.2021 të GjK-së;
- Vendimi nr. 12 datë 09.03.2021 i GjK-së;
- Vendimi nr.21, datë 20.03.2017 i GjK-së;
- Vendimi nr. 37, datë 30.06.2016 të GjK-së.
- Vendimi nr.2, datë 16.01.2013 të GjK-së;
- Vendimi nr. 42/2011 i GjK-së;
- Vendimi nr. 14/2009 i GjK-së;
- Vendimi nr. 24, datë 21.11.2008 të GjK-së;
- Vendimi nr.29, datë 21.12.2006 të GjK-së;
- Vendimi Nr. 5, datë 2 .02.2001 të GjK-së;
- Vendimi Unifikues nr. 1, datë 31.01.2006 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë;
- Vendimi nr. 370, datë 11.06.2013 të Kolegjit Civil i Gjykatës së Lartë.

#### **Faqe interneti**

- <https://sourcebooks.fordham.edu/source/magnacarta.asp>
- <https://www.un.org/en/development/desa/what-we-do/rule-of-law.html>
- <https://www.un.org/ruleoflaw/thematic-areas/açess-to-justice-and-rule-of-law-institutions/açess-to-justice/>
- <http://komentarielektronik.magjistratura.edu.al/sq/eli/fz/2017/7905/450>





### **CIP Katalogimi në botim BK Tiranë**

Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore

Monitorimi i aksesit në drejtësi dhe performanca gjyqësore  
për zhvillimin e një gjykimi të drejtë : aksesit në drejtësi dhe  
komunikimi me përdoruesit e gjykatës : manual trajnimi për  
shoqërinë civile / Instituti për Studimet Publike dhe Ligjore. -  
Tiranë : Muza, 2023.

... f. ; ... cm

ISBN 9789928361462

1.E drejta dhe legjislacioni 2.Gjykata 3.Gjykimi 4.Shoqëria  
civile 5.Manuale 6.Shqipëri  
34(496.5) (035)